



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

VRASJET E GRAVE DHE VAJZAVE DHE FEMICIDI NË SHQIPËRI (2021-2023)

Ky raport u përgatit nga Avokati i Popullit me mbështetjen e UN Women, Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”, i financuar nga Qeveria së Suedisë.

Autore: Znj. Lindita Cakoni dhe znj. Agustela Nini-Pavli, eksperte, UN Women

Znj. Erinda Ballanca, znj. Vilma Shurdha dhe znj. Brunilda Dervishaj, nga Zyra e Avokatit të Popullit

Znj. Alba Agolli dhe znj. Majlinda Nesturi, nga UN Women

Tiranë, dhjetor 2024

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtimeve	4
Përmbledhje ekzekutive	5
Hyrje	9
1. Përkufizimi i femicidit dhe kuadri ligjor ndërkombëtar.....	10
2. Metodologjia dhe mbledhja e të dhënave.....	14
KREU I - VRASJET E GRAVE DHE VAJZAVE (FEMICIDI) NË SHQIPËRI	
1.1 Nevoja për përmirësimin e mekanizmave institucionalë.....	18
1.2 Legjislacioni penal mbi vrasjen e grave dhe vajzave në Shqipëri dhe legjislacioni kundër dhunës dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.....	18
1.3 Legjislacioni kundër dhunës në familje.....	20
1.4 Të dhënat statistikore mbi vrasjet e grave dhe vajzave në Shqipëri (2021-2023).....	21
1.5 Norma e femicidit në Shqipëri dhe krahasimi me vende të tjera.....	24
1.6 Analizë e rasteve të vrasjes së grave dhe vajzave dhe të dhëna mbi viktimat dhe autorët	26
1.7 Harta e vrasjeve të grave dhe vajzave (femicideve) në Shqipëri	33
KREU II - ROLI I MKR-VE NË TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS DHE PARANDALIMIN E FEMICIDIT	
2.1 Koordinimi ndërinstitutional në mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës	36
2.2 Roli i policisë në trajtimin e rasteve të dhunës dhe parandalimin e femicidit.....	40
2.3 Roli i prokurorisë dhe gjykatave si pjesë e MKR-ve.....	43
2.4 Monitorimi i urdhrave të mbrojtjes.....	44
2.5 Roli i bashkive/koordinatorit vendor për dhunën në familje.....	45
2.6 Roli i qendrave shëndetësore.....	46
2.7 Roli i organizatave të shoqërisë civile.....	47
2.8 Roli i familjes dhe komunitetit.....	48
KREU III - HETIMI DHE GJYKIMI I VRASJES SË GRAVE DHE VAJZAVE NË SHQIPËRI	
3.1 Roli i policisë dhe prokurorisë në hetimin e vrasjes së grave/vajzave dhe identifikimin e femicideve.....	48
3.2 Analiza e vendimeve gjyqësore për veprat penale të vrasjes së grave dhe vajzave lidhur me gjininë (femicidet) (2021-2023).....	50
3.3 Dënimi i autorëve të femicidit.....	54
3.4 Monitorimi i seancave gjyqësore.....	57
3.5 Pasojat e femicidit të fëmijët dhe familjarët e viktimave.....	58

KREU IV- REKOMANDIME

4.1 Rekomandime të përgjithshme.....	62
4.2 Rekomandime specifike.....	63

SHTOJCA

Raste studimore.....	67
Intervista me familjarët e viktimave.....	77
Intervista me autorët.....	80

Harta e qendrave kombëtare dhe strehëzave për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.....	84
--	----

LITERATURA.....	85
------------------------	-----------

Lista e shkurtimeve

AP	Avokati i Popullit
BE	Bashkimi Evropian
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DHBGJ	Dhuna me bazë gjinore
DHF	Dhuna në familje
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
INSTAT	Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEGJFDG	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KLQJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
KP	Kodi Penal
KPP	Kodi i Procedurës Penale
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
NJVV	Njësitë e vetëqeverisjes vendore
OJF	Organizata jofitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSHC	Organizata të shoqërisë civile
PMF	Punonjësi për mbrojtjen fëmijëve
PP	Prokuroria e Përgjithshme
UM	Urdhër mbrojtjeje
UMM	Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje
UMPM	Urdhër paraprak i mbrojtjes së menjëhershme
UN WOMEN	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport është hartuar nga Avokati i Popullit, bazuar në të dhënat e mbledhura për vitet 2021-2023 në kuadër të Observatorit për Femicidet në Shqipëri, i krijuar në mars 2024 pranë këtij institucioni.¹ Ngritja e Observatorit, si një mekanizëm monitorues lidhur me vrasjet e grave dhe vajzave për shkak të gjinisë, përbën një hap të rëndësishëm në drejtim të institucionalizimit të masave për parandalimin e kësaj dukurie, si dhe të rritjes së ndërgjegjësimit të strukturave përgjegjëse për trajtimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Shqipëria është vendi i parë në Ballkan - dhe ndër të paktat vende në Evropë - që ka ngritur Observatorin për Femicidet,² duke hedhur një hap tepër të rëndësishëm drejt zbatimit të detyrimeve që burojnë nga instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe luftimin e dhunës me bazë gjinore.

Qëllimi i raportit – Qëllimi i raportit është të analizojë dhe dokumentojë rastet e femicidit në Shqipëri gjatë periudhës 2021–2023, duke identifikuar problematikat dhe boshllëqet institucionale në trajtimin e dhunës me bazë gjinore dhe të femicideve. Raporti synon të ofrojë rekomandime konkrete për parandalimin e kësaj dukurie, përmirësimin e përgjigjes institucionale dhe mbështetjen e viktimave dhe trashëgimtarëve.

Objekti i raportit – Objekti i raportit përfshin mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mbi rastet e femicidit në Shqipëri, shqyrtimin e rolit të institucioneve përgjegjëse (policia, prokuroria, gjykatat, bashkitë, dhe institucionet shëndetësore), si dhe vlerësimin e efektivitetit të masave mbrojtëse, shërbimeve mbështetëse dhe programeve rehabilituese në trajtimin e këtyre rasteve.

Metodologjia dhe mbledhja e të dhënave – Për qëllimin e këtij raporti janë përdorur të dhëna parësore dhe dytësore. Të dhënat parësore u mbledhën nga institucionet përgjegjëse, si dhe gjatë monitorimit të proceseve gjyqësore. Ndërkohë, të dhënat dytësore u siguruan nga studime të mëparshme mbi femicidin dhe dhunën me bazë gjinore.

Struktura: Raporti përfshin *Hyrjen*, që trajton kontekstin, përkufizimin dhe kuadrin ligjor ndërkombëtar si dhe informacion për metodologjinë e përdorur. **Kreu I** paraqet në mënyrë të përmbledhur rastet e monitoruara të femicidit, me të dhëna për viktimat, autorët dhe rrethanat e krimeve. **Kreu II** vazhdon me një analizë të detajuar të masave që duhet të kishin marrë institucionet përgjegjëse për parandalimin e këtyre krimeve. Kjo është bazuar në detyrat e tyre sipas legjislacionit shqiptar, Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEGJFDG), Konventës së Stambollit, si dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për çështje të kësaj natyre. **Kreu III** analizon rolin e institucioneve të

¹ Observatori për Femicidet është ngritur në përputhje me kërkesat e KEGJFDHG-së, Konventës së Stambollit, etj., për mbledhjen, publikimin dhe analizimin e të dhënave për vrasjet e grave dhe vajzave në nivel kombëtar. Ngritja e Observatorit u mbështet nga Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara dhe qeverisë shqiptare “T’i japim fund dhunës ndaj grave”, i financuar nga qeveria e Suedisë.

² Në nëntor 2017, Gjeorgjia ishte vendi i parë në Evropë që ngriti Mekanizmin mbi Monitorimin e Femicideve.

prokurorisë dhe të gjykatës gjatë proceseve penale ndaj autorëve të femicidit, si dhe pasojat tek fëmijët e viktimave. Në përfundim, raporti paraqet një sërë **rekomandimesh** të përgjithshme dhe specifike, drejtuar gjithë institucioneve përkatëse. Në Shtojcë paraqiten tre raste studimore, ngjarje të rënda të ndodhura në vendin tonë ku viktima mbetën pesë gra dhe vajza, katër prej të cilave u vranë nga persona me të cilët ato kishin marrëdhënie familjare, si dhe intervista me familjarë të viktimave dhe disa autorë të krimeve.

Femicidi nuk është një term i përkufizuar apo i përdorur në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, ose në akte ligjore të tjera. Po ashtu, nuk ka dispozita të cilat rregullojnë shprehimisht vrasjet për shkak të gjinisë. Megjithatë, kjo nuk duhet të përbëjë pengesë për organet e drejtësisë që në rastet e vrasjeve të grave t'i kushtojnë vëmendjen e duhur motivit gjinor që lidhet me krimin.

Gjatë viteve 2021-2023, në Shqipëri u vranë 32 gra dhe vajza, 27 prej të cilave u vranë nga autorë me të cilët viktimat ishin në marrëdhënie familjare. Nga 28 autorët e vrasjeve, 26 ishin burra dhe djem dhe në dy raste autore ishin një grua dhe një vajzë. Në 28 raste autori është gjetur dhe në dy raste autori nuk është gjetur nga organet kompetente. Gjashtë autorë humbën jetën menjëherë pas ngjarjes, nga të cilët pesë u vetëvranë dhe një humbi jetën në përpjekje për t'iu shmangur arrestimit nga policia. Dy autorë humbën jetën në paraburgim gjatë hetimeve.

Rezulton se nga 32 rastet e vrasjeve të grave dhe vajzave, 24 prej tyre i përmbushin elementët për t'u cilësuar si femicide, ose vrasje për shkak të gjinisë. Vrasjet në këto raste u kryen nga 22 autorë.

Norma e femicidit në Shqipëri për vitin 2021 ishte **0,85 për 100,000 popullatë gra dhe vajza**; në vitin 2022 kjo normë ra në **0,50** dhe në vitin 2023 u rrit në 0,84. Krahasimi me disa nga vendet e rajonit dhe Bashkimit Evropian³ për vitet 2021, 2022 dhe 2023 tregon se:

- Në 2021, norma e femicidit në Shqipëri ishte **më e lartë** se në Maqedoninë e Veriut, Itali, Slloveni, Serbi, Maltë, Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë, Çeki, Bullgari, Rumani, Greqi, Hungari dhe në Mal të Zi.
- Në 2022, norma e femicidit në Shqipëri ishte **më e ulët** se në disa prej këtyre vendeve dhe **më e lartë** se në Slloveni, Maqedoninë e Veriut dhe Itali.⁴
- Në 2023, norma e femicidit në Shqipëri ishte **më e ulët krahasuar me Maqedoninë e Veriut, por më e lartë se në të gjitha vendet e tjera të përzgjedhura për krahasim.**

³ Vendet e përzgjedhura për krahasim janë: Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Sllovenia, Serbia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Rumania Malta, Hungaria, Greqia, Çekia dhe Italia.

⁴ UNODC ka publikuar të dhëna për femicidet sipas shteteve deri në vitin 2023, te cilat janë llogaritur për 100.000 popullatë femra. Shih: <https://dataunodc.un.org/dp-femicide>.

Në lidhje me motivet, rezultojnë se në pjesën më të madhe të rasteve gratë dhe vajzat u vranë për shkak të xhelozisë, mospranimi të ndarjes, mospranimi të faktit që viktima kishte krijuar një marrëdhënie tjetër pas ndarjes me autorin e vrasjes, dhe hakmarrjes për raportimin në polici. Në pjesën më të madhe, vrasjet u kryen me mizori, nëpërmjet përdorimit të armëve të zjarrit, mjeteve të mprehta, mjeteve të forta, si dhe ushtrimit të forcës fizike.

Nga të dhënat e mbledhura rezultojnë se në rreth 90% të rasteve viktimat e femicidit dhunoheshin nga autorët e vrasjes përpara kryerjes së krimit, por vetëm gjashtë prej tyre (25%) e kishin raportuar më parë në polici dhunën. Në dy prej këtyre rasteve, gratë ishin të pajisura me masa mbrojtëse (UMM/UM) në momentin e vrasjes. Asnjë prej rasteve nuk ishte pajisur me urdhër për masë paraprake të mbrojtjes së menjëhershme (UMPMM) nga policia.

Problematikat e hasura për sa i përket parandalimit të krimeve, në rastet që ishin raportuar më parë në polici, lidhen kryesisht me mosvlerësimin e duhur të faktorëve të rrezikut dhe mosmarrjen e masave të menjëhershme të mbrojtjes, moskoordinimin e mirë të punës ndërmjet strukturave përgjegjëse, moskryerjen e monitorimit të masave mbrojtëse sipas procedurave të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, dhe mungesën e shërbimeve mbështetëse efektive për viktimat dhe të atyre rehabilituese për dhunuesit.

Këto problematika janë evidentuar gjithashtu edhe nga Grupi i Ekspertëve për Veprim Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO) në Raportin e parë të vlerësimit tematik për Shqipërinë, publikuar në shtator 2024.⁵ Nga ana tjetër, numri i lartë i grave dhe vajzave të vrara të cilat nuk kishin raportuar më parë në polici, nxjerr në pah nevojën për rritje të mëtejshme të ndërgjegjësimit të komunitetit dhe institucioneve.

Katër prej grave dhe vajzave u vranë disa ditë pas daljes nga burgu të autorëve, të cilët kishin vuajtur dënimin në lidhje me veprën penale të dhunës në familje parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal. Kjo vë në pah nevojën për vënien në lëvizje të mekanizmave që mundësojnë jo vetëm njoftimin në kohë të viktimës në lidhje me lirimin nga burgu të dhunuesve, por edhe mbajtjen nën monitorim të këtyre rasteve, pavarësisht nëse viktimat janë apo jo të pajisura me urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje/urdhër mbrojtjeje (UMM/UM). Në këtë kuadër, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë duhet të rishikojnë standardet e bashkëpunimit ndërmjet tyre sa i përket kryerjes në kohë të njoftimeve në lidhje me lirimin nga burgu të dhunuesve, si dhe dhënies së informacionit mbi ecurinë e procesit rehabilitues të autorëve të veprave penale që lidhen me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Ngritja e programeve rehabilituese dhe zbatimi i tyre në të gjitha institucionet e vuajtjes së dënimit

⁵ Raporti i parë i vlerësimit tematik për Shqipërinë i Grupit të Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO), “Ndërtimi i besimit duke ofruar mbështetje, mbrojtje dhe drejtësi”, shtator 2024. “GREVIO inkurajon fuqimisht autoritetet shqiptare të sigurojnë që vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi i tij në rastet që kanë të bëjnë me të gjitha format e dhunës të mbuluara nga Konventa e Stambollit të kryhen duke përfshirë dhe bashkërenduar punën me të gjitha agjencitë dhe subjektet përkatëse që ofrojnë shërbime për viktimat dhe fëmijët e tyre”. Shih: <https://rm.coe.int/grevio-s-first-thematic-evaluation-report-on-albania/1680b1a0ca>

(IEVP), si dhe pjesëmarrja e detyrueshme e autorëve të dhunës me bazë gjinore në këto programe, janë çështje të tjera që duhen trajtuar me kujdesin e duhur.

Në përgjithësi, adresimi i çështjeve ku dhunuesit paraqesin probleme të shëndetit mendor mbetet një sfidë e cila duhet trajtuar me kujdesin e duhur dhe në mënyrë sa më të shpejtë.

Gjatë periudhës objekt i monitorimit, 35 fëmijë u prekën nga vrasja e nënave të tyre, nga të cilët 20 ishin të mitur. Po ashtu, disa prej tyre ishin të pranishëm në momentin e ngjarjes. Këta fëmijë vuajnë pasojë psikologjike, por edhe ekonomike, për shkak të ngjarjes dhe për shkak të zgjatjes së procedurave gjyqësore mbi kujdestarinë. Përgjithësisht, familjet që marrin të drejtën e kujdestarisë së këtyre fëmijëve hasin vështirësi në rritjen dhe edukimin e tyre, për shkak të situatës ekonomike, mungesës së shërbimeve, ose pamjaftueshmërisë së tyre.

Hetimet për çështjet e femicidit përgjithësisht janë zhvilluar në afate të shkurtra kohore. Në rastet kur autorët kanë humbur jetën pas ngjarjes, hetimet janë mbyllur brenda pak muajve, ndërsa në rastet e tjera hetimet kanë zgjatur nga tre muaj deri në një vit e 15 ditë. Në rastet ku autori nuk është gjetur menjëherë pas ngjarjes, hetimet zgjasin shumë në kohë.

Problematik është fakti se hetimi nuk shtrihet që të përfshijë edhe informacionet që disponojnë strukturat përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, në rastet kur gratë dhe vajzat e vrara kanë qenë viktima të mëparshme të dhunës, apo të pajisura me urdhër mbrojtje në momentin e ngjarjes. Po ashtu, në rastet e kërkesave për pushimin e çështjes për shkak të vdekjes së autorit, gjykatat procedojnë në afate më të shkurtra kohore dhe nuk thellohen në analizimin e historikut të dhunës. Në kërkesat për gjykim të paraqitura nga prokuroria dhe në vendimet e gjykatës nuk i kushtohet vëmendje motivit gjinor të vrasjes.

Bazuar në ndryshimet e viteve të fundit në Kodin Penal, gjykatat aplikojnë dënime më të rrepta në rastet e kryerjes së krimeve për shkak të marrëdhënieve familjare; megjithatë, ende nuk ka raste ku është vërtetuar motivi gjinor i krimin.

Ky raport përmban disa rekomandime të përgjithshme dhe specifike për institucionet përkatëse. Rekomandimet fokusohen në dy drejtime:

- Masat që duhet të merren për parandalimin e femicidit, nëpërmjet forcimit të përgjigjes së koordinuar ndër-institucionale ndaj rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës ndaj grave dhe, në veçanti, kryerja me efektivitet e vlerësimit të riskut si dhe zbatimi i masave mbrojtëse për viktimat e dhunës.
- Masat që duhet të merren gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjeve të femicidit dhe, në veçanti, thellimi në motivin gjinor të vrasjes dhe analizimi i historikut të mëparshëm të dhunës, që gjithashtu ndikojnë në rritjen e ndërgjegjësimit për parandalimin e kësaj dukurie.

HYRJE

Dhuna me bazë gjinore jo vetëm përbën një dukuri të përhapur globale, por konsiderohet si një nga shkeljet më të rënda të drejtave të njeriut që prek në mënyrë disproporcionale gratë dhe vajzat. Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të gjithë rendit juridik. E drejta për jetë dhe mbrojtja e saj është një nga detyrimet themelore Kushtetuese, si një vlerë nga e cila burojnë të gjitha të drejtat e tjera. Në përmbushje të detyrave të tyre, organet e pushtetit publik duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.⁶

Vrasja e grave për shkak të gjinisë, ose femicidi, përbën formën më ekstreme të dhunës me bazë gjinore. Sipas raportit të përbashkët të Zyrës së Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe Krimin (UNODC) dhe UN Women “Femicidi në 2023: Të dhëna botërore mbi vrasjet e grave dhe vajzave nga partnerët intimë dhe anëtarët të familjes”, në nivel botëror, në vitin 2023, u vranë me dashje 85000 gra dhe vajza; rreth 51100 prej tyre (ose rreth 60%) u vranë nga partnerët intimë ose anëtarë të tjerë të familjes.⁷ Po kështu, sipas raportit të vitit 2022, atë vit, në nivel global u vranë afërsisht 89000 gra dhe vajza, që ishte numri më i lartë vjetor i vrasjeve të regjistruara në njëzet vitet e fundit.⁸

Avokati i Popullit në Shqipëri, si një institucion i pavarur kushtetues, në ushtrimin e funksioneve të tij i kushton vëmendje të veçantë barazisë gjinore, parandalimit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe, në veçanti, formave më të rënda të saj. Ky raport paraqet një analizë të thelluar mbi rastet e vrasjeve të grave dhe vajzave në Shqipëri gjatë periudhës janar 2021 - dhjetor 2023, me fokus në rastet e femicidit, apo të vrasjes së grave për shkak të gjinisë. Raporti u hartua nga Avokati i Popullit, në bazë të të dhënave të mbledhura në kuadër të Observatorit për Femicidet në Shqipëri, i ngritur në mars 2024 pranë këtij institucioni.⁹

Observatori është një mekanizëm monitorimi i krijuar për të trajtuar rastet e vrasjeve të grave dhe vajzave, me qëllim parandalimin e kësaj dukurie dhe zbatimin efektiv të legjislacionit kundër dhunës me bazë gjinore. Nëpërmjet këtij mekanizmi mblidhen të dhëna në nivel kombëtar, të cilat analizohen në mënyrë të thelluar, me qëllim identifikimin e problematikave dhe boshllëqeve në zinxhirin e mekanizmit mbrojtës për viktimat e dhunës. Në bazë të gjetjeve, hartohen

⁶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 15 dhe 21.

⁷ UNODC dhe UN Women, “Femicidi në 2023: Të dhënat botërore të vrasjes së grave dhe vajzave nga partnerët intimë dhe anëtarët të familjes”, <https://www.unwomen.org/sites/default/files/2024-11/femicides-in-2023-global-estimates-of-intimate-partner-family-member-femicides-en.pdf>

⁸ Raporti i UNODC dhe UN Women “Vrasja e grave dhe vajzave lidhur me gjininë”, Vlerësime globale në lidhje me vrasjet e grave dhe vajzave nga partnerët intimë dhe anëtarët e familjes, viti 2022, shih: <https://www.unwomen.org/sites/default/files/2023-11/gender-related-killings-of-women-and-girls-femicide-feminicide-global-estimates-2022-en.pdf>

⁹ Observatori për Femicidet u ngrit në përputhje me kërkesat e KEGJFDG-së, Konventës së Stambollit, etj., për mbledhjen, publikimin dhe analizimin e të dhënave për vrasjet e grave dhe vajzave në nivel kombëtar. Ngritja e Observatorit u mbështet nga Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara dhe qeverisë shqiptare “T’i japim fund dhunës ndaj grave”, i financuar nga qeveria e Suedisë.

rekomandimeve konkrete për Mekanizimin Kombëtar të Luftës kundër Dhunës me bazë Gjinore dhe institucionet përkatëse.

I gjithë informacioni hidhet në një sistem të posaçëm të dhënash mbi femicidet,¹⁰ bazuar në kuadrin statistikor të OKB-së¹¹ dhe praktikat më të mira evropiane. Gjatë këtij procesi, institucioni i Avokatit të Popullit angazhohet edhe në monitorimin e seancave gjyqësore në lidhje me veprat penale të vrasjeve ku viktimat janë gratë ose vajzat, me qëllim kryerjen e analizës së procedurës dhe vendimmarrjes gjyqësore.

Bazuar në studime të ndryshme mbi femicidin dhe praktikat e vendeve të cilat e kanë përfshirë Observatorin për Femicidet brenda një institucioni të pavarur, vlerësohet se ky mekanizëm do të ketë efikasitetin e nevojshëm jo vetëm sa i përket mbledhjes dhe analizimit të dhënave mbi femicidet, por veçanërisht në drejtim të parandalimit të kësaj dukurie.

Po ashtu, ky raport ndihmon në përmbushjen e një prej rekomandimeve të GREVIO-s në raportin e vitit 2024 që *“inkurajon fuqimisht autoritetet shqiptare që të prezantojnë një sistem rishikimi retrospektiv të rasteve të vrasjeve me bazë gjinore dhe vetëvrasjeve të lidhura me dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe të vlerësojnë nëse boshllëqet në përgjigjen institucionale dhe/ose gjyqësore kanë kontribuar në rezultatin fatal, me synimin për t'i parandaluar ato në të ardhmen dhe për t'i mbajtur përgjegjës si autorët e krimeve, ashtu edhe institucionet që mund të kenë dështuar në detyrimet e tyre për të parandaluar incidente të tilla”*.¹²

1. Përkufizimi i femicidit dhe kuadri ligjor ndërkombëtar

Mbrojtja nga forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave garantohet nga një sërë konventash ndërkombëtare. Megjithatë, ende nuk është formuluar një përkufizim për femicidin i pranuar universalisht.¹³ Përgjithësisht, femicidi njihet si manifestimi më ekstrem dhe brutal i dhunës ndaj grave; një dukuri që prek të gjitha rajonet dhe vendet në mbarë botën. Në thelb, femicidi nënkupton vrasjet e grave dhe vajzave për motive që lidhen me gjininë.

Megjithëse instrumentet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut garantojnë të drejtën e grave për barazi gjinore, dhuna ndaj grave u njoh zyrarisht si shkelje e të drejtave të njeriut

¹⁰ Sistemi i mbajtjes së të dhënave për rastet e femicideve, është një bazë të dhënash e ndarë në disa rubrika, të cilat fokusohen në të dhënat mbi viktimitë, autorin dhe ngjarjen. Në sistem ka një rubrikë të veçantë ku regjistrohen rastet e vlerësuara si femicide në bazë të komponentëve që burojnë nga kuadri statistikor i OKB-së. Një vend të posaçëm në sistem kanë edhe vendimet e gjykatave dhe të dhënat mbi monitorimin e seancave gjyqësore.

¹¹ Kuadri statistikor për matjen e vrasjeve të grave dhe vajzave të lidhura me gjininë (që njihet edhe si "femicid/femicidit"), përgatitur nga Zyra e Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe Krimin dhe Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave. Dokumenti mund të gjendet në adresën: https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/Statistical_framework_femicide_2022.pdf

¹² Raporti i parë i vlerësimit tematik për Shqipërinë i Grupit të Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO), “Ndërtimi i besimit duke ofruar mbështetje, mbrojtje dhe drejtësi”, shtator 2024.

¹³ Në lidhje me historikun e termit femicid dhe përkufizimet e ndryshme të bëra mbi këtë term shih Raportin e përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare “Vrasjet e Grave (Femicidi) dhe tentative për femicid në Shqipëri 2017-2020”, viti 2021. Ky raport u realizua në kuadër të zbatimit të Programit Rajonal të UN Women “Ti japim fund dhunës kundër grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi”, “Zbatojmë normat, ndryshojmë mendësitë”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.

vetëm në vitet 1990. Në vitin 1992, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (Komiteti i KEGJFDG-së), në Rekomandimin e tij të përgjithshëm nr. 19, hapi një kapitull të ri për adresimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore. Kjo dhunë u konsiderua si një formë diskriminimi e ndaluar nga neni 1 i Konventës KEGJFDG. Në vijim, Komiteti i KEGJFDG-së, nëpërmjet Rekomandimit nr. 35 “Për dhunën me bazë gjinore ndaj grave” të vitit 2017, me të cilin përditësoi Rekomandimin e përgjithshëm nr. 19 të vitit 1992, u kërkoi shteteve anëtare të mbledhin, analizojnë dhe publikojnë rregullisht të dhëna statistikore mbi dhunën ndaj grave, me fokus të veçantë në të dhënat administrative që lidhen me vrasjen e grave dhe vajzave për shkak të gjinisë (femicid/femicid). Në nëntor 2023, në Vëzhgimet Përfundimtare drejtuar Shqipërisë, Komiteti i KEGJFDG-së rekomandoi ndryshimin e Kodit Penal për të përfshirëemicidin si një vepër penale specifike.¹⁴

Nisma të Kombeve të Bashkuara për luftimin eemicidit

Në vitin 2017, Raportuesja e Posaçme e Kombeve të Bashkuara për Dhunën ndaj Grave, gjatë fushatës “16 Ditë të aktivizimit kundër dhunës ndaj grave” u bëri thirrje shteteve anëtare që të krijojnë mekanizma për mbledhjen dhe publikimin vjetor të të dhënave dhe analizave që lidhen me rastet eemicidit.

Shqyrtimi dhe analizimi i çështjeve tëemicideve, në kuadër të përgatitjes së këtij raporti, është bazuar në përkufizimin e dhënë nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB). Në kuadrin statistikor të OKB-së për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave statistikore,emicidi përkufizohet si:

“Vrasje me dashje e grave, e kryer nga partnerë intimë, anëtarë të tjerë të familjes, ose persona të njohur apo të panjohur, bazuar në mënyrën e kryerjes ose në kontekste që tregojnë motive gjinore”.¹⁵

Elementet identifikuese tëemicidit

Bazuar në kuadrin statistikor të OKB-së dhe legjisllacionin penal të Republikës së Shqipërisë, për të trajtuar një rast të vrasjes me dashje të një gruaje ose vajze siemicid, konsiderohen këto elementë:

- nëse autori i vrasjes kishte histori të mëparshme të dhunës fizike, seksuale ose psikologjike ndaj viktimës;
- nëse autori ishte ndaluar më parë nga organet ligjzbatuese;

¹⁴ Komiteti i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (Komiteti i KEGJFDG-së), raporti “Vëzhgimet përmbyllëse mbi raportin e pestë periodik të Shqipërisë”, viti 2023, shih: <https://documents.un.org/doc/undoc/gen/n23/352/80/pdf/n2335280.pdf>

¹⁵ Kuadri statistikor për matjen e vrasjeve të grave dhe vajzave të lidhura me gjininë (që njihen edhe si "emicide/femicide"), përgatitur nga Zyra e Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe Krimin dhe Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave, viti 2022, faqja 10. Shih: https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/Statistical_framework_femicide_2022.pdf

- nëse viktima kishte punuar në industrinë e seksit ose ishte subjekt i shfrytëzimit të paligjshëm;
- nëse viktima kishte pësuar dhunë seksuale para dhe/ose pas vrasjes;
- nëse vrasja ishte kryer me mizori dhe shoqëruar me gjymtim të trupit të viktimës;
- nëse trupi i pajetë i viktimës ishte lënë në një hapësirë publike;
- nëse vrasja ishte motivuar nga urrejtja ose paragjykimi ndaj grave;
- nëse viktima ishte rrëmbyer ose privuar nga liria para vrasjes.

Femicidi ndryshon nga format e tjera të vrasjes, sepse përkufizohet si vrasja e një gruaje për shkak të gjinisë së saj, thjesht sepse është grua. Shkaqet rrënjësore të femicidit lidhen me:

- pozitën e përgjithshme të gruas në shoqëri;
- diskriminimin ndaj grave;
- rolet gjinore;
- ndarjen e pabarabartë të pushtetit midis burrave dhe grave;
- stereotipet e zakonshme gjinore;
- paragjykimet dhe dhunën ndaj grave.

Roli i Konventës së Stambollit në luftën kundër dhunës ndaj grave

Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, e njohur si Konventa e Stambollit, është traktati ndërkombëtar më specifik për të luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Ajo përmban dispozita të shumta parandaluese dhe mbrojtëse, si dhe përcakton një sërë detyrimesh për shtetet anëtare që të sigurojnë një përgjigje të përshtatshme të drejtësisë penale ndaj këtyre shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut.

Megjithëse Konventa e Stambollit nuk e përmend shprehimisht femicidin, ky term përdoret gjerësisht në raportet e Grupit të Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO). GREVIO lavdëron shtetet anëtare që raportojnë mbi dukurinë e femicidit. Në raportin tematik të GREVIO-s për Shqipërinë, të publikuar në vitin 2024, u vlerësua se ngritja e Observatorit për Femicidet do të përmirësojë procesin e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, duke krijuar një pikë qendrore referimi për këtë dukuri në Shqipëri. Gjithashtu, GREVIO inkurajon fuqimisht autoritetet shqiptare që të krijojnë një sistem rishikimi retrospektiv të rasteve të vrasjeve me bazë gjinore dhe vetëvrasjeve të lidhura me dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe të vlerësojnë nëse boshllëqet në përgjigjen institucionale dhe/ose gjyqësore kanë kontribuar në rezultatin fatal, me synimin për t’i parandaluar ato në të ardhmen dhe për t’i vënë

para përgjegjësisë si autorët e krimeve, ashtu edhe institucionet që mund të mos kenë përmbyshur detyrimet e tyre për t'i parandaluar incidente të tilla.¹⁶

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Çështjet e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, dhe specifikisht rastet më ekstreme që kanë çuar në humbjen e jetës, janë trajtuar gjerësisht nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në bazë të nenit 2 “E drejta për jetë” të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Disa nga çështjet gjyqësore më të rëndësishme që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me këtë studim përfshijnë: *Opuz kundër Turqisë* (2009), ku një person, pasi kishte tentuar më parë të vriste bashkëshorten, vrau nënën e saj. Ky ishte një nga rastet e para, në të cilin GJEDNJ kërkoi zbatimin e një sistemi për ndëshkimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave dhe konstatoi se “dhuna ndaj bashkëshortes dhe vrasja e nënës së saj konsiderohen se ka qenë me bazë gjinore dhe diskriminuese për gratë”. Gjithashtu, Gjykata konstatoi përgjegjësinë e Turqisë për mosndjekjen e procesit penal ndaj dhunuesit përpara se të kryente vrasjen, pavarësisht se denoncimi ishte tërhequr.¹⁷ Në raste të tjera gjyqësore, GJEDNJ-ja ka konstatuar përgjegjësi të autoriteteve për:

- mungesën e trajtimit psikiatrik të personave me probleme të shëndetit mendor që kanë kryer vrasje të bashkëshortes ose anëtarëve të tjerë të familjes (p.sh. *Branko Tomašić dhe të tjerët Kundër Kroacisë*, 2009);¹⁸
- hetimin e pamjaftueshëm të dhunës në familje në rastet ku familja jetonte në situatë dhune të vazhdueshme dhe përfundoi në vrasjen e fëmijës dhe plagosjen e nënës (*Talpis kundër Italisë*, 2019);¹⁹
- mungesën e hetimit të duhur në rastet e sulmit ndaj grave, kur ky sulm kishte shenjat dalluese të dhunës me bazë gjinore (*Tërshana kundër Shqipërisë*, 2020).²⁰

Disa nga çështjet e kohëve të fundit që kanë të bëjnë me parandalimin e vrasjeve në marrëdhëniet familjare përfshijnë: *Kurt kundër Austrisë* (2021, Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së);²¹ *Tkheldze kundër Gjeorgjisë* (2021);²² dhe *Y dhe të tjerë kundër Bullgarisë* (2022).²³ Gjykata u bazua në detyrimin primar që ka shteti për mbrojtjen e jetës, në përputhje me nenin 2 të Konventës

¹⁶ Raporti i parë i vlerësimit tematik për Shqipërinë i Grupit të Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO), “Ndërtimi i besimit duke ofruar mbështetje, mbrojtje dhe drejtësi”, viti 2024, faqja 16. Shih: <https://rm.coe.int/grevio-s-first-thematic-evaluation-report-on-albania/1680b1a0ca>

¹⁷ GJEDNJ (2009), *Opuz kundër Turqisë*, Vendimi, <http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-92945>

¹⁸ <http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng-press/pages/search.aspx?i=003-2602993-2833362>

¹⁹ <http://hudoc.echr.coe.int/eng-press?i=003-5644174-7145931>

²⁰ Çështja u vendos nën monitorim nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, në kuadër të të cilit Shqipërisë iu kërkua të mbante të informuar Komitetin mbi masat e marra për zbatim. Rrjeti i Monitorimit Kundër Dhunës me bazë Gjinore paraqiti një raport me problematikat që ekzistojnë. Në vijim, shteti shqiptar paraqiti një plan veprimi të masave të përgjithshme për adresimin e problematikave të çështjes, ndërsa për sa i përket masave individuale, prokuroria pritej të kthente përgjigje për ecurinë e hetimit të çështjes në fjalë (sipas informacionit më të fundit në lidhje me zbatimin e vendimit.

[https://hudoc.exec.coe.int/#{%22fulltext%22:\[%22tershana%20v%20albania%22\],%22excedentier%22:\[%22004-56331%22\]}](https://hudoc.exec.coe.int/#{%22fulltext%22:[%22tershana%20v%20albania%22],%22excedentier%22:[%22004-56331%22]})

²¹ [https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22itemid%22:\[%22002-13298%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22itemid%22:[%22002-13298%22]})

²² <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22tabview%22:%225B%22document%22%5D,%22itemid%22:%225B%22001-210854%22%5D%7D>

²³ <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%225B%22001-216360%22%5D%7D>

Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe në përgjegjësinë e autoriteteve që, nëse e dinin ose duhet të dinin për ekzistencën e një kërcënimi të mundshëm për jetën, duhet të merrnin hapat e duhur për ta parandaluar atë. Këtë detyrim GJEDNJ-ja e sqaroi më tej, duke përcaktuar përgjegjësitë konkrete të autoriteteve për vlerësimin e riskut në kontekstin e dhunës në familje (shih më poshtë Kreun 1).

2. Metodologjia dhe mbledhja e të dhënave

Për qëllimin e këtij raporti, janë përdorur të dhëna parësore dhe dytësore. Të dhënat parësore u mbledhën nga institucionet përgjegjëse, si edhe gjatë monitorimit të proceseve gjyqësore. Ndërsa të dhënat dytësore u siguruan nga studime të mëparshme mbi femicidin dhe dhunën me bazë gjinore.

Mbledhja dhe analizimi i të dhënave parësore

Të dhënat parësore u siguruan përmes:

- analizimit të materialeve të mbledhura nga strukturat kompetente në rrugë zyrtare,
- shqyrtimit të kërkesave për gjykim dhe vendimeve gjyqësore mbi veprat penale që lidhen me vrasjen e grave dhe vajzave,
- monitorimit të seancave gjyqësore për këto raste,
- intervistave, dhe
- analizimit të shkrimeve në media, etj.

Mbledhja e të dhënave u realizua falë bashkëpunimit me institucionet kryesore përgjegjëse, si:

- strukturat e Policisë së Shtetit,
- prokuroritë,
- gjykatat e rretheve gjyqësore,
- institucionet e pushtetit vendor,
- institucionet shëndetësore, dhe
- institucionet e vuajtjes së dënimit.

Nga strukturat e policisë u kërkua informacion statistikor dhe të dhëna mbi viktimat, autorët dhe ngjarjet për periudhën e monitorimit. Lidhur me viktimat dhe autorët, informacioni përfshin:

- gjeneralitetet (ID, emër, atësi, mbiemër, datëlindje, vendlindje, vendbanim, kombësi, shtetësi, arsim, gjendje civile, numri i fëmijëve dhe mosha e tyre),
- statusin e shtatzënisë,
- profesionin dhe punësimin,
- orientimin seksual,
- statusin e aftësisë së kufizuar,
- intoksikimin nga lëndë narkotike dhe/ose alkool,
- raportimet e mëparshme të dhunës,

- pajisjen ose jo me urdhra mbrojtjeje (UMM/UM),
- precedentët e mëparshëm penalë, dhe
- motivet e vrasjes.

Për **ngjarjet**, informacioni përfshinte:

- datën dhe orën e ndodhjes,
- vendndodhjen gjeografike të kryerjes së krimit,
- llojin e hapësirës ku ndodhi krimi (banesë private, zonë publike, institucion shtetëror/privat),
- faktin nëse fëmijët ishin të pranishëm gjatë ngjarjes,
- mënyrën e kryerjes së krimit dhe mjetin e përdorur, dhe
- faktin nëse krimi ishte kryer në bashkëpunim.

Nga prokuroritë e rretheve gjyqësore u kërkua informacion i detajuar që përfshinte:

- numrin e vrasjeve të referuara në prokurori, ku viktimat ishin gra ose vajza,
- numrin e çështjeve për të cilat ishte kërkuar dërgimi për gjykim,
- numrin e çështjeve për të cilat ishte kërkuar pushimi,
- numrin e çështjeve ende në hetim,
- numrin e çështjeve të pezulluara, dhe
- kopjet e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të ekzekutuara nga prokuroritë për rastet në fjalë.

Për çështjet ku vendimi i gjykatës nuk kishte marrë formë të prerë, u kërkuan kopje të kërkesave për gjykim ose për pushim.

Nga gjykatat u kërkua:

- informacion statistikor për çështjet e përfunduara,
- informacion mbi çështjet ende në proces gjykimi, dhe
- vendimet përfundimtare dhe materialet që shërbejnë për identifikimin e motiveve, shkaqeve dhe boshllëqeve në përgjigjen institucionale ndaj femicideve.

Disa nga instrumentet kryesore të përdorura për mbledhjen e të dhënave përfshinin:

- **komunikimin zyrtar me shkrim** me të gjitha institucionet përgjegjëse;
- **monitorimin e seancave gjyqësore** për të vlerësuar mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore;
- **zhvillimin e intervistave** me familjarët e viktimave dhe autorët e femicideve.

Për të krijuar një pasqyrë sa më të plotë mbi secilin rast, u mbledhën gjithashtu të dhëna nga media e shkruar dhe elektronike, që kanë raportuar rastet e vrasjeve të grave dhe vajzave. Të dhënat për rastet e femicidit u mbledhën në bazë të komponentëve të një **pyetësoi të përgatitur paraprakisht** dhe u regjistruan në një sistem të posaçëm për mbajtjen dhe analizimin e të dhënave.

Veprat penale objekt monitorimi dhe analizimi

Në këtë raport janë shqyrtuar veprat penale të parashikuara në nenet **76, 78, 79** dhe **79/c** të Kodit Penal, të cilat mund të klasifikohen si femicide kur përmbushin një ose më shumë nga elementet e përcaktuara më herët. Pas ndryshimeve në kompetencat lëndore të gjykatave në vitin 2021, këto vepra hetohen dhe gjykohen nga **prokuroritë** dhe **gjykatat e rretheve gjyqësore** të juridiksionit të përgjithshëm.

Shtrirja kohore

Gjurmimi dhe analizimi i rasteve të femicideve është shtrirë në periudhën **janar 2021 – dhjetor 2023**, gjatë së cilës janë marrë në shqyrtim të gjitha rastet e vrasjeve të grave dhe vajzave. Për sa i përket monitorimit të seancave gjyqësore, procesi është kryer gjatë vitit 2024 për çështje që lidhen me vrasjet e grave që janë vlerësuar si femicide dhe që kanë qenë në proces shqyrtimi gjyqësor pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Kufizimet e metodologjisë

Bazuar në analizimin e informacionit dhe dokumentacionit të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, prokuroritë dhe gjykatat e rretheve gjyqësore, në lidhje me rastet e vrasjeve të grave dhe vajzave gjatë periudhës janar 2021 - dhjetor 2023, Avokati i Popullit ka komunikuar zyrtarisht me drejtoritë vendore të policisë dhe bashkitë ku kishin vendbanimin viktimat. Gjithashtu, është kërkuar informacion nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në lidhje me rolin e institucioneve shëndetësore në trajtimin e këtyre rasteve. Vlen të theksohet se shumica e institucioneve kanë treguar gatishmëri për të bashkëpunuar dhe për të ofruar informacion mbi çështjet e femicidit. Megjithatë, janë evidentuar disa problematika që lidhen me procesin e dhënies së informacionit, si:

- vonesa në dërgimin e përgjigjeve,
- mosdhënia e informacionit të kërkuar sipas përmbajtjes së kërkesave,
- ofrimi i përgjigjeve formale, të cilat nuk mbështeten me informacion të detajuar apo të plotë,
- mosrakordimi i informacionit,
- moskontaktimi në kohë i personave të kontaktit,
- mungesa e të dhënave të standardizuara.

Gjithashtu, ka rezultuar se mbledhja e të dhënave është një proces që zgjat në kohë, pasi informacioni duhet të sigurohet nga burime të ndryshme, të analizohet dhe, në rast mosrakordimi, kërkohet informacion shtesë për të siguruar saktësi dhe përputhshmëri në të dhënat e mbledhura.

KREU I: VRASJET E GRAVE DHE VAJZAVE (FEMICIDI) NË SHQIPËRI

Dhuna me bazë gjinore, përfshirë femicidin, vazhdon të mbetet një dukuri shqetësuese në Shqipëri. Numri i vrasjeve ku viktimat janë gratë dhe vajzat ka mbetur konstant gjatë viteve të fundit.²⁴ Studimi i parë mbi vrasjen e grave dhe vajzave në Shqipëri u realizua nga Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare në kuadër të programit rajonal të UN Women “T’i japim fund dhunës kundër grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi” dhe të programit “Zbatojmë normat, ndryshojmë mendësitë”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Ky raport hedh dritë mbi një sërë faktorësh të rëndësishëm që lidhen me dhunën ndaj grave dhe femicidet në Shqipëri, duke i kushtuar vëmendje të veçantë analizës së kuadrit ligjor në fuqi, analizës së vendimeve gjyqësore mbi rastet e femicidit, si dhe vlerësimit të kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse.²⁵

Në përgjithësi, studimet mbi dhunën ndaj grave dhe vajzave kanë treguar se forma më e përhapur e femicidit është ajo e kryer nga partnerët intimë dhe nga anëtarët e familjes. Këto femicide shpesh janë të parashikueshme dhe mund të parandalohen, pasi zakonisht paraprihen nga dhuna fizike dhe psikologjike ndaj viktimave.

Nga analiza e rasteve të femicidit gjatë periudhës objekt monitorimi (2021-2023), rezulton se:

- nga **32 gra dhe vajza të vrara**, 27 prej tyre u vranë nga autorë me të cilët ishin në marrëdhënie familjare.
- në **rreth 90% të rasteve**, viktimat kishin përjetuar dhunë nga autorët përpara kryerjes së vrasjes.²⁶

Në disa raste, viktimat e femicideve e kishin raportuar dhunën e pësuar në polici apo në struktura të tjera mbrojtëse dhe ishin pajisur me urdhra mbrojtjeje (UM) nga gjykata, çka tregon se zbatimi i standardeve për mbrojtjen e grave dhe vajzave në situata dhune ka mangësi dhe kërkon rishikim të praktikave aktuale dhe koordinim më të mirë ndërmjet institucioneve përgjegjëse.

²⁴ Gjatë pesë viteve të fundit u vranë mesatarisht dhjetë gra/vajza në vit. Viti me numrin më të lartë të vrasjeve ishte 2018 me 15 vrasje, ndërsa viti 2022 ishte viti me numrin më të ulët, me shtatë gra dhe vajza të vrara.

²⁵ Raporti “Vrasjet e grave (femicidi) dhe tentativa për femicid në Shqipëri 2017-2020”, përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në bashkëpunim me UN Women Shqipëri.

²⁶ Kjo e dhënë rezulton nga analiza e vendimeve gjyqësore, ku nga pyetjet dëshmitarëve rezultoi se autorët ushtronin dhunë ndaj viktimave.

1.1 Nevoja për përmirësim të mekanizmave institucionale

Ngjarjet e femicideve nxjerrin në pah nevojën për një zbatim sa më rigoroz të procedurave për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe në veçanti për:

1. përmirësim të procedurës së vlerësimit dhe menaxhimit të riskut për viktimat, duke identifikuar me saktësi rastet më kritike;
2. rritjen e efikasitetit në koordinimin ndërmjet institucioneve, përfshirë strukturat policore, gjykatat, institucionet shëndetësore dhe shërbimet sociale në nivel qendror dhe lokal;
3. monitorim dhe analizë të vazhdueshme të rasteve, nga momenti i raportimit të dhunës deri në rehabilitimin e viktimave dhe të autorëve.

1.2 Legjislacioni penal mbi vrasjen e grave dhe vajzave në Shqipëri dhe legjislacioni kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje

Vitet e fundit, legjislacioni penal në Shqipëri ka pësuar ndryshime të vazhdueshme me qëllim përafrimin e tij me standardet ndërkombëtare dhe mbulimin më efektiv të çështjeve që lidhen me cenimin e të drejtave të njeriut nga veprimet dhe mosveprimet e kundërligjshme. Legjislacioni penal bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve, si dhe të humanizmit.²⁷ Gratë, vajzat dhe të miturit gëzojnë mbrojtje të veçantë nga legjislacioni në fuqi, një aspekt kyç i reformës në sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

Aktualisht, **femicidi** nuk është një term i përdorur në Kodin Penal apo në ligje të tjera në Shqipëri dhe nuk ekzistojnë dispozita specifike që trajtojnë vrasjet për shkak të gjinisë. Edhe pse vetëm pak vende e kanë përfshirë femicidin si një vepër penale specifike, hulumtimet tregojnë përfitime të shumta nga kjo qasje.²⁸

Klasifikimi i femicidit si vepër penale specifike është i nevojshëm sepse ndihmon në reagimin e shpejtë për parandalimin e femicidit, hetimin efektiv, si dhe në ndjekjen dhe ndëshkimin e autorëve. Gjithashtu ai lehtëson monitorimin dhe studimin e femicidit si dhe identifikimin e masave të përshtatshme për parandalimin e tij.

Legjislacioni penal

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë,²⁹ në **Kreun II** ka parashikuar veprat penale kundër personit. Seksioni 1 i këtij kreu trajton krimet kundër jetës të kryera me dashje, përfshirë veprat penale të cituara në nenet **76, 77, 78, 79,** dhe **79/c**. Këto vepra janë marrë në shqyrtim për këtë raport, duke u fokusuar te rastet ku viktimat ishin gra dhe vajza.

²⁷ Neni 1/c i Kodit Penal, i ndryshuar.

²⁸ Aktualisht Malta, Qipro, Belgjika, Maqedonia e Veriut dhe Kroacia janë pesë vendet evropiane që e kanë përfshirë femicidin si vepër penale në legjislacionin e tyre të brendshëm.

²⁹ Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

- **Neni 76:** “*Vrasja me dashje*”, dënohet me burgim nga **10 deri në 20 vjet**.
- **Neni 77:** “*Vrasja me dashje në lidhje me një krim tjetër*”, dënohet me **jo më pak se 20 vjet burgim**.
- **Neni 78:** “*Vrasja me paramendim*”, dënohet me burgim nga **15 deri në 25 vjet**.
- **Neni 79:** “*Vrasja në rrethana të tjera cilësuese*”, dënohet me **jo më pak se 20 vjet burgim ose burgim të përjetshëm**.
- **Neni 79/c:** “*Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare*”, e shtuar me Ligjin nr. 144/2013, dënohet me **jo më pak se 20 vjet burgim ose burgim të përjetshëm**.

Neni 79/c: “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare” përcakton si objekt mbrojtjeje marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar të drejtën e jetës së personave të lidhur në marrëdhënie familjare, gjinore, ose krushqie me autorin e veprës penale. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se kushti për kualifikimin e kësaj vepre është:

- vrasja të kryhet *me dashje*, dhe
- viktima të jetë një person në **lidhje të afërt familjare, gjinore, ose krushqie** me autorin.

Në këtë dispozitë ligjvënësi nuk i është referuar një ligji specifik për të përcaktuar personat në lidhje familjare, gjinore, apo krushqie me autorin e veprës. Në rastet kur viktimat janë gra ose vajza dhe ekzistojnë elementë që lidhin krimin me gjininë e viktimës, ato mund të klasifikohen si **femicide**.

Siç rezulton dhe nga të dhënat statistikore vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare zë përqindjen më të madhe të rasteve të vrasjeve të grave dhe vajzave në Shqipëri. Për periudhën objekt monitorimi rezulton se mbi 84% e vrasjeve ndaj grave dhe vajzave u kryen nga autorë me të cilët viktimat ishin në marrëdhënie familjare, kryesisht bashkëshortë, ish-bashkëshortë, bashkëjetues, ish-bashkëjetues vëlla-motër, kunat-kunatë, etj.

Neni 50 i Kodit Penal³⁰ përmban dispozita mbi rrethanat rënduese për autorët e veprave penale. Ky nen është ndryshuar disa herë ndër vite me qëllim shtimin e rrethanave që rëndojnë pozitën e autorëve të veprave penale. Në kuptim të kësaj dispozite, disa nga elementet që rëndojnë dënimin e autorëve të veprave penale janë:

- kryerja e veprave penale me **egërsi dhe mizori**,
- kryerja e veprave gjatë ose pas lëshimit të **urdhrave të mbrojtjes** nga gjykata,
- shfrytëzimi i **marrëdhënieve familjare**, dhe
- motivimi nga faktorë që lidhen me **gjininë**, identitetin gjinor, ose orientimin seksual të viktimës.

³⁰ Ndryshuar me Ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001, Ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004, Ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007, Ligjin nr. 144, datë 2.5.2013 dhe me Ligjin nr. 44/2019, datë 18.7.2019.

Sa më sipër janë në përputhje me elementët e parashikuar në kuadrin statistikor të OKB për cilësimin e vrasjeve të grave dhe vajzave si vrasje për shkak të gjinisë. Në disa nga vendimet e gjykatave janë parashtruar si rrethana rënduese kryerja e veprave me egërsi dhe mizori si dhe gjatë ose pas lëshimit të urdhrave të mbrojtjes, por në asnjë nga rastet e trajtuara nuk është parashtruar si rrethanë rënduese kryerja e veprës motivuar nga faktorë që lidhen me gjininë.

Ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale të vitit 2017³¹ ndër të tjera, prekën edhe dispozitat që rregullojnë procedurat mbi gjykimin e shkurtuar³². Në bazë të Nenit 403, pika 2, “Nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm”. Në këtë kuadër për veprat penale të parashikuara nga nenet 79 dhe 79/c, që parashikojnë mundësinë e dënimit me burgim të përjetshëm të autorëve të veprës penale, nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar. Kërkesa për gjykim të shkurtuar është pranuar në vetëm një prej rasteve të vlerësuara si femicid ; kjo çështje u gjykua pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Durrës.

1.3 Legjislacioni kundër dhunës në familje

Vlerësimi dhe menaxhimi i riskut, të përshkruar në Konventën e Stambollit, janë ndër procedurat më të rëndësishme për parandalimin e mëtejshëm të dhunës dhe përshkallëzimit të saj, që mund të çojë edhe në humbjen e jetës së viktimave të dhunës. Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”³³ u ndryshua katër herë me qëllim adresimin e çështjeve të evidentuara gjatë zbatimit të tij në praktikë, si dhe për të mundësuar mbrojtje efektive për viktimat në përputhje me Konventën e Stambollit. Në ndryshimet e vitit 2018, ky ligj parashikoi për herë të parë detyrimet për hartimin e procedurave dhe standardeve/protokolleve për vlerësimin e riskut, planeve të ndërhyrjes dhe të monitorimit të zbatimit të tyre, si dhe për lëshimin nga policia të urdhrave për masa paraprake të mbrojtjes së menjëhershme (UMPM). Këto procedura mundësojnë marrjen e masave të menjëhershme nga policia për mbrojtjen e viktimave nga rreziku i menjëhershëm. Po ashtu, në zbatim të detyrimeve ligjore, u miratua Udhëzimi i Përbashkët nr. 866, datë 20.12.2018, “Për miratimin e modelit dhe të procedurave për vlerësimin e riskut për rastet e dhunës në familje”³⁴, i cili përcakton procedurat për kryerjen e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit dhe modelin e këtij vlerësimi.

³¹ Ndryshuar me Ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017.

³² Gjykimi i shkurtuar është një institut procedural që i njeh të pandehurit të drejtën për të zgjedhur një formë alternative gjykimi, e kushtëzuar nga pranimi prej tij i akteve të hetimit paraprak në gjendjen e ndodhur dhe që ka si efekt shkurtimin e procedurës gjyqësore, duke shmangur debatin mbi provat dhe duke mundësuar përfundimin e procesit penal në një kohë më të shkurtër. Natyra juridike procedurale e gjykimin të shkurtuar ka të bëjë me shmangien e ecures së zakonshme të shqyrtimit gjyqësor të procedimit penal, si rezultat i kërkesës për zgjedhjen e kësaj procedure të posaçme gjykimi, që nënkupton zbatimin në kushte dhe situata të caktuara procedurale të rregullave të ndryshme nga ato që zbatohen zakonisht.

³³ Ndryshuar me Ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, date 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020.

³⁴ Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

1.4 Të dhënat statistikore mbi vrasjet e grave dhe vajzave në Shqipëri

Gjatë periudhës **janar 2021 – dhjetor 2023**, u vranë gjithsej **32 gra dhe vajza** nga **28 autorë**, nga të cilët një autor vrau dy gra dhe një vajzë, ndërsa në dy raste autori nuk është gjetur. Prej tyre, **27 gra dhe vajza (84,4%)** u vranë për shkak të marrëdhënieve familjare. Specifikisht:

- në **vitin 2021** u regjistruan **12 viktima gra dhe vajza**,
- në **vitin 2022** u regjistruan **7 viktima gra dhe vajza**, dhe
- në **vitin 2023** u regjistruan **13 viktima gra dhe vajza**.


Sipas Raportit të INSTAT-it “Burra dhe gra 2023”, nga **42 vrasje me dashje** të regjistruara gjatë vitit 2022, **26,2% (11 raste)** ishin vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare (neni 79/c i Kodit Penal). Ndër këto, **54,5% e viktimave (6 raste)** të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare ishin gra dhe vajza.³⁵ Sipas Prokurorisë së Përgjithshme, përqindja specifike e veprave penale të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare në grupin “Krime kundër jetës të kryera me dashje” në vitin 2021 ishte 4,6 %, në vitin 2022 ishte 4,4%, dhe në vitin 2023 ishte 4,14 %.³⁶

Përtej statistikave të viktimave të drejtpërdrejta, numri i personave që vuajnë pasojat e këtyre krimeve është shumë më i lartë, nëse marrim në konsideratë fëmijët jetimë, prindërit, vëllezërit dhe motrat e grave të vrara, që rrallë konsiderohen viktima të drejtpërdrejta të femicideve, megjithëse përballen me trauma dhe pasoja të rënda emocionale, sociale dhe ekonomike. Si rezultat, dhimbja e tyre është e padukshme dhe nevojat e tyre në të shumtën e rasteve mbeten të pa-adresuara në mënyrën e duhur.

³⁵ Raporti i INSTAT-it “Burra dhe gra”, viti 2023, faqja 90.

³⁶ Raportet e Prokurorisë së Përgjithshme, të viteve 2021, 2022 dhe 2023, shih: https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/

Grafiku nr.1



Krahasimisht me periudhën **2018-2020**,³⁷ gjatë së cilës u vranë gjithsej **37 gra dhe vajza**, prej të cilave **29 në marrëdhënie familjare**, periudha **2021-2023** tregon një **rënie të lehtë** të numrit të grave dhe vajzave të vrara. Megjithatë, statistikat konfirmojnë se vrasjet për shkak të dhunës në marrëdhëniet familjare mbeten një **problem serioz** që kërkon trajtim të menjëhershëm dhe angazhim shumëdimensional.

Nga **32 viktimat gra dhe vajza** të vrara në periudhën objekt monitorimi, rezulton se **24 raste** përfshijnë elementë që lidhen me femicidin (vrasjen për shkak të gjinisë).

Ndër rastet që nuk janë vlerësuar si femicide, përfshihen:

- një rast ku vrasja është cilësuar si “*Vrasje nga pakujdesia*” (neni 85 i Kodit Penal);
- një rast ku vrasja është cilësuar si “*Vrasje në tejkallim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme*” (neni 83 i Kodit Penal);
- një rast ku nusja vrau vjehrrën për shkak të konflikteve të ndërsjella;
- një rast ku viktima dhe bashkëshorti i saj u vranë nga kunati (vëllai i bashkëshortit) për një konflikt pronësie;
- një rast ku bashkëshorti vrau gruan dhe vëllain e tij për arsye xhelozie (autori kishte probleme të shëndetit mendor);

³⁷ Raporti “Vrasjet e grave (femicidi) dhe tentativa për femicid në Shqipëri 2017-2020, përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në bashkëpunim me UN Women Shqipëri. Sipas këtij raporti, në vitin 2018 u vranë 15 gra dhe vajza, në vitin 2019 u vranë 13 gra dhe vajza, dhe në vitin 2020 u vranë 9 gra dhe vajza.

- një rast ku viktima u vra nga kunati me probleme të shëndetit mendor;
- një rast ku viktima u vra nga pakujdesia, pasi objektivi i vrasjes ishin persona të tjerë;
- një rast ku viktima u vra nga i biri me probleme të shëndetit mendor.

Raportimet e mëparshme

Lidhur me historikun e dhunës para kryerjes së vrasjes, **dy viktima gra** ishin të pajisura me **urdhër mbrojtjeje** dhe katër prej tyre kishin raportuar dhunën në polici, por me rezultate të ndryshme në trajtimin e çështjeve. Viktimat e pajisura me UM ishin trajtuar nga Komisariati Fier dhe Komisariati Korçë. Konkretisht, një prej viktimave kishte raportuar në Komisaratin e Policisë Elbasan për dhunë në familje dhe ndaj autorit kishte filluar procedimi penal në gjendje të lirë, por viktimës nuk i ishte plotësuar UMM/UM nga policia. Ndërsa një tjetër grua e vrarë kishte raportuar për dhunë në familje në Komisaratin e Gjirokastrës, por nuk i ishte plotësuar UMM/UM, me pretendimin se konflikti mes palëve ishte trajtuar dhe zgjidhur. Një grua tjetër u vra pas raportimit për dhunë në Komisaratin e Elbasanit, ndërkohë që ishte në pritje të shqyrtimit gjyqësor të çështjes me objekt lëshimin e UMM. Gjithashtu, një prej viktimave kishte raportuar rreth një vit përpara vrasjes për dhunë në familje pranë Komisariatit të Policisë nr.6 Tiranë por kishte hequr dorë nga ndjekja e mëtejshme e çështjes.

Tabela nr.1: Vrasjet e grave dhe vajzave dhe femicidet sipas statusit të raportimeve të mëparshme

Raportime	Vrasje	Femicid
Po	6	6
Jo	26	18
UMM/UM	2	2

Nga analiza e materialeve mbi rastet e femicidit rezulton se **në 90% të rasteve, viktimat kishin përjetuar dhunë nga autorët para kryerjes së vrasjes.**

Nga **28 autorët** e identifikuar për kryerjen e vrasjeve, **26 ishin burra dhe djem**, dhe në **dy raste** autore ishin një grua dhe një vajzë; në dy raste autori nuk është gjetur nga organet kompetente dhe çështjet janë në hetim.

Rastet e vlerësuara si femicid u kryen nga 22 autorë, të gjithë burra. Në 16 prej këtyre rasteve, çështjet në ngarkim të autorëve të vrasjeve kanë përfunduar, në gjashtë prej tyre çështja u ankimua dhe është dhënë vendimet nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm. Vazhdojnë të jenë në proces hetimi dy autorë dhe në proces shqyrtimi gjyqësor katër autorë.

Gjatë vitit 2022 u dënuan gjashtë autorë, në vitin 2023 u dënuan katër autorë dhe në vitin 2024 u dënuan gjashtë autorë.

Lidhur me shëndetin mendor të autorëve rezulton se **në katër raste, autorët kishin probleme të shëndetit mendor**, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës, ndërsa një prej autorëve rezultoi i papërgjegjshëm, bazuar në ekzaminimin psikiatriko-ligjor të kryer pas vrasjes.

1.5 Norma e femicidit në Shqipëri dhe krahasimi me vende të tjera³⁸


Norma e femicidit në Shqipëri për vitin 2021 ishte **0,85 për 100.000 popullatë gra dhe vajza**, ndërsa në vitin 2022 kjo normë ra në **0,50**. Krahasimi me vende të tjera të rajonit dhe Bashkimit Evropian për vitin 2021 dhe 2022 tregon se:

- Për vitin 2021, norma e femicidit në Shqipëri ishte **më e lartë** se në Maqedoninë e Veriut, Itali, Slloveni, Serbi, Maltë, Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë, Çeki, Bullgari, Rumani, Greqi, Hungari dhe Mal të Zi.
- Për vitin 2022, norma e femicidit në Shqipëri ishte **më e ulët** se në disa prej këtyre vendeve por **më e lartë** se në Slloveni, Maqedoninë e Veriut dhe Itali.
- Për vitin 2023 norma e femicidit në Shqipëri ishte **më e ulët krahasuar me Maqedoninë e Veriut, por më e lartë se në të gjitha vendet e tjera të përzgjedhura për krahasim.**

Të dhëna nga UNODC	2021	2022	2023
Maqedoni e Veriut	0,28	0,29	0,96
Itali	0,39	0,42	
Slloveni	0,57	0,47	0,28
Shqipëri	0,85	0,50	0,84
Serbi	0,71	0,53	0,65
Maltë	0,62	0,62	0,78
Kroaci	0,67	0,68	0,69
Bosnje dhe Hercegovinë	0,42	0,73	0,78
Çeki	0,47	0,75	0,82
Bullgari	0,79	0,83	0,82
Rumani	0,76	0,84	0,54
Greqi	0,62	0,85	0,34
Hungari	0,53	0,87	0,61
Mal i Zi	0,62	1,86	0,30


³⁸ UNODC ka publikuar të dhëna për femicidet sipas shteteve deri në vitin 2023, te cilat janë llogaritur edhe në normën për 100.000 banorë popullatë femra. Shih: <https://dataunodc.un.org/dp-femicide>;

Grafiku nr.2



Ndërsa krahasuar me disa nga vendet e tjera jashtë kontinentit evropian, gjatë vitit 2023 norma e femicidit në Shqipëri ishte më e ulët se në SHBA, Meksikë, Kosta Rika, dhe Mongoli dhe më e lartë se në Marok, Algjeri dhe Jordani.

Grafiku nr.3




1.6 Analizë e rasteve të vrasjeve të grave dhe vajzave dhe të dhëna mbi viktimat dhe autorët

Të dhëna mbi viktimat:

Grupmosha

Gratë dhe vajzat e vrara gjatë periudhës objekt monitorimi janë të moshave të ndryshme. Numri më i lartë i grave dhe vajzave të vrara i përket grupmoshës 45-49 vjeç, ndjekur nga grupmosha 30-44 vjeç dhe grupmosha mbi 60 vjeç.

Grafiku nr.4



Përkatësia në grupe të ndryshme dhe shtetësia


Sa i përket orientimit seksual të viktimave, rezultojnë se institucionet nuk mbajnë të dhëna mbi këtë aspekt, as për viktimat dhe as për autorët. Sipas informacionit të marrë nga policia, një e dhënë e tillë shënohet vetëm nëse deklarohet vullnetarisht nga autorët. Po ashtu, nuk mbahen të dhëna për përkatësinë etnike të viktimave apo autorëve; regjistrohen vetëm shtetësia dhe kombësia. Nga të dhënat ekzistuese, rezultojnë se të gjitha viktimat ishin me shtetësi dhe kombësi shqiptare. Megjithatë, bazuar në informacionin e marrë nga media dhe monitorimi i proceseve

gjyqësore, një prej viktimave i përkiste pakicës etnike rome. Në Raportin për Shqipërinë të Komitetit të Konventës për Eliminimin e Diskriminimit Racor, shtetit shqiptar iu kërkua të marrë masa për mbajtjen dhe raportimin e këtyre të dhënave.³⁹

Statusi martesor

Në lidhje me statusin martesor të viktimave rezulton se: në rreth 72% të rasteve viktimat ishin të martuara; 26 me fëmijë; 11 prej viktimave ishin me fëmijë nën 18 vjeç dhe një viktimë ishte shtatzënë në momentin e vrasjes.

Grafiku nr.5




Niveli arsimor dhe statusi ekonomik i viktimave

Në lidhje me nivelin arsimor të viktimave rezulton se në 59% të rasteve viktimat ishin me arsim 8/9 vjeçar, ndjekur nga 22 % e viktimave me arsim të mesëm.


³⁹Raporti i Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit Racial, Maj 2024. “Duke kujtuar rekomandimin e tij të mëparshëm dhe rekomandimet e përgjithshme nr. 4 (1973) dhe nr. 24 (1999) në lidhje me nenin 1 të Konventës, Komiteti rekomandon që shteti palë të vazhdojë të zhvillojë mjete të përshtatshme, bazuar në parimet e vetidentifikimit dhe anonimitetit, për të mbledhur të dhëna dhe për të mbledhur informacion mbi përbërjen demografike të popullsisë dhe statusin socio-ekonomik, të ndara sipas **përkatësisë etnike**, gjinisë, moshës, fesë, gjuhës së folur dhe rajonit...”

Grafiku nr.6



Në lidhje me gjendjen socio-ekonomike të viktimave, rezulton se disa prej tyre jetonin në kushte të vështira ekonomike, në banesa me qira, apo ishin rikthyer pranë familjes së tyre të origjinës pas ndarjes. Nga të dhënat rezulton se 14 prej viktimave ishin në marrëdhënie pune në momentin e vrasjes dhe pjesa më e madhe e të punësuarra në sektorin privat. Ndërsa 12 prej viktimave nuk ishin në marrëdhënie pune. Asnjë nga viktimat nuk përfitonte nga programet sociale të strehimit. Dy rastet e pajisura me UM nuk jetonin në të njëjtën banesë me autorin pasi ishin larguar nga banesa.

Grafiku nr.7



Në lidhje me **statusin e aftësisë së kufizuar** rezultojnë se dy prej viktimave të femicidit ishin me aftësi të kufizuara, ato vuanin nga probleme të shëndetit mendor, njëra prej tyre jetonte e vetmuar dhe në kushte shumë të vështira ekonomike.⁴⁰

Në lidhje me **intoksikimin me alkool ose lëndë psikotropike**, nga analizimi i kërkesave për gjykim dhe vendimeve të gjykatës rezultojnë se një viktimë ishte përdoruese e drogës dhe një tjetër përdoruese e alkoolit.⁴¹

Të dhëna mbi autorët

Autorët janë të moshave të ndryshme, ku numri më i lartë i autorëve është i grupmoshës 45-49 vjeç ndjekur nga grupmoshat 30-44 vjeç dhe grupmosha mbi 60 vjeç. Të gjithë kanë lindur në Shqipëri dhe janë me shtetësi shqiptare. Po ashtu, si në rastin e viktimave, institucionet nuk mbajnë të dhëna në lidhje me përkatësinë etnike të autorit, por vetëm për shtetësinë dhe kombësinë. Nga këto të dhëna rezultojnë se të gjitha autorët janë me kombësi dhe shtetësi shqiptare, por nga informacioni i marrë nga media dhe nga monitorimi i proceseve gjyqësore rezultojnë se një prej autorëve i përket pakicës etnike romë.


Nga të dhënat, rezultojnë se në rreth 64% të rasteve, autorët ishin të martuar dhe në 21% të rasteve të pamartuar. Autorët janë të niveleve arsimore të ndryshme: 46% e autorëve ishin me arsim 8/9 vjeçar, ndjekur nga 29% e autorëve me arsim të mesëm, ndërsa tre prej autorëve ishin me arsim të lartë. Rreth 44% e autorëve nuk ishin në marrëdhënie pune, ndërsa 25% e tyre ishin të punësuar.

Të dhënat në lidhje me grupmoshën, gjininë, statusin martesor, nivelin arsimor dhe statusin ekonomik pasqyrohen në grafikun e mëposhtëm:

⁴⁰ Nga informacioni i marrë në media, ajo vuante nga depresioni dhe kishte 10 vite që jetonte pa energji elektrike; po ashtu, viktimja kishte vuajtur dënim me burgim për 5 muaj burg për dhunë në familje, pasi kishte konflikte me familjarët e ish-bashkëshortit.

⁴¹ Ky informacion është siguruar nga policia dhe prokuroria gjatë hetimit të çështjes, kryesisht bazuar në dëshmitë e familjarëve të viktimave.

Grafiku nr.8



Lidhur me shëndetin mendor të autorëve rezultojnë se **në katër raste, autorët kishin probleme të shëndetit mendor**, të vërtetuara me dokumentacionin përkatës, ndërsa një prej autorëve rezultoi i papërgjegjshëm, bazuar në ekzaminimin psikiatriko-ligjor të kryer pas vrasjes, ndaj tij u vendos masa e mjekimit të detyruar në një institucion mjekësor⁴². Njëri prej autorëve ishte nën masën “Kurim i detyruar ambulator” në momentin e vrasjes. Gjithashtu, rezultojnë se 6 autorë ishin përdorues të alkoolit, një autor përdorues i drogës dhe një autor ishte përdorues i drogës dhe alkoolit.⁴³

Për sa i përket recidivizmit, rezultojnë se vetëm tre prej autorëve kishin qenë të dënuar përpara kryerjes së vrasjes. Dy prej autorëve kishin qenë të dënuar për veprën penale të dhunës në

⁴² Ky autor nuk ishte diagnostikuar me probleme të shëndetit mendor përpara vrasjes, as nga dëshmitë nuk rezultojnë që autori vuante nga ndonjë problem i shëndetit mendor.


⁴³ Ky informacion është dhënë nga policia por rezultojnë edhe gjatë shqyrtimit të kërkesave për gjykim dhe vendimeve të gjykatës.

familje, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, ndaj partnereve të tyre, ndërsa një autor kishte qenë i dënuar tri herë përpara kryerjes së vrasjeve.⁴⁴

Nga 28 autorët e vrasjeve të grave dhe vajzave, 22 u ndaluan nga policia në momentin e ngjarjes ose menjëherë pas ngjarjes, gjashtë prej autorëve humbën jetën menjëherë pas vrasjes së viktimës, nga të cilët pesë u vetëvranë dhe një humbi jetën në përpjekje për t’ju shmangur arrestimit nga policia. Dy nga autorët e arrestuar humbën jetën në paraburgim gjatë fazës së hetimeve.

Grafiku i mëposhtëm pasqyron të dhëna në lidhje me intoksikimin, recidivizmin, ndalimin nga organet ligjzbatuese si dhe numrin e autorëve të cilët humbën jetën pas ngjarjes:

Grafiku nr.9




Marrëdhënia ndërmjet autorëve dhe viktimave

Në pjesën më të madhe të rasteve, autorët ishin në marrëdhënie bashkëshortore/ish-bashkëshortore, bashkëjetese/ish-bashkëjetese ndërmjet tyre, por disa prej grave u vranë nga anëtarë të tjerë të familjes, si për shembull, vëllai vrau motrën, motra vrau motrën, kunati vrau

⁴⁴ Sipas të dhënave në vitin 2007, autori kishte vrarë me thikë bashkëshorten e tij të parë (vetëm 22 vjeçe), për të cilën ishte dënuar me 14 vite burgim. Ndërsa në vitin 2003 ai ishte dënuar me 2 vite e 8 muaj burgim për veprën penale “Heqje e paligjshme e lirisë” (neni 110/2 i KP).

kunatën, nusja vrau vjehrrën, vjehri vrau bashkëjetuesen e djalit, etj. Tri prej viktimave u vranë nga persona me të cilët nuk kishin asnjë lloj lidhje familjare apo krushqie.

Grafiku nr. 10



Grafiku nr.11




Tabela nr.2: Marrëdhënia ndërmjet autorëve dhe viktimave

Marrëdhënia ndërmjet autorit dhe viktimës/viktimave	Partneri intim bashkëshorti/ish-bashkëshorti, bashkëjetuesi/ish-bashkëjetuesi i dashuri/ish- i dashuri	Anëtarë të familjes Të afërm gjaku Të afërm nga martesë ose marrëdhënia e birësimit	Tjetër (mik, person i njohur, person i panjohur)
Numri i autorëve	14 autorë vranë bashkëshortet e tyre 1 autor vrau ish-bashkëshorten 1 autor vrau bashkëjetuesen 1 autor vrau ish-bashkëjetuesen	1 autor vrau nënën 2 autorë vranë motrat 1 autorë vrau vjehrrën 1 autor vrau bashkëjetuesen e djalit 3 autorë vranë kunatat 1 autor vrau 2 gra që ishin familjare të ish-bashkëjetueses së tij, ndërsa viktimën e tretë e vrau për arsye hakmarrje ndaj vëllait të saj.	1 autor vrau një grua me të cilën jetonte në të njëjtin fshat 1 autor vrau një vajzë të cilën kishte shumë pak kohë që e njihnte ⁴⁵ 1 autor vrau një vajzë me të cilën nuk kishte njohje, në shenjë hakmarrje ndaj vëllait të saj.

1.7 Harta e vrasjeve të grave dhe vajzave në Shqipëri

Ngjarjet e femicidit kanë ndodhur në bashki të ndryshme të vendit, me numrin më të lartë të rasteve të regjistruara në Fier dhe Elbasan. Asnjë nga vrasjet nuk u krye në zona që gëzojnë statusin e ekstraterritorialitetit.

Tabela nr. 3: Vrasjet e grave dhe vajzave dhe femicidet sipas bashkive, 2021-2023


	Vrasje	Femicid
Dibër	1	0
Durrës	2	2
Elbasan	3	3
Fier	4	4

⁴⁵ Nga të dhënat e prokurorisë rezultojnë se viktimat ishin vrarë pas një konflikti të çastit me autorin, i cili ishte njohur prej saj para pak ditësh (më pak se një muaj). Ata kishin marrëdhënie shoqërore ndërmjet tyre dhe konsumonin drogë të tipit heroinë së bashku. Autori i ka kërkuar viktimës para për të blerë drogë dhe duke qenë se viktimat ka refuzuar t'ja jepte, ka filluar debati ndërmjet tyre, në debat e sipër autori ka nxjerrë thikën dhe e ka goditur viktimën disa herë në trup.

Gramsh	1	0
Kamëz	1	1
Kavajë	1	1
Korçë	1	1
Krujë	1	1
Kuçovë	1	1
Librazhd	1	1
Lushnje	1	1
Malësi e Madhe	1	1
Maliq	1	1
Përmet	2	1
Shkodër	2	2
Mirditë	1	0
Tiranë	6	2
Vau i Dejës	1	1
Gjithsej	32	24

Krimet u kryen kryesisht në banesë, në oborrin e banesës apo në mjediset përreth saj. Disa prej vrasjeve ndodhën në mjedise publike, përfshirë një ngjarje ku viktimat u vra në qendër të qytetit, në praninë e dy djemve të saj, vetëm pak minuta pas daljes nga gjykata. Në këtë incident u plagosën gjithashtu dy persona të tjerë dhe u rrezikuan kalimtarët e rastit.

Grafiku nr.12



Mënyra e kryerjes së veprës penale dhe mjete i përdorur

Në lidhje me mënyrën e kryerjes së vrasjeve, bie në sy fakti që në pjesën më të madhe të rasteve, ato janë kryer me mizori, si për shembull, duke e djegur trupin e viktimës pas vrasjes,⁴⁶ duke e qëlluar shumë herë me plumba, duke e goditur me thikë në shumë pjesë të trupit,⁴⁷ ose duke e goditur me thikë pas qëllimit me armë.⁴⁸ Ngjarjet ndodhën në orë të ndryshme të ditës dhe të natës, por numri më i lartë i tyre u regjistruan pas orës 20:00 të mbrëmjes.

- **12 viktima** u vranë me **armë zjarri**,
- **10 viktima** u vranë me **mjete të mprehta**,
- **1 viktimë** u vra me goditje me **mjet të fortë** (bastun), dhe
- **1 viktimë** u vra nëpërmjet **mbytjes** (shtrëngim me forcë).

Cilësimi ligjor i veprës penale

Në lidhje me cilësimin ligjor të veprave penale, pjesa më e madhe u cilësuan si “*Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare*”, parashikuar në nenin 79/c të Kodit Penal; në tre raste çështja u cilësua si *vrasje me dashje*, parashikuar në nenin 76; një rast u cilësua si “*Vrasje me paramendim*”, parashikuar në nenin 78/2 të Kodit Penal. Në varësi të rrethanave, akuzat ndaj autorëve u rënduan edhe nga dispozita të tjera penale mbi armëmbajtjen pa leje, mbajtjen e armëve të ftohta, ose prishjen e rendit dhe qetësisë publike. Në asnjë nga rastet vrasja nuk u krye në bashkëpunim. Në një rënë prej vrasjeve, e cila u krye në një ambient publik, u akuzuan disa persona për moskallëzim krimi.

Sa i përket hetimit të çështjeve të femicidit, në rastet ku autorët janë gjetur menjëherë pas vrasjes, hetimet janë mbyllur brenda një afati të shkurtër kohor, nga tre muaj deri në 1 vit e 14 ditë.

Në lidhje me motivet e kryerjes së femicidit, rezulton se në pjesën më të madhe të rasteve gratë dhe vajzat u vranë për shkak të xhelozisë dhe mospranimit të ndarjes nga autorët.

Historiku i dhunës së mëparshme

Një ndër elementët më të rëndësishëm që lidhet me kategorizimin e një vrasjeje si femicid (sipas kuadrit statistikor të OKB-së) është prania e dhunës së mëparshme fizike, seksuale ose psikologjike të ushtruar nga autori ndaj viktimës. Ky komponent përfshin analizimin e historisë së mëparshme të dhunës, përmes vlerësimit nëse viktima kishte raportuar ndonjëherë dhunën ndaj saj pranë institucioneve përgjegjëse, apo nëse kjo dhunë ishte identifikuar në mënyra të tjera, si përmes

⁴⁶ Vendimi nr.52, datë 01.02.2022, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kavajë.

⁴⁷ Vendimi nr.1548, datë 04.07.2022, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Autori e ka vranë viktimën në gjumë duke i shkaktuar 8 plagë në pjesë të ndryshme të trupit.

⁴⁸ Vendimi nr.235, datë 27.04.2023, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, “Pas goditjes disa herë me armë, autori e ka goditur edhe me thikë në qafë viktimën që të sigurohej për vdekjen e saj”. Vendimi 1548, datë 04.07.2022 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Autori e ka vranë viktimën në gjumë duke i shkaktuar 8 plagë në pjesë të ndryshme të trupit.

dëshmime nga familjarët ose personat e afërt. Nga analizimi i rasteve rezulton se në pjesën më të madhe të tyre, viktimat kishin përjetuar dhunë më parë nga autorët e vrasjeve.

Në disa raste viktimat e kishin raportuar dhunën në strukturat e policisë, por në raste të tjera dhuna u vërtetua përmes dëshmime të dhëna nga familjarët e viktimave. Përveç kësaj, disa prej vrasjeve janë kategorizuar si femicide bazuar në mizorinë me të cilën u kryen. Autorët e disa prej këtyre krimeve kishin precedentë penalë për veprime të mëparshme që lidhen me dhunën me bazë gjinore ose dhunën në familje.

KREU II - HETIMI DHE GJYKIMI I VRASJEVE TË GRAVE DHE VAJZAVE NË SHQIPËRI

2.1 Koordinimi ndërinstytucional për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës

Koordinimi i punës ndërmjet strukturave përgjegjëse për trajtimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore është një hap i rëndësishëm për reduktimin e kësaj dukurie dhe parandalimin e rasteve të femicidit. Zhvillime thelbësore në këtë drejtim janë ndryshimet e vitit 2018 dhe 2020 të Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”; VKM nr. 327, datë 2.06.2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”; dhe “Protokolli i menaxhimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor”,⁴⁹ i miratuar në vitin 2020, që përcaktojnë hapat e nevojshëm për trajtimin dhe dokumentimin e rasteve të dhunës në familje. Këto akte kanë sjellë një rritje të përgjegjshmërisë për trajtimin e rasteve dhe krijimin e Mekanizmave Kombëtarë të Referimit (MKR) në të 61 bashkitë e vendit. Megjithatë, zbatimi i legjislacionit, dhe në veçanti i Protokollit, mbetet në fazat fillestare dhe kërkon një angazhim më të madh nga çdo anëtar i MKR-ve për të siguruar trajtimin efikas të rasteve.

Lidhur me funksionimin e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit, bazuar në raportet e organizatave të shoqërisë civile³⁹ rezulton se disa nga institucionet përgjegjëse nuk janë pjesë aktive e këtij mekanizmi dhe kanë dhënë kontribut minimal në adresimin e nevojave të rasteve të trajtuara. Trajtimi i rastit (vlerësimi i riskut, monitorimi dhe ekzekutimi i UMM/UM) duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë midis punonjësit të policisë dhe koordinatorit vendor. Megjithëse aktet nënligjore⁴⁰ që kanë parashikuar modalitetet e trajtimit të përbashkët të rasteve të dhunës në familje kanë hyrë në fuqi prej disa kohësh, ndjekja e kësaj praktike ka rezultuar në një numër shumë të ulët rastesh.

⁴⁹ “Protokolli i Menaxhimit të Rasteve të dhunës në familje në nivel vendor, përmes Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR)”, është një dokument shumë i rëndësishëm i cili synon të standardizojë veprimet e nevojshme për t’u kryer nga të gjithë anëtarët e MKR-ve për të siguruar një reagim të menjëhershëm, gjithëpërfshirës e me përgjegjshmëri, në përputhje me kompetencat dhe detyrimet e tyre ligjore, për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe vënien e dhunuesve përpara përgjegjësisë.

Në mënyrë të veçantë duhet të rritet roli dhe kontributi i institucioneve shëndetësore, të cilat në bazë të legjislacionit në fuqi kanë një sërë detyrimesh për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Institucionet shëndetësore duhet të jenë pjesë aktive e zgjidhjes së problematikave dhe mbështetjes së viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Prokuroria, si një institucion tepër i rëndësishëm në përbërje të MKR-ve, duhet të ketë një qasje që ka në qendër viktimën dhe adresimin e nevojave të saj. Pajisja e viktimave me prova shkresore, siç është akti i ekspertimit mjeko-ligjor apo ekstrakte të tjera të dosjes, duhet të jetë një procedurë lehtësisht e aksesueshme nga viktimat, pasi këto dokumente mund të përdoren si prova në procesin gjyqësor me objekt lëshimin e urdhrit të mbrojtjes. Në raportin Avokatit të Popullit “Mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri për periudhën janar 2020 - shtator 2021” një nga rekomandimet e dhëna lidhet me ndryshimin dhe përmirësimin e legjislacionit ekzistues për t’u dhënë mundësinë viktimave të dhunës në familje të paraqiten drejtpërdrejt pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore për t’u ekzaminuar pa qenë nevoja e pajisjes më parë të tyre me vendim nga organi procedues ose Avokati i Popullit.⁵⁰

Megjithëse Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i jep të drejtë prokurorisë të kërkojë urdhër mbrojtjeje për një të rritur apo një të mitur, gjatë gjithë këtyre viteve në asnjë rast nuk kemi konstatuar ngritje të padisë publike nga institucioni i prokurorisë.

Sipas një studimi të kryer nga Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (IEBGJ) mbi femicidin në Bashkimin Evropian,⁵¹ profesionistët dhe viktimat e intervistuar theksojnë se parandalimi i femicideve lidhet ngushtë me përmirësimin e reagimit ligjor ndaj dhunës në familje. Për të arritur këtë, kërkohet ndërhyrje e hershme, ofrim i mbrojtjes dhe mbështetjes për viktimat dhe zgjidhje e menjëhershme e çështjeve të kujdestarisë së fëmijëve dhe përgjegjësisë prindërore. Autorët e dhunës duhet të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre, përmes garantimit që sistemi ligjor të jetë i shpejtë dhe efektiv.

Pas hapjes së negociatave për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, një nga detyrimet kryesore është përafrimi i legjislacionit vendas me standardet e BE-së për mbrojtjen e viktimave të dhunës dhe forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë. Kjo përfshin edhe Direktivën e BE-së kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.⁵²

Sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë, numri i rasteve të evidentuara dhe të denoncuara për dhunë në familje ka ardhur në rritje vit pas viti. Sipas statistikave nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në tre vitet e fundit janë trajtuar 15586 raste të dhunës në familje, që përbën një

⁵⁰ Raporti gjendet në: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rrapporte-speciale-1/>

⁵¹ Raporti i IEBGJ-së “Përmirësimi i përgjigjes ligjore për luftimin e femicidit në Bashkimin Evropian”, viti 2023.

Shih: https://eige.europa.eu/publications-resources/publications/improving-legal-responses-counter-femicide-european-union-perspectives-victims-and-professionals?language_content_entity=en;

⁵² “Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, viti 2024. Shih: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/PE-33-2024-INIT/en/pdf> ;

rritje me 2677 raste krahasuar me periudhën 2018-2020, kur u raportuan 12909 raste. Për sa i përket kërkesëpadive për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes (UMM/UM), ka një rritje të lehtë prej 247 rastesh në tre vitet e fundit (2021-2023).⁵³


Tabela nr.4: Numri i rasteve të dhunës në familje të trajtuara nga policia

Viti	Numri i rasteve të DHF të trajtuara	Numri i kërkesëpadive për lëshimin e UMM/UM	Numri i grave dhe vajzave të dëmtuara nga dhuna në familje	Numri i autorëve të proceduar penalisht	Numri i autorëve të arrestuar
2021	5312	3266	3960	1631	638
2022	5210	2940	3767	1887	682
2023	5064	2730	3649	1911	699

Këto të dhëna pasqyrohen më poshtë në grafikët nr.13 dhe nr.14.


Nga këto të dhëna rezulton se strukturat e Policisë së Shtetit gjatë kësaj periudhe kanë trajtuar një numër të lartë rastesh të dhunës në familje. Pavarësisht se numri i rasteve të vrasjeve të grave në raport me numrin e raportimeve është i ulët, është e domosdoshme të vihen në lëvizje mekanizma të forcuara që kontribuojnë në rritjen e efikasitetit në identifikimin e rasteve dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore.

Grafiku nr.13



⁵³ Raporti i Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare “Vrasjet e grave (femicidi) dhe tentativa për femicid në Shqipëri 2017-2020”, viti 2021, faqja 35.

Grafiku nr.14



Raporti i INSTAT-it “Burra dhe gra 2023” tregon se qarku me numrin më të lartë të grave të dëmtuara nga dhuna në familje është Tirana, ndjekur nga Durrësi dhe Vlora.⁵⁴ Këto janë edhe qarqet me numrin më të lartë të popullsisë në vend.

Sipas një studimi të kryer nga qendra “Të drejtat e njeriut në demokraci” mbi rolin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në trajtimin e çështjeve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, gjatë viteve 2020-2021 janë shqyrtuar 1920 kërkesëpadi për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes (UMM) ose urdhrin të mbrojtjes (UM). Nga këto, 53% e çështjeve janë pranuar ose pranuar pjesërisht, ndërsa 47% janë pushuar ose rrëzuar.⁵⁵

Nga të dhënat e mbledhura dhe të analizuar në kuadër të këtij raporti, identifikohen problematika kryesore që lidhen me mbajtjen e të dhënave, trajtimin e rasteve dhe mungesën e koordinimit ndërmjet institucioneve kryesore përgjegjëse (policia, bashkitë dhe institucionet shëndetësore) për të garantuar mbrojtjen e viktimave. Trajtimi i rasteve në mënyrë të koordinuar që nga momenti i vlerësimit të rrezikut, njoftimi i viktimave për lirim dhe dhunuesve dhe monitorimi i tyre pas lirit, si dhe trajtimi i fëmijëve të prekur nga femicidi në përputhje me nevojat e tyre, janë çështje urgjente që kërkojnë ndërhyrje institucionale.

⁵⁴ Raporti i INSTAT-it “Burra dhe gra 2023”, viti 2023, faqja 90.

⁵⁵ Studimi i qendrës “Të drejtat e njeriut në demokraci”: “Sistemi gjyqësor si pararendës në mbrojtjen e të drejtave të viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, periudha e monitorimit 2020-2021, viti 2022.

2.2 Roli i policisë në trajtimin e rasteve të dhunës dhe parandalimin e femicidit

Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, policia është aktori kyç në trajtimin dhe adresimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Bazuar në raporte të ndryshme të përgatitura nga organizatat e shoqërisë civile, rezulton se rreth 99% e rasteve paraqiten pranë komisariateve të policisë për të denoncuar dhunën e pësuar. Tradicionalisht këto institucione, të vëna në lëvizje nga palët, nisin procedurën për plotësimin e kërkesëpadisë për lëshimin e UM/UMM-ve nga gjykata. Por, me ndryshimet ligjore të vitit 2018, policia u pajis me kompetencën për të lëshuar urdhra për masë paraprake të mbrojtjes së menjëhershme (UMPMM), si një mjet efektiv për mbrojtjen e menjëhershme të viktimave.⁵⁶ Kjo prerogativë e policisë është në përputhje me nenin 52 të Konventës së Stambollit, sipas të cilit, në situata të rrezikut të menjëhershëm, autoritetet kanë kompetencën të lëshojnë një urdhër ndalimi emergjent. Nëpërmjet këtij mjeti mbrojtës bëhet e mundur që viktima të merret në mbrojtje menjëherë pas raportimit në polici dhe të mos lihet pa mbrojtje deri në lëshimin e UMM-së nga gjykata.

Sipas legjislacionit, menjëherë pas identifikimit ose raportimit të rastit të dhunës në familje, titullari i strukturës përgjegjëse në polici duhet të marrë të gjitha masat për të ndaluar dhunën, për të kryer procedurat për vlerësimin e riskut dhe lëshimin e UMPMM-së.⁵⁷ Vlerësimi i riskut për sigurinë e viktimës është një hap thelbësor që duhet të kryhet për **çdo rast raportimi të dhunës**. Punonjësi i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit të riskut njofton koordinatoren e dhunës në njësinë përkatese të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, është e domosdoshme që policia të koordinojë punën edhe me strukturat e tjera përgjegjëse dhe të dëgjojë e të adresojë nevojat e viktimës në mënyrë të përshtatshme.

Moskryerja e vlerësimit të riskut përbën shkelje të kuadrit ligjor në fuqi dhe bie ndesh me Konventën e Stambollit dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ky vlerësim jo vetëm që mat nivelin e rrezikshmërisë me të cilën përballet viktima, por gjithashtu identifikon faktorët që duhet të merren në konsideratë gjatë trajtimit dhe monitorimit të rastit në vijim. Rezulton se në rastet kur viktimat kishin raportuar për dhunë në familje, por nuk iu ishte plotësuar UMM/UM nga policia, nuk ishte kryer vlerësimi i riskut për sigurinë e viktimës. Gjithashtu problematika janë konstatuar edhe sa i përket mënyrës së kryerjes së vlerësimit të riskut ku, në njërin prej rasteve të shqyrtuara, fakti që autori kishte qenë i dënuar më parë nuk u vlerësua si element rreziku për sigurinë e viktimës.

⁵⁶ Kur nga kryerja e vlerësimit të riskut rezulton se dhuna e ushtruar paraqet rrezik për jetën, shëndetin dhe lirinë e anëtarëve të familjes, strukturat përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit, marrin menjëherë masa paraprake për mbrojtjen e viktimës dhe për ndalimin e dhunës, duke lëshuar urdhër për masë paraprake të mbrojtjes së menjëhershme (UMPMM). Brenda 48 orëve nga marrja e masës, organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit, paraqesin përpara gjykatës kërkesë për vlerësimin e masës paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe kërkesëpadi për lëshimin e urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes.

⁵⁷ Në zbatim të detyrimeve ligjore, u miratua Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 866, datë 20.12.2018, "Për miratimin e modelit dhe të procedurave për vlerësimin e riskut për rastet e dhunës në familje", i cili përcakton procedurat për kryerjen e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit dhe modelin e këtij vlerësimi dhe Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.912, datë 27.12.2018, "Për procedurat dhe modelin e urdhrat për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme".

Bazuar në çështjen *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1998) mbi përgjegjësinë e shteteve për mbrojtjen e jetës prej sulmeve të personave të tjerë, në çështjen *Kurt kundër Austrisë* (2021), si dhe në çështje të tjera në vijim që kanë të bëjnë me këto përgjegjësi në kontekstin e dhunës në familje, GJEDNJ-ja ka përcaktuar tre parimet kryesore në vijim të zbatueshme në kuadër të vlerësimit të riskut, kur shqyrtohet nëse autoritetet kanë marrë “masa parandaluese operacionale për të mbrojtur jetën e viktimës” në kontekstin e dhunës në familje:

- Autoritetet shtetërore “duhet të përgjigjen menjëherë në rastet e akuzave për dhunë në familje”.
- Kur njoftohen për raste të dhunës në familje, autoritetet duhet të kontrollojnë nëse ekziston një “rrezik real dhe i menjëhershëm për jetën e një ose më shumë viktimave të identifikuar”. Kjo duhet bërë nëpërmjet një “vlerësimi të pavarur, proaktiv dhe gjithëpërfshirës të rrezikut”. Autoritetet duhet gjithashtu “të marrin parasysh kontekstin specifik të dhunës në familje kur vlerësojnë rrezikun real dhe të menjëhershëm”.
- Nëse vlerësimi i mësipërm i riskut përcakton se ekziston kërcënim real dhe i menjëhershëm për jetën, autoritetet “duhet të marrin masa parandaluese operacionale për të shmangur këtë rrezik” dhe këto masa duhet të jenë “të përshtatshme dhe proporcionale me nivelin e vlerësuar të rrezikut”.⁵⁸

Në raportin e vlerësimit tematik për Shqipërinë, GREVIO vëren se policia heziton të përdorë plotësisht këtë instrument. Sipas këtij raporti, në vitin 2021 policia ka lëshuar 415 UMPMM dhe në vitin 2022 424 UMPMM, një numër i ulët kundrejt numrit të raportimeve për dhunë në familje. Gjithashtu GREVIO vëren problematika në lidhje me kryerjen e vlerësimit të rrezikut, sikurse është mosmarrja parasysh e të gjithë treguesve të rrezikut, duke ndikuar ndonjëherë në klasifikimin e pasaktë të rasteve ku lëshimi i UMPMM-së është i domosdoshëm. Këto problematika janë më të dukshme në bashki më të vogla se Tirana, në disa prej të cilave asnjë rast nuk ishte pajisur me urdhër të tillë.⁵⁹

Trajtimi i rasteve, që përfshin vlerësimin e rrezikut, monitorimin dhe ekzekutimin e UMM/UM-ve, duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë midis punonjësve të policisë dhe koordinatorëve vendorë. Megjithëse tashmë janë në fuqi akte nënligjore që rregullojnë modalitetet e trajtimit të përbashkët të rasteve, numri i rasteve të trajtuara sipas këtyre rregullave mbetet shumë i vogël. Policia e Shtetit, si institucioni i parë ku viktimat raportojnë në rreth 99% të rasteve, duhet të rrisë bashkëpunimin me koordinatorët vendorë dhe institucionet shëndetësore, të cilat kanë detyrime specifike për trajtimin e dhunës sipas legjislacionit në fuqi.

⁵⁸ Tkhelidze kundër Gjeorgjisë (2021); A.A. dhe B. kundër Gjeorgjisë (2022); Gaidukevich kundër Gjeorgjisë; Y dhe të tjerët kundër Bullgarisë, (2022); Luca kundër Republikës së Moldavisë (2023).

⁵⁹ Raporti i parë i vlerësimit tematik për Shqipërinë i Grupit të Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO), “Ndërtimi i besimit duke ofruar mbështetje, mbrojtje dhe drejtësi”, shtator 2024.

Gjithashtu, nga analizat dhe raportet e organizatave të shoqërisë civile konstatohet se shumë raste të raportuara në polici nuk trajtohen në mënyrë të koordinuar, duke bërë që nevojat e viktimave të mos adresohen në përputhje me legjislacionin. Në mënyrë që zinxhiri mbrojtës të funksionojë siç duhet, pas raportimit në polici, rasti duhet të lidhet me koordinatorin vendor, i cili duhet të organizojë anëtarët e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor (ETN) për të ndjekur sigurimin e shërbimeve të nevojshme për viktimën, për të mbështetur ecurinë e saj, dhe për të marrë masa për rehabilitimin e autorit.

Numri i lartë i rasteve të raportuara dhe kompleksiteti i trajtimit të tyre krijojnë vështirësi për një koordinator vendor në nivel bashkie, sidomos në bashkitë e mëdha. Për këtë arsye, është e nevojshme që çdo njësi administrative të ketë një person përgjegjës për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, siç parashikohet edhe nga ndryshimet e bëra në vitin 2018 në Ligjin “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cili i pajis njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe koordinatorët vendorë me kompetenca shtesë, përfshirë ato për monitorimin dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për lëshimin e UMM/UM-ve.⁶⁰

Në kuadër të analizës së rolit të policisë në trajtimin e rasteve të DHBGJ-së dhe DHF-së, është kërkuar informacion i detajuar në lidhje me rastet kur viktimat kishin raportuar dhunë në familje përpara vrasjes.⁶¹

Konstatime:

Nga analiza e informacionit të siguruar nga drejtoritë vendore të policisë janë evidentuar problematikat e mëposhtme:

- Mosplotësimi i UMM/UM-ve paralelisht me procedimin penal për dhunën në familje;
- Procedimi i dhunuesve në gjendje të lirë, edhe pse ata kishin precedentë të mëparshëm për ushtrimin e dhunës;
- Moskryerja e vlerësimit të rrezikut, edhe kur viktimat kishin bërë kallëzim për dhunë në familje;
- Procedimi i dhunuesve i varur nga vullneti i viktimës për të bërë kallëzim, edhe pse dhuna në familje është një vepër penale që ndiqet kryesisht;
- Vlerësimi i rrezikut si “i moderuar”, edhe kur viktimat shprehej se ndihej e rrezikuar për jetën;
- Rastet kur, pavarësisht rrezikut të lartë të konstatuar dhe gjendjes psikologjike të rënduar të viktimës, plotësohej vetëm urdhri i mbrojtjes (UM), i cili shqyrtohet nga gjykata 14 ditë pas raportimit, dhe jo urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes (UMM);

⁶⁰ Ligji nr. 47/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’”, i ndryshuar.

⁶¹ Ky informacion përfshinte kryerjen e vlerësimit të rrezikut për sigurinë e viktimës në momentin e raportimit - . Niveli i rrezikut i vlerësuar nga policia, monitorimi i respektimit të UMM/UM-së nga policia, bashkëpunimi me koordinatorin vendor, punonjësien përgjegjës ose anëtarë të tjerë të MKR-së, informacioni në lidhje me nivelin e rrezikshmërisë së autorit, marrja e dëgjimit në kohë për lirimin nga burgu të dhunuesve, mbajtja nën vëzhgim e rasteve, referimi i rasteve në struktura të tjera apo organizata joqeveritare (OJF).

- Mungesa e njoftimit në kohë për policinë dhe viktimën në rastet e lirimit nga burgu të dhunuesve.

Në dy raste specifike, në të cilat viktimave nuk u ishte plotësuar UMM/UM-ja paralelisht me procedimin penal, arsyeja e dhënë ishte se viktima nuk kishte pranuar të plotësohej UM, duke kërkuar vetëm kallëzim penal. Megjithatë, sipas frymës së legjislacionit kundër dhunës në familje, është e domosdoshme që paralelisht me procedimin penal të dhunës në familje të plotësohet edhe kërkesa për lëshimin e UMM/UM-së, pavarësisht vullnetit të viktimës. Viktima ka të drejtën të mos paraqitet në gjykatë ose të kërkojë pushimin e UMM/UM-së, nëse nuk është dakord me lëshimin e urdhrit.

Rezulton se në asnjë nga rastet e shqyrtuara, policia nuk e kishte pajisur viktimën me UMPMM, edhe pse kjo masë është një mjet efektiv për mbrojtjen e menjëhershme të viktimave. Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe Konventën e Stambollit vlerësimi i riskut për sigurinë e viktimës është një hap thelbësor që duhet të kryhet për çdo rast raportimi të dhunës.

Procedimi penal i dhunuesve duhet të trajtohet me kujdes të veçantë, duke shqyrtuar çdo element që lidhet me rrezikshmërinë e tyre. Sugjerohet që të shmanget procedimi në gjendje të lirë i dhunuesve me precedentë të mëparshëm për ushtrimin e dhunës, pasi kjo rrit ndjeshëm rrezikun për viktimat.

Një problematikë tjetër e rëndësishme është mosnjoftimi në kohë i policisë për rastet e lirimit nga IEVP-të të autorëve të dënuar për dhunë ndaj grave. Policia duhet të informohet në kohë dhe të marrë masa të menjëhershme për të monitoruar sjelljet e këtyre autorëve, veçanërisht kur ata përfaqësojnë rrezik të lartë për viktimat.

Trajtimi dhe adresimi i rasteve ku autorët e dhunës paraqesin çrregullime të shëndetit mendor kërkon vëmendje tepër të veçantë dhe monitorim të vazhdueshëm. Në disa raste autorët pretenduan se kishin probleme të shëndetit mendor, por vetëm një autor rezultoi i papërgjegjshëm pas kryerjes së ekspertimit psikiatriko-ligjor gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Në 2 raste autorët që kishin probleme të shëndetit mendor u vetëvranë menjëherë pas kryerjes së krimit.

2.3 Roli i prokurorisë dhe gjykatave si pjesë e MKR-ve

Prokurorët dhe gjyqtarët luajnë një rol kyç në përgjigjen e sistemit të drejtësisë ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Ata duhet të sigurojnë respektimin e parimit të kujdesit të duhur (*due diligence*) për parandalimin, hetimin dhe ndëshkimin e dhunës. Gjithsesi, në praktikë, lëshimi i urdhrave të mbrojtjes, ndjekja penale dhe gjykimi i rasteve të dhunës me bazë gjinore

mbetet një detyrë sfiduese. Është e domosdoshme që prokurorët dhe gjyqtarët të interpretojnë legjislacionin në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me një qasje të ndjeshme gjinore.

Prokuroria, si pjesë e Mekanizmave Kombëtarë të Referimit (MKR), duhet të ketë një qasje me në qendër viktimën, duke siguruar që nevojat e saj të adresohen. Pajisja e viktimave me prova shkresore, si akti i ekspertimit mjeko-ligjor apo ekstrakte nga dosjet, duhet të jetë një procedurë lehtësisht e aksesueshme, pasi këto dokumente janë thelbësore për proceset gjyqësore për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes. Edhe pse ligji i jep prokurorisë të drejtën të kërkojë urdhër mbrojtjeje për të mitur ose të rritur, deri më tani nuk ka pasur asnjë rast të ngritjes së një padie publike nga prokuroria.

Lidhur me mbrojtjen ligjore, sipas raportit të vitit 2022 të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, u mbështetën me këshillim ligjor 819 viktima të dhunës në familje, por nuk jepen shifra të ndara sipas kategorive të përfitueseve të ndihmës juridike dytësore, apo për rastet e përfaqësuar me avokat falas.⁶²

Gjatë vitit 2023 rezultoi se 1131 raste të dhunës në familje kanë përfituar ndihmë juridike parësore ose këshillim ligjor.⁶³ Megjithatë, vetëm 112 raste janë përfaqësuar në gjykatë.⁶⁴ Raporti nuk specifikon nëse këto të dhëna lidhen me çështje civile për pajisjen me masa mbrojtëse (UMM/UM), apo procese penale ku gratë janë viktima të dhunës. Ky numër mbetet shumë i ulët krahasuar me numrin e lartë të rasteve vjetore.

Edhe pse numri i rasteve të mbështetura nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është rritur nga viti në vit, Avokati i Popullit konstaton se është ende e nevojshme të rritet mbështetja me ndihmë ligjore, sidomos në rajonet ku kjo ndihmë është më e kufizuar. Kjo mund të arrihet përmes angazhimit më të madh të zyrave të ndihmës juridike falas si pjesë aktive e MKR-ve, duke siguruar që më shumë viktima të përfitojnë ndihmë juridike falas, që është parakusht për pajisjen me urdhër mbrojtjeje dhe përfshirjen në shërbimet mbështetëse.

2.4 Monitorimi i urdhrave të mbrojtjes

Vendimi për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes së menjëhershme (UMM) ose urdhrave të mbrojtjes (UM) ekzekutohet menjëherë nga strukturat e Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me shërbimin përbarimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim kanë banimin e përhershëm ose të përkohshëm.

⁶² Analiza vjetore e performancës 2022, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, shih : <https://ndihmajuridike.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/analiza-performances-DNJF-2022-2.pdf>

⁶³ Sipas Ligjit Nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", viktimat e dhunës në familje të pajisura me UMM/UM përfitojnë ndihmë juridike falas pavarësisht nivelit të të ardhurave ekonomike të tyre.

⁶⁴ Analiza vjetore e performancës 2023, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, faqja 23, shih : <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/analiza-statistikore/analiza-statistikore-2023/>

Sipas statistikave nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH), gjatë tre viteve të fundit janë evidentuar 478 raste të shkeljeve të urdhrave të mbrojtjes, të ndara si vijon:

- 169 raste gjatë vitit 2021;
- 157 raste gjatë vitit 2022, dhe
- 152 raste gjatë vitit 2023.

Këto të dhëna theksojnë nevojën për një monitorim të vazhdueshëm të respektimit të urdhrave të mbrojtjes, me qëllim parandalimin e përshkallëzimit të dhunës.

Gjatë periudhës së zbatimit të vendimit gjyqësor për UMM/UM, zyra e shërbimeve sociale e njësisë së vetëqeverisjes vendore ka përgjegjësi të monitorojë respektimin e urdhrat nga palët dhe për të përgatitur një raport çdo 60 ditë, duke informuar Policinë e Shtetit për secilin rast.

Raporti tematik i GREVIO-s për Shqipërinë i vitit 2024, nxit autoritetet shqiptare të shtojnë përpjekjet për të zbatuar dhe monitoruar urdhrat e mbrojtjes. Gjithashtu, raporti kërkon sigurimin e sanksioneve penale që janë efektive, proporcionale dhe bindëse për autorët që shkelin urdhrat e mbrojtjes, duke theksuar rëndësinë e një qasjeje të rreptë për të garantuar mbrojtjen e viktimave dhe për të parandaluar dhunën e mëtejshme.

Konstatime:

Sipas informacionit të siguruar nga bashkitë, monitorimi i respektimit të UMM/UM realizohet kryesisht përmes mbajtjes së kontakteve me telefon me viktimën, ose përmes pyetjeve të drejtpërdrejta në rastet kur viktimat paraqiten pranë bashkisë për marrjen e shërbimeve.

Në të dy rastet që viktimat ishin të pajisura me UM në momentin e vrasjes, nga bashkitë përkatëse nuk ishte përgatitur raport monitorimi në lidhje me ecurinë e zbatimit të masave mbrojtëse. Avokati i Popullit gjen rastin të sjellë në vëmendje se përgatitja e raportit të monitorimit është detyrim ligjor i parashikuar në Ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.

2.5 Roli i bashkive/koordinatorit vendor për dhunën në familje

Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, bashkitë luajnë rol thelbësor në trajtimin dhe adresimin e çështjeve që lidhen me dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore. Në këtë kontekst, është kërkuar informacion specifik nga bashkitë për rastet kur ishte raportuar më parë dhunë në familje, për gjendjen social-ekonomike të familjeve të viktimave që nuk kishin raportuar dhunë para vrasjes, si dhe për shërbimet që mund të kishin marrë ato nga bashkia.⁶⁵

⁶⁵ Në rastet e viktimave që kishin raportuar dhunë më parë, është kërkuar informacion nëse këto raste ishin referuar tek koordinatori vendor ose punonjësi përgjegjës për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, nëse ishin trajtuar nga Ekipi Teknik Ndërdisciplinor (ETN) pranë bashkisë përkatëse, dhe nëse punonjësit përgjegjës kishin dijeni për rrezikshmërinë e autorëve. Gjithashtu, është kërkuar informacion mbi monitorimin e

Për viktimat e pajisura me UMM/UM, koordinatori vendor kishte dijeni për rastin, por nuk kishte marrë pjesë në procedurat për vlerësimin e rrezikut të viktimës nga komisariati i policisë. Në rastet ku viktimat e kishin raportuar më parë dhunën në polici, rezulton se koordinatorët vendorë nuk ishin informuar nga policia ose nga anëtarë të tjerë të Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR). Gjithashtu, asnjë prej këtyre rasteve nuk ishte trajtuar në mbledhjet e ETN-ve dhe koordinatorët vendor nuk kishin informacion për rrezikshmërinë e autorëve.

Në rastet e viktimave të pajisura me UM, bashkitë i trajtonin viktimat me ndihmë ekonomike si viktima të dhunës dhe mbanin kontakte me to përmes punonjësve përgjegjës përkatës. Kontaktet me viktimat mbaheshin nëpërmjet telefonit ose gjatë paraqitjes së viktimës në bashki. Rezulton se monitorimi i rasteve nuk kryhej në përputhje me legjislacionin në fuqi, i cili ka parashikuar qartë rolin proaktiv të punonjësve vendorë sa i përket monitorimit të UMM/UM-ve.

Nga përgjigjet e bashkive rezulton se për viktimat që nuk ishin pajisur me UMM/UM, këto institucione nuk kishin asnjë informacion mbi gjendjen social-ekonomike të tyre dhe viktimat nuk kishin përfituar shërbime nga bashkitë.

Një nga problematikat kryesore të evidentuara është mosnjohimi i koordinatorit vendor për rastet kur autori i dhunës lirohet nga burgju. Sipas legjislacionit, koordinatori vendor duhet të mbajë kontakte të vazhdueshme me policinë. Megjithatë, në një nga rastet e shqyrtuara rezultoi se lirimi i një autori nga I EVP Krujë, me kusht masën e mjekimit të detyruar ambulator dhe qëndrimin nën kujdesin e një familjari, nuk i ishte njoftuar koordinatorit vendor dhe, më pas, personi i liruar kreu një vrasje.

Për rastet e lirimit të dhunuesve nga dënimi me heqje lirie, është e domosdoshme që, përveçse të njoftojë policinë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve duhet të informojë menjëherë edhe viktimën dhe koordinatorin vendor për të mundësuar marrjen e masave parandaluese. Në funksion të parandalimit të ngjarjeve të rënda, duhet që të gjitha strukturat përgjegjëse të përcjellin informacionin në kohë dhe të koordinojnë punën për mbështetjen e viktimave. Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve mbetet element kyç për zbatimin efektiv të masave mbrojtëse dhe për përfshirjen e viktimave në programe mbështetëse.

2.6 Roli i qendrave shëndetësore

Fryma e legjislacionit kundër dhunës në familje synon ofrimin e një shërbimi të shpejtë dhe të thjeshtë nga institucioni përgjegjës më i afërt, përfshirë policinë, njësitë vendore, institucionet

respektimit të urdhrave të mbrojtjes nga koordinatori vendor, kontaktet e mbajtura me viktimën dhe bashkëpunimin me strukturat e policisë si dhe në lidhje me shërbimet e ofruara. Në lidhje me rastet kur viktimat kanë pasur fëmijë të mitur është kërkuar informacion nëse punonjësi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve ka marrë kontakt me ta, në lidhje me shërbimet e ofruara, dhe nëse fëmijët janë vendosur nën kujdestari.

shëndetësore dhe gjykatat. Në këtë kuadër, institucionet shëndetësore kanë detyrimin të ofrojnë ndihmë mjekësore, sociale dhe psikologjike për viktimat e dhunës në familje. Ato duhet të evidentojnë çdo rast dhune në dokumentacionin e posaçëm mjekësor dhe të pajisin viktimat me raportet mjekësore përkatëse.

Rezulton se institucionet shëndetësore nuk kishin trajtuar asnjë nga viktimat që më parë kishin raportuar në polici, në përputhje me procedurën e parashikuar nga legjislacioni në fuqi për trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare. Një nga viktimat e femicidit u trajtua pranë Spitalit Universitar të Traumës pas plagosjes së rëndë nga bashkëshorti i saj, ajo gjeti vdekjen rreth tre javë pas shtrimit në spital.

Sipas raporteve alternative të përgatitura nga organizatat e shoqërisë civile që i janë paraqitur mekanizmave ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut si Komiteti i KEGJFDG-së, GREVIO dhe Grupi i Punës për Rishikimin Periodik Universal (RPU), institucionet shëndetësore vazhdojnë të kenë një kontribut minimal në identifikimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, si dhe në evidentimin e tyre në dokumentacionin e posaçëm mjekësor. Kjo konfirmohet edhe nga të dhënat e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, sipas të cilave numri i rasteve të dhunës të trajtuara nga institucionet shëndetësore është shumë i ulët në raport me numrin e raportimeve të dhunës në rang kombëtar.

Në përputhje me rekomandimet e Grupit të Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO), institucionet shëndetësore duhet të rrisin përpjekjet për të ofruar mbështetje dhe trajtim për rastet e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përfshirë identifikimin, trajtimin dhe dokumentimin sistematik të tyre.

2.7 Roli i organizatave të shoqërisë civile (OSHC)

OSHC-të luajnë një rol të rëndësishëm në trajtimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, por kontributi i tyre ende mbetet i kufizuar pasi në shumë raste varet nga burimet financiare të donatorëve. Në një prej rasteve të shqyrtuara, policia e referoi rastin të një organizatë për të siguruar mbështetje ligjore për viktimën, e cila i ofroi viktimës mundësinë e akomodimit në një strehë të sigurt. Por gruaja e refuzoi këtë mundësi dhe kërkoi të ndihmohej në gjetjen e një pune.⁶⁶ Avokati i qendrës e informoi zyrtarin e policisë së zonës (ZPZ) për historikun e dhunës së autorit dhe rrezikshmërinë e tij, duke kërkuar monitorim të situatës. Megjithatë, viktimja u vra 48 orë pas raportimit të dhunës në polici.

Vlen të përmendet se organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol tepër të rëndësishëm sa i përket informimit dhe ndërgjegjësimin të komunitetit për çështjet e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, si dhe nëpërmjet ngritjes së shërbimeve mbështetëse për të mbijetuarat nga dhuna.

⁶⁶ Rasti i J.E., trajtuar nga organizata "Forumi i Gruas Elbasan".

Disa nga këto organizata kanë ngritur prej vitesh strehëza emergjente dhe afatgjata për viktimat dhe kanë kontribuar në mbështetjen dhe rehabilitimin e tyre.

2.8 Roli i familjes dhe komunitetit

Nga analizimi i të dhënave rezulton se familjarët, të afërmit dhe të njohurit e viktimave shpesh ishin në dijeni të konflikteve dhe dhunës së ushtruar ndaj tyre. Në disa raste, familjarët përpiqeshin ta inkurajonin viktimën të ndahej nga autori ose ta nxisnin të raportonte në polici. Në raste të tjera, prindërit ishin në dijeni të dhunës dhe përpiqeshin të ndërmjetësonin për të përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet viktimës dhe bashkëshortit të saj. Dëshmitë e të njohurve të viktimave dhe autorëve tregojnë se në shumicën e rasteve, autorët kishin marrëdhënie të mira me të tjerët dhe nuk njiheshin si persona të dhunshëm nga komuniteti. Megjithatë, nuk u evidentua asnjë rast kur familjarët apo anëtarët e komunitetit kishin informuar policinë për dhunën e ushtruar ndaj viktimave para ngjarjeve fatale.

KREU III - ROLI I POLICISË DHE I MEKANIZMAVE TË KOORDINUAR TË REFERIMIT (MKR-VE) NË TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS DHE PARANDALIMIN E FEMICIDIT

3.1 Roli i policisë dhe prokurorisë në hetimin e vrasjes së grave/vajzave dhe identifikimin e femicideve

Strukturat e policisë dhe prokuroritë luajnë rol thelbësor në hetimin e rasteve të vrasjes së grave dhe vajzave, duke qenë përgjegjëse për grumbullimin e provave mbi të cilat do të mbështetet ndëshkimi i autorëve. Ky proces është vendimtar dhe i një rëndësie të veçantë për të siguruar drejtësinë ndaj viktimave dhe për të parandaluar përsëritjen e këtyre krimeve.

Nga shqyrtimi i materialeve mbi çështjet e vrasjes së grave dhe vajzave në Shqipëri, rezulton se procesi i mbledhjes dhe grumbullimit të provave fokusohet kryesisht në këqyrjen e vendit të ngjarjes, mbledhjen e provave materiale në vendin e ngjarjes, pyetjen e të pandehurve, marrjen e dëshmive, kryerjen e ekspertimeve dhe e eksperimentimeve të ndryshme. Gjithashtu prokuroria fokusohet në marrjen e informacionit në lidhje me të shkuarën e të pandehurit, nëse ai ka kryer një vepër penale më parë, informacioni i cili ndihmon në krijimin e një pasqyre më të qartë mbi personalitetin e të pandehurit dhe ndikon në masën e dënimit ndaj tij.

Sa i përket historikut të dhunës, hetimet mbështeten kryesisht në dëshmitë e dhëna nga familjarët e viktimës. Pyetjet që iu bëhen dëshmitarëve shpesh lidhen me mënyrën e jetesës së palëve përpara ngjarjes, natyrën e marrëdhënieve midis autorit dhe viktimës, nëse autori kishte ushtruar dhunë më parë, llojin e dhunës së ushtruar, nëse viktimja kishte kërkuar urdhër mbrojtjeje,

marrëdhëniet e autorit me persona të tjerë dhe sjelljen e tij ndaj tyre, si dhe nëse kishte kërcënuar më parë viktimën. **Megjithatë, hetimi i shkaqeve gjinore që mund të kenë ndikuar në kryerjen e krimit, shpesh lihet në hije, duke u përqendruar kryesisht te kuadri ligjor që mbështet mbrojtjen e marrëdhënieve familjare.**

Në kërkesat për gjykim të çështjeve të femicidit, prokuroria përfshin informacionin e nevojshëm mbi procedimin penal, provat e mbledhura gjatë hetimit dhe kualifikimin ligjor të veprave penale për të cilat akuzohet i pandehuri.⁶⁷ Po ashtu, parashtrohen të dhëna të detajuara mbi ngjarjen, hapat e ndërmarra nga policia pas raportimit të ngjarjes, provat e grumbulluara në vendngjarje si dhe të gjitha veprimet e kryera në kuadër të procesit hetimor mbi ngjarjen (ekspertime, eksperimentime, marrje të dëshmive).⁶⁸

Hetimet për çështjet e femicidit zakonisht përfundojnë brenda një kohe të shkurtër. Në rastet kur autorët kanë humbur jetën pas ngjarjes, hetimet janë mbyllur brenda disa muajve. Në rastet e tjera, hetimet kanë zgjatur nga tre muaj deri në një vit e 15 ditë. Kur autori nuk identifikohet menjëherë pas ngjarjes, hetimet zgjasin më shumë.⁶⁹

Konstatime

Rezulton se hetimi nuk shtrihet në informacionet që disponojnë strukturat përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, në rastet kur viktimat kanë qenë viktimat të mëparshme të dhunës apo të pajisura me urdhër mbrojtje në momentin e ngjarjes. Marrja e këtij informacioni nga anëtarët e MKR-ve do të nxirrte në pah jo vetëm përpjekjet dhe përgjegjësitë e strukturave përgjegjëse për të trajtuar viktimën dhe për të parandaluar ngjarjen por edhe për të evidentuar problematikat e hasura në zinxhirin mbrojtës. Në asnjë nga kërkesat për gjykim të shqyrtuara nuk rezulton që prokuroria të ketë kërkuar informacion nga MKR-të në lidhje me viktimat.

Sipas raportit të publikuar nga Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (IEBGJ)⁷⁰ i cili ofron një analizë gjithëpërfshirëse të përgjigjeve ligjore për luftimin e femicidit, në zbatim të parimit të kujdesit të duhur, shtetet janë të detyruara të hetojnë në mënyrë efektive të gjitha rastet e dhunës ndaj grave dhe të ndjekin penalisht ata që kanë kryer krimin. Po ashtu, të gjitha vrasjet e grave duhet të hetohen si raste të mundshme të dhunës me bazë gjinore. Në këtë kontekst, profesionistët sugjerojnë që të sigurohet një qasje e ndjeshme gjinore për mbledhjen e provave.

⁶⁷ Në bazë të nenit 327/6/b të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, në përfundim të hetimeve paraprake, prokurori i kërkon gjykatës dërgimin e çështjes në gjyq, kur nuk procedon sipas neneve 400, 406/a dhe 406/dh të këtij Kodi.

⁶⁸ Në zbatim të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale, kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq përmban: a) gjeneralitetet e të pandehurit dhe të viktimës, kur është e mundur, si dhe çdo element tjetër që shërben për identifikimin e tyre; b) parashtimin e faktit penal dhe cilësimin juridik të veprës penale; c) burimet e provës dhe faktet që ato u referohen; ç) kërkimin që gjyqtari i seancës paraprake të vendosë dërgimin e çështjes në gjyq; d) datën dhe nënshkrimin e prokurorit.

⁶⁹ Viktima V.G u vra në shkurt të vitit 2021 dhe çështja vazhdon të jetë në hetim për shkak të mosgjetyes së autorit.

⁷⁰ Raporti i Institutit Evropian për Barazinë Gjinore (IEBGJ), *Improving legal responses to counter femicide in Europe* (Përmirësimi i përgjigjes ligjore për luftimin e femicidit në Evropë), faqja 23. Ky raport ofron një analizë gjithëpërfshirëse të përgjigjeve ligjore për të luftuar femicidin. Duke përdorur si pikënisje standardin e kujdesit të duhur, raporti ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi boshllëqet ligjore, sfidat dhe praktikatat e mira në ofrimin e drejtësisë për viktimat e femicideve. Gjetjet fokusohen në hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin autorëve të femicideve.


Gjetjet e intervistave të zhvilluara në kuadër të këtij raporti sugjeruan se krijimi i njësive të veçanta hetimore dhe ekipeve të prokurorisë të specializuara për femicidet mund të përmirësojë procesin e mbledhjes së të dhënave dhe të rezultojë në ndjekje të suksesshme. Për shkak të kompleksitetit të këtyre çështjeve, duhet të vendosen kanaleve të komunikimit ndërmjet institucioneve të ndryshme, si policia, prokuroria, gjykatat civile dhe penale, shërbimet mbështetëse për viktimat etj. Ekspertët vënë dukje se është e nevojshme të krijohen protokolle komunikimi, me role dhe përgjegjësi të qarta të përcaktuara, dhe të sigurohet një shkëmbim i përhershëm i informacionit në lidhje me rastet e femicidit.⁷¹

3.2 Analiza e vendimeve gjyqësore për veprat penale të vrasjes së grave dhe vajzave lidhur me gjininë, femicidet (2021-2023)

Në kuadër të këtij raporti janë shqyrtuar të gjitha vendimet gjyqësore të dhëna nga gjykatat e rretheve gjyqësore të juridiksionit të përgjithshëm që lidhen me vrasjen e grave dhe vajzave për shkak të gjinisë. Gjashtë prej këtyre vendimeve janë ankimuar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Nga kjo analizë rezulton se për 16 prej autorëve të femicideve, janë dhënë vendime të formës së prerë nga gjykatat e rretheve gjyqësore të juridiksionit të përgjithshëm në Fier, Kavajë, Elbasan, Shkodër, Tiranë, Berat dhe Gjirokastrë. Numrin më të lartë të vendimeve të dhëna gjatë kësaj periudhe e mban Elbasani me katër vendime, ndjekur nga Fieri me tre vendime dhe Shkodra me dy vendime.

Grafiku nr.15



⁷¹ Raporti i Institutit Evropian për Barazinë Gjinore (IEBGJ), *Improving legal responses to counter femicide in Europe* (Përmirësimi i përgjigjes ligjore për luftimin e femicidit në Evropë), faqja 26, viti 2023. Shih: https://eige.europa.eu/publications-resources/publications/improving-legal-responses-counter-femicide-european-union-perspectives-victims-and-professionals?language_content_entity=en

Lidhur me kualifikimin e veprës penale, rezulton se në asnjë nga rastet e shqyrtuara, gjykata nuk e ka ndryshuar kualifikimin ligjor të bërë nga prokuroria. Në lidhje me provat e administruara në dosjet gjyqësore, policia dhe prokuroria kanë qenë të angazhuara në grumbullimin e provave të nevojshme për të vërtetuar fajësinë e të pandehurve. Kjo përfshin këqyrjen e vendit të ngjarjes, kryerjen e ekspertimeve të ndryshme, vlerësimin psikiatriko-ligjor kur është konsideruar i nevojshëm, marrjen e dëshmive nga punonjës të policisë që kanë shkuar të parët në vendngjarje, si dhe dëshmitë e të afërmeve dhe personave të njohur të viktimës.

Në lidhje me qëndrimin e autorëve gjatë shqyrtimit të çështjeve, rezulton se në pjesën më të madhe të rasteve ata e pranuan akuzën, por ka pasur raste kur fillimisht mohuan kryerjen e krimit ose pretenduan se vepra penale ishte kryer në kushtet e vetëmbrojtjes. Në **3 raste**, autorët nuk shfaqën asnjë pendesë për krimin e kryer.

Gjykatat, në arsyetimin e vendimeve të tyre, kanë nënvizuar se vepra penale “Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare”⁷² nuk kërkon si kusht të domosdoshëm që vrasja të jetë e paramenduar, mjafton që vrasja të kryhet në zënie e sipër, duke përmbushur elementët e tjerë të kërkuar nga kjo dispozitë.

Kohëzgjatja e procedurave mbi çështjet e femicidit:

Sa i përket kohëzgjatjes së procedurave, nga data e ndodhjes së ngjarjes deri në datën kur vendimi ka marrë formë të prerë, rezulton se intervali më i gjatë kohor për shqyrtimin e çështjeve të femicidit ishte 2 vite e 1 muaj, ndërsa intervali më i shkurtër kohor brenda të cilit u shqyrtua një çështje ishte 4 muaj.

Në rastet e kërkesave për pushimin e çështjes për shkak të vdekjes së autorit, prokuroritë dhe gjykatat procedojnë në afate më të shkurtra kohore. Në këto raste, gjykata nuk është thelluar në analizimin e motiveve dhe historikut të dhunës.


Tabela nr.5 Kohëzgjatja e procedurave të shqyrtimit të çështjes

Kohëzgjatja e procedurave nga data e ndodhjes së ngjarjes deri në datën kur vendimi ka marrë formë të prerë	Numri i çështjeve
25 muaj	1
22 muaj	1
18 muaj	2
17 muaj	1
14 muaj	2
12 muaj	5
11 muaj	1

⁷² Neni 79/c i Kodit Penal, i ndryshuar.

10 muaj	1
9 muaj	1
4 muaj	1

Grafiku nr.16



Procedurat e gjata të shqyrtimit të çështjeve nga organet kompetente nuk janë në përputhje me pritshmëritë dhe mirëqenien psiko-emocionale të trashëgimtarëve të viktimave, duke u krijuar atyre ndjenjën e braktisjes, të padrejtësisë dhe të mosbesimit në sistemin e drejtësisë. Gjithashtu, trashëgimtarët e viktimave ishin pjesëmarrës gjatë shqyrtimit gjyqësor vetëm në katër raste, ndërsa në një rast ata u përfaqësuan nga një avokat mbrojtës i zgjedhur prej tyre.

Në rastet e kërkesave për pushimin e çështjes për shkak të vdekjes së autorit, shqyrtimi i çështjeve në gjykatë nga data e regjistrimit në gjykatë deri në datën e dhënies së vendimit përfundimtar, ka zgjatur nga një deri në tre muaj. Në rastet e tjera kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes ka zgjatur nga katër deri në dhjetë muaj.

Sipas Raporteve të KLGJ-së për vitet 2022⁷³ dhe 2023⁷⁴ çështjet civile dhe penale përfundojnë brenda afatit të arsyeshëm ligjor. Gjatë vitit 2023, koha e nevojshme për përfundimin e një çështjeje penale të gjykuar në shkallë të parë ishte mesatarisht 114 ditë. Vërehet se koha e nevojshme për evadimin e çështjeve është zgjatur në krahasim me vitin 2022, kur ishte 98 ditë.

Gjatë vitit 2023, 92% e çështjeve penale u gjykuan në shkallë të parë në më pak se 6 muaj. Sipas raportit norma e likuidimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nuk paraqitet e kënaqshme. Koha mesatare e nevojshme për shqyrtimin e çështjeve penale është 1673,4 ditë.

Motivet e kryerjes së veprës penale të femicidit:

Në lidhje me **motivet** e femicideve, në pjesën më të madhe të rasteve gratë dhe vajzat u vranë për shkak të:

- xhelozisë;
- mospranimit të ndarjes nga autori;
- mospranimit të faktit që viktima kishte krijuar një marrëdhënie tjetër pas ndarjes, ose
- hakmarrjes pas raportimit të dhunës në organet përgjegjëse ligjzbatuese;

Disa autorë i mbanin viktimat nën vëzhgim dhe ushtronin presion ndaj tyre që të ribashkoheshin.⁷⁵ Konfliktet për menaxhimin e kujdestarisë së fëmijëve gjithashtu rezultuan si burim tensioni që çoi në përshkallëzimin e dhunës deri në vrasje. Në dy raste, viktimat u vranë pas konflikteve banale të çastit.

Dy nga autorët i kryen vrasjet për t'u hakmarrë ndaj viktimave që i kishin raportuar më parë në polici.⁷⁶ Përgjithësisht, autorët kishin pasur konflikte të vazhdueshme me viktimat, shpesh të shoqëruara me dhunë.

Në kërkesat për gjykim të paraqitura nga prokuroritë dhe vendimet e gjykatave nuk i kushtohet vëmendje motivit gjinor të vrasjes. Megjithatë, nga dëshmitë e familjarëve të viktimave, shfaqen elementë që tregojnë ndjenjën e superioritetit të autorëve ndaj viktimave, për shkak të qenies së tyre burra.⁷⁷

Konstatime

⁷³ Shih: <https://klgj.al/wp-content/uploads/2023/07/RAPORT-VJETOR-2022-shkarko.pdf>

⁷⁴ Shih: <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202404300923008125RAPORT%20VJETOR%202023.pdf>

⁷⁵ Vendimi nr.86, datë 23.01.2023, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Në vendim thuhet se para se ta vriste viktimën, autori i kishte kërkuar llogari se ku kishte qenë një natë më parë; ai e kishte monitoruar.

⁷⁶ Vendimi nr.364, datë 26.07.2023, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Autori deklaroi se në mëngjes ishte njoftuar nga gjykata për zhvillimin e seancës gjyqësore në lidhje me çështjen me objekt lëshimin e urdhrin të mbrojtjes dhe në darkë shkoi në banesën e viktimës dhe e vrau atë.

⁷⁷ Vendimi nr. 406 datë 17/7/2024 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Në një nga dëshmitë e dhëna nga babai i njërit prej viktimave citohet: "Përpara se ta vriste ai i tha: 'Pse me mua do të hahesh ti? Jam burrë unë, Jam filani unë'".

Gjykatat duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë mbrojtjes së të drejtave të trashëgimtarëve të viktimave. Duhet të krijohen mundësi që trashëgimtarët të pyeten në ambiente të ndara nga ato ku ndodhet autori, për të shmangur kontaktin vizual me të në gjykatë.⁷⁸

Në rastet e pushimit të ndjekjes penale për shkak të vdekjes së autorit, gjykatat duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë historikut të dhunës dhe të përshkruajnë hollësisht motivet e krimit të kryer.

3.3 Dënimi i autorëve të femicidit

Dënimi i autorëve përfaqëson një formë shtrëngimi shtetëror ndaj subjekteve të shpallur fajtorë për kryerjen e një veprë penale, duke pasur për qëllim jo vetëm ndëshkimin, por edhe edukimin e autorëve dhe parandalimin e veprave penale në të ardhmen. Në këtë drejtim, është e domosdoshme që gjykata, gjatë caktimit të dënimit, të udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë dhe domosdoshmërisë së dënimit, si dhe nga parimi i dobishmërisë dhe individualizimit të tij.⁷⁹ Në caktimin e dënimit ndaj autorit, gjykata merr në konsideratë rrezikshmërinë e veprës penale dhe të autorit të saj, shkallën e fajit dhe rrethanat lehtësuese apo rënduese. Për këtë arsye, ligjvënësi ka parashikuar në ligj marzhe të caktuara minimumi dhe maksimumi për çdo veprë penale, duke i lënë hapësirë gjykatës të vlerësojë rast pas rasti masën e përshtatshme të dënimit.

Referuar nenit 47 të Kodit Penal, gjykata, gjatë caktimit të dënimit, vlerëson shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, duke marrë parasysh objektin e cenuar prej saj, mënyrën e kryerjes së krimit, kohën, vendin, kushtet dhe rrethanat që ndikuan në kryerjen e saj, si dhe përhapjen e kësaj veprë në shkallë vendi apo rajoni. Po ashtu, analizohen edhe pasojat e ardhura nga kryerja e veprës penale.

Gjykata vlerëson edhe rrezikshmërinë e autorit të krimit, duke marrë në konsideratë rrethana objektive dhe subjektive të lidhura me personalitetin dhe individualitetin e tij, si gjendja gjyqësore, moshja, gjendja sociale dhe familjare, arsimi dhe profesioni. Në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit, gjykata shqyrton gjithashtu ekzistencën e rrethanave lehtësuese dhe rënduese, të parashikuara në nenet 48-50 të Kodit Penal, të cilat pasqyrojnë një shkallë më të ulët ose më të lartë rrezikshmërie të veprës dhe të autorit.

Llojet e dënimeve të dhëna autorëve të femicideve përfshijnë kryesisht burgim të përjetshëm dhe 30 vite burgim. Në dy raste, autorët u dënuan me 20 vjet burgim dhe në një rast me 12 vjet burgim. Njëzetekatër rastet e femicideve u kryen nga 22 autorë. Për 16 autorë çështja gjyqësore ka përfunduar dhe gjashtë janë në proces shqyrtimi (dy në hetim dhe katër në gjykim). Nga këto,

⁷⁸ Një nga familjaret e intervistuar ndër të tjera citoi: "Kur shkova në gjykatë dhe pashë përballë meje autorin e vrasjes së motrës time, u mpiva komplet, kalova gjendje ankthi, nuk munda të kuptoj asgjë çfarë ndodhi gjatë seancës gjyqësore".

⁷⁹ Në nenin 47 të Kodit Penal, nën titullin "Mënyra e caktimit të dënimit" parashikohet se gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të Kodit Penal dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara në ligj për veprën penale.

nëntë autorë janë dënuar, gjashtë çështje janë pushuar (pasi autori ka humbur jetën pas ngjarjes) dhe për një rast është dhënë vendim për mjekim të detyruar në një institucion mjekësor.

Grafiku nr.17




Tabela nr. 6 Dënimi i autorëve

Lloji i dënimit	Numri i autorëve të dënuar	Masa e dënimit
Burgim i përjetshëm	4 autorë	
Burgim	4 autorë	30 vite burgim - 2 autorë 20 vite burgim - 1 autor 12 vite burgim - 1 autor
Kurim i detyruar në një institucion shëndetësor	1 autor	

Autorët që janë dënuar me burgim të përjetshëm e vuajnë dënimin në burgje të sigurisë së lartë, ndërsa për autorët e tjerë vuajtja e dënimit kryhet në burgje të sigurisë së zakonshme. Vendimet me burgim të përjetshëm u dhanë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan për tre autorë dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier për një autor. Vendimet me 30 vite burgim u dhanë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për një autor dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër për një autor. Dënimi më i ulët me burgim (12 vjet burgim) u dha nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës për një autor.

Ndërsa dënimet janë rezultat i gjykimeve lidhur me provueshmërinë e shkeljes së ligjit, dhënia e masës mjekësore rrjedh nga gjykimi lidhur me rrezikshmërinë shoqërore dhe jo me përgjegjshmërinë apo mundësinë e përsëritjes së krimit në të ardhmen. Sipas nenit 46 të Kodit Penal, masat mjekësore personale përfshijnë “mjekimin e detyruar ambulator” dhe “mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor”. Për të vlerësuar domosdoshmërinë e caktimit të masës “mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”, për personat që përjashtohen nga përgjegjësia penale, një rol vendimtar luan mendimi i ekspertit psikiatër gjatë procedimit penal, si dhe akti i ekspertimit psikiatriko-ligjor i përgatitur nga grupi i ekspertëve.

Në shumicën e rasteve të shqyrtuara, ndaj autorëve është kryer ekspertimi psikiatriko-ligjor. Megjithatë, në 3 raste, gjatë shqyrtimit të çështjes nuk u krye vlerësimi psikiatriko-ligjor, ndërsa në një rast tjetër autori ishte nën masën e mjekimit të detyruar ambulator në momentin e kryerjes së vrasjes.⁸⁰

Konstatime

Dhunuesit me probleme të shëndetit mendor përbëjnë një problem tepër shqetësues, i cili kërkon adresim të posaçëm përmes aktivizimit të mekanizmave të nevojshëm, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar mbi shëndetin mendor.⁸¹ Autoritetet përgjegjëse duhet të marrin masa për të ofruar zgjidhje të përshtatshme dhe për të ngritur programe të specializuara për trajtimin afatgjatë të këtyre individëve.

Policia dhe autoritetet mjekësore duhet të veprojnë me iniciativë për identifikimin dhe adresimin e rasteve të tilla, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi për shëndetin mendor. Gjithashtu, familjarët dhe rrethi shoqëror duhet të jenë më të ndjeshëm ndaj këtyre situatave, duke informuar autoritetet përkatëse për marrjen e masave të duhura në kohë.

Në çështjen **Branko Tomašić dhe të tjerët kundër Kroacisë**, ankuesit ishin të afërmit e një foshnjeje dhe të nënës së saj, babai/burri i së cilës i vrau ato dhe veten një muaj pasi u lirua nga burgu ku vuante dënimin për kërcënime me vdekje kundër të njëjtëve. Ai fillimisht ishte urdhëruar t'i nënshtrohej trajtimit të detyrueshëm psikiatrik gjatë qëndrimit në burg dhe pas lirim, sipas nevojës, por Gjykata e Apelit urdhëroi që trajtimi i tij të ndërpritej pas lirim. GJEDNJ-ja u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 2 (e drejta për jetë) të Konventës së të Drejtave të Njeriut, për shkak të mosmarrjes së hapave të duhur nga autoritetet kroate për të parandaluar vdekjen e fëmijës dhe të nënës. Gjykata vërejt në veçanti se konstatimet e gjykatës kroate dhe përfundimet e ekzaminimit psikiatrik treguan pa dyshim se autoritetet kishin qenë në dijeni se kërcënimet e bëra ndaj jetës së nënës dhe fëmijës ishin serioze dhe se duhej të ishin

⁸⁰ Në këtë rast gjykata u mjaftua me vlerësimin psikiatriko-ligjor të kryer ndaj autorit disa muaj më parë, kur ishte bërë zëvendësimi i masës nga “mjekim i detyruar në një institucion mjekësor” në “mjekim i detyruar ambulator”.

⁸¹ Sipas raportit të qendrës “Të drejtat e njeriut në demokraci”, “Sistemi gjyqësor si pararendës në mbrojtjen e të drejtave të viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, i vitit 2021, rezultojnë se 4% e dhunuesve ishin me probleme të shëndetit mendor.

marrë të gjithë hapat e arsyeshëm për t'i mbrojtur ato. Gjykata më tej vuri në dukje disa mangësi në veprimet e autoriteteve. Kështu, edhe pse raporti psikiatrik i hartuar për qëllime të procesit penal kishte theksuar nevojën për vazhdimin e trajtimit psikiatrik të bashkëshortit, qeveria kroate nuk arriti të provonte se një trajtim i tillë ishte kryer siç duhej. Nga dokumentet e dorëzuara rezultoi se trajtimi i bashkëshortit në burg kishte konsistuar në seanca bisedimi me punonjësit e burgut, asnjë prej të cilëve nuk ishte psikiatër. Gjithashtu, rregulloret përkatëse dhe vendimi i gjykatës mbi urdhrin për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik nuk kishin dhënë detaje të mjaftueshme se si duhet të kryej trajtimi. Së fundi, bashkëshorti nuk ishte ekzaminuar përpara lirimit nga burgu për të vlerësuar nëse ai ende përbënte rrezik për fëmijën dhe nënën e fëmijës. Rrjedhimisht, GJEDNJ-ja arriti në përfundimin se autoritetet vendase nuk kishin marrë masat e duhura për të mbrojtur jetën e tyre.

3.4 Monitorimi i seancave gjyqësore

Institucioni i Avokatit të Popullit ka qenë i angazhuar në monitorimin e seancave gjyqësore për veprat penale të vrasjes së grave dhe vajzave të vlerësuara si femicide, me synimin për të analizuar procedurat dhe vendimmarrjen gjyqësore.

Bazuar në informacionin dhe dokumentacionin e siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe prokuroritë e rretheve gjyqësore, janë identifikuar çështjet që janë në proces shqyrtimi nga gjykatat dhe janë monitoruar disa prej çështjeve kundër autorëve të femicideve.

Seancat gjyqësore janë zhvilluar përgjithësisht sipas orareve të caktuara dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndërsa intervalet kohore ndërmjet seancave kanë variuar nga 14 ditë deri në një muaj. Sa i përket gjykimit në apel të këtyre çështjeve, gjatë periudhës mars - dhjetor 2024 nuk ka pasur raste femicide në shqyrtim. Në kuadër të këtij raporti janë monitoruar 13 seanca gjyqësore që lidhen me pesë raste femicide, të trajtuara nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore të Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Korçë. Nga këto, gjashtë seanca janë shtyrë për arsye të ndryshme, ndër të cilat:

- mosplotësimi i trupit gjykues,
- shkarkimi i njërit prej anëtarëve të trupit gjykues,
- probleme shëndetësore të anëtarëve të trupit gjykues,
- mosnjohimi i trashëgimtarëve të viktimave,
- mungesa e avokatëve, dhe
- kërkesat për shtyrje të seancave nga palët.

Konstatime

Janë konstatuar raste kur seancat janë shtyrë për shkak të mosnjohimit të trashëgimtarëve të viktimave, përfshirë mosgjetjen e adresave të tyre të banimit.

Një tjetër problematikë ka qenë mosshoqërimi i të pandehurve nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në datën dhe orën e caktuar për seancat.

Në seancat e monitoruara nuk kanë marrë pjesë trashëgimtarët e viktimave, përveç një rasti ku avokati i zgjedhur nga trashëgimtarët e viktimës mori pjesë në procedurat gjyqësore.

Rezulton se nga data e regjistrimit në gjykatë deri në dhënien e vendimit përfundimtar, proceset gjyqësore zgjasin zakonisht 1-3 muaj në rastet e pushimit të çështjes dhe 4-10 muaj në rastet e tjera.

3.5 Pasojat e femicidit tek fëmijët dhe familjarët e viktimave

Nëse i referohemi familjarëve të viktimave të femicidit dhe në mënyrë të veçantë fëmijëve rezulton se numri i viktimave është shumë më i lartë. Pasojat me të cilat përballen trashëgimtarët e viktimave të femicidit janë të rënda – përveç vuajtjeve dhe traumave nga humbja e njeriut të tyre të dashur, ata duhet të kujdesen për fëmijët e viktimave, të angazhohen në rritjen dhe edukimin e tyre, pavarësisht vështirësive me të cilat përballen.

Gjatë periudhës objekt monitorimi, nga vrasja e nënave të tyre u prekën 35 fëmijë, nga të cilët 20 ishin të mitur, për më tepër, disa prej tyre ishin të pranishëm në momentin e ngjarjes. Këta fëmijë vuajnë pasojat psikologjike, por edhe ekonomike, për shkak të ngjarjes edhe të zgjatjes së procedurave gjyqësore mbi kujdestarinë.

Zbatimi i Hartës së Re Gjyqësore u shoqërua me mbingarkesë të gjykatave, në mënyrë të veçantë në gjykatat e mëdha të vendit, që solli zvarritje të proceseve gjyqësore dhe afate më të gjata të shqyrtimit të çështjeve. Edhe në rastet kur kërkohet përcaktimi i kujdestarisë së fëmijëve të mbetur pa kujdes prindëror, procedurat zgjasin shumë në kohë, gjë që bie ndesh me parimin e mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës. Avokati i Popullit ka hartuar një raport i cili ka në fokus kryesor ndikimin e vonesave në gjykimin e çështjeve gjyqësore familjare tek të drejtat e fëmijëve (interesit më të lartë të fëmijës).⁸²

Fëmijët gëzojnë mbrojtje të veçantë nga legjisllacioni shqiptar, por mbështetja e tyre në praktikë kërkon angazhim të koordinuar ndërmjet strukturave përgjegjëse⁸³ si dhe shtim të shërbimeve mbështetëse. Rastet e trajtuara tregojnë se është e domosdoshme që fëmijët dëshmitarë të krimit

⁸² Institucioni i Avokatit të Popullit ka hartuar Raportin e veçantë "Analizë e eficiencës së drejtësisë për fëmijët, në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve familjare", dërguar Kuvendit të RSH-së me shkresën nr.650 prot., datë 19.11.2024.

⁸³ Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur përdor termin viktimë ose dëshmitar i veprës penale për fëmijët e gjendur në të tilla situata. Ky Kod, ndër të tjera, ka për qëllim që të mbrojë të drejtat e të miturit në rastet kur është dëshmitar dhe/ose viktimë e veprës penale. "I mitur viktimë" i veprës penale sipas këtij Kodi është çdo person nën moshën 18 vjeç, të cilit i është shkaktuar dëm moral, fizik ose material, si pasojë e një vepre penale. "I mitur dëshmitar" është çdo person nën 18 vjeç, i cili mund të ketë informacion lidhur me veprën penale.

apo të prekur nga këto ngjarje të mbështeten me kujdes dhe profesionalizëm menjëherë pas ngjarjes.

Në një prej rasteve, dëshmia e një fëmije të mitur, i cili kishte qenë i pranishëm gjatë dhunimit të nënës, shërbeu si provë kyçe për të provuar vrasjen, pasi fillimisht ngjarja ishte raportuar nga bashkëshorti i viktimës si vetëvrasje. Në raste të tjera, fëmijët u përballën me situata tepër të rënda, si në rastin kur vajza e mitur e viktimës shkoi në vendin e ngjarjes pas plagosjes së rëndë të nënës së saj, e cila më pas ndërroi jetë në spital.⁸⁴ Po ashtu, në disa raste, vrasjet ndodhën në të njëjtin ambient ku fëmijët ishin të pranishëm, në disa raste gjatë kohës së gjumit.

Organet kompetente duhet t'i trajtojnë çështjet me të mitur viktime ose dëshmitarë me përkujdesje të veçantë, duke respektuar dinjitetin e tyre dhe duke marrë parasysh gjendjen personale, nevojat specifike, moshën, gjininë dhe nivelin e pjekurisë.⁸⁵

Përgjigjet e marra nga bashkitë tregojnë se pas ngjarjeve, përfaqësuesit e njësive vendore shpeshherë vizitojnë familjet e viktimave për të verifikuar nevojat dhe problematikat e mbetura, veçanërisht ato që lidhen me fëmijët.

Në vendimet gjyqësore kundër autorëve të femicidit, vrasja në prani të fëmijëve, sikurse ka ndodhur në disa raste, apo vrasja e nënave me fëmijë të mitur, shpesh trajtohet si rrethanë rënduese. Por vuajtjet e fëmijëve rrallë pasqyrohen në të dhënat statistikore ose analizat.

Megjithatë, ka pasur raste ku fëmijët janë asistuar vetëm pas disa ditësh nga ngjarja, sidomos kur janë zhvendosur dhe akomoduar pranë të afërmeve në qytete të tjera. Në këto raste, bashkia ku ka ndodhur ngjarja ka për detyrë ta referojë rastin tek bashkia ku është zhvendosur fëmija, por procedurat shpesh zgjaten, duke vonuar mbështetjen për të miturit.

Në rastet ku fëmijët e mitur mbetën pa kujdes prindëror, punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve (PMF) luajtën rol të rëndësishëm, duke kontaktuar të miturit dhe duke propozuar masa mbrojtjeje. Në disa raste, PMF-të organizuan Ekipin Teknik Ndërdisciplinor (ETN) për të vendosur masa të menjëhershme, si kalimi i kujdestarisë së fëmijës tek të afërmit. Në një prej rasteve, një fëmijë u vendos përkohësisht në një institucion dhe më pas kujdestaria iu dha gjyshërve nga nëna, pasi babai kishte hequr dorë nga kujdestaria.⁸⁶

⁸⁴ Në kërkesën për gjykim në lidhje me gjykimin ndaj të pandehurit A.M, parashtrohet se në vendngjarje iu morën deklaratime vajzës së mitur të viktimës "Aty në vend i janë marrë deklaratimet kësaj shtetasje, e cila ka shpjeguar rrethanat e konstatimit të veprës penale". Më pas thuhet: "Në cilësinë e personit që ka dëgjim për veprën penale është pyetur në përputhje me parashikimet e KDPM-së dhe nenit 297 të Kodit të Procedurës Penale, në prani të përfaqësuesit procedural (Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve), psikologut dhe avokatit mbrojtës, shtetasja e mitur K.M".

⁸⁵ Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës është struktura për mbrojtjen e të miturit në nivel vendor, sipas kuadrit ligjor për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Përfaqësuesi i kësaj Njësie është personi mbështetës në rastet e të miturve dëshmitarë dhe viktime; ai ka për detyrë të ndjekë hap pas hapi trajtimin dhe rehabilitimin e të miturve.

⁸⁶ Në këtë rast viktime ishte vrarë nga ish kunati i saj (ish-bashkëjetuesi i motrës).

Në përgjithësi, kujdestaria ligjore për këta fëmijë i është lënë me vendim gjykate gjyshërve ose të afërmeve nga nëna. Bashkitë kanë ofruar shërbime si ndihmë në procedurat ligjore, këshillim psikologjik dhe mbështetje materiale, duke përfshirë paketa për festa dhe sete shkollore.

Në disa raste, ndihma psikologjike nuk është ofruar nga bashkitë përkatëse,⁸⁷ por fëmijët janë referuar pranë organizatave të shoqërisë civile. Ofrimi i kësaj ndihme duhet të realizohet me efektivitetin e duhur dhe deri në rehabilitimin e të miturve nga traumat e pësuar.

Ofrimi i kësaj ndihme dhe shërbimeve të tjera mbështetëse afër vendbanimit të fëmijëve është një faktor i rëndësishëm për mbështetjen e tyre, pasi shumë prej tyre jetojnë nën kujdesin e gjyshërve që përballen me vështirësi ekonomike dhe shëndetësore, duke e bërë të vështirë sigurimin e shërbimeve.

Një problematikë tjetër lidhet me konfliktet midis familjarëve të nënës dhe atyre të babait të fëmijëve për mbajtjen e raporteve me fëmijët.⁸⁸ Në shumicën e rasteve, familjarët që marrin kujdestarinë e fëmijëve nuk mbajnë kontakte me familjarët e autorit të kimit.

Rezulton se punonjësit përgjegjës mbajnë kontakte të vazhdueshme me familjet kujdestare, duke ofruar informacion për të drejtat e tyre dhe duke asistuar në ndjekjen e procedurave për mbështetje financiare. Megjithatë, ndihma që ofrohet nuk përmbush nevojat për mirëritjen dhe edukimin e të miturve.⁸⁹

Mbështetja financiare e fëmijëve të viktimave

Aktualisht sipas Ligjit nr.8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, një nga rastet kur të miturit fitojnë statusin e jetimit është kur ata nuk kanë gjallë asnjërin nga prindërit.

Sipas ligj nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, personat që janë në ngarkim të personit të ndjerë që plotëson kushtet për përfitimin e njërit nga llojet e pensioneve ose merrte pension, kanë të drejtë të marrin **pension familjar**. Sipas nenit 41 të këtij Ligji, pensioni familjar është pjesë e pensionit që kishte ose i takonte të ndjerit, ku secili nga fëmijët përfiton nga 25% të shumës së pensionit që i takonte të ndjerit. Shuma e një pensioni familjar nuk duhet të kalojë masën e pensionit që merrte ose do të merrte personi që vdiq. Jetimi që humbet të dy prindërit, merr pension jetimi për secilin prej tyre.

⁸⁷ Në përgjigjen e kthyer nga bashkia e Vaut të Dejës rezulton pranë kësaj bashkie nuk ofrohej shërbim psikologjik, ndaj e mitura ishte referuar pranë një organizate që operon në Bashkinë Shkodër, nuk jepet informacion nëse e mitura ka vazhduar të marrë shërbim pranë kësaj organizate.

⁸⁸ Në përgjigjet e kthyera nga bashkitë janë konstatuar raste të konflikteve ndërmjet palëve ku është kërkuar edhe lëshimi i UM nga familjarët e të miturve.

⁸⁹ Trashëgimtarja e intervistuar, e cila ka nën kujdesin e saj tre fëmijët e mitur të motrës së saj shprehet: “Nuk marr asnjë ndihmë nga shteti, e kam shumë të vështirë të menaxhoj rritjen e fëmijëve, ne jetojmë nëntë persona në një banesë me dy dhoma, fëmijët janë shumë të vegjël, kanë shumë nevoja, njëri prej tyre është i sëmurë me epilepsi dhe unë duhet të punoj dhe të ndjek ekzaminimet shëndetësore të tij”.

Në rastet e femicidit ku të miturit kanë humbur nënën ndërsa babai vuan dënimin për vrasjen e saj, duke qenë se këta fëmijë praktikisht mbeten pa kujdes prindëror, familjarët e viktimës i drejtohen me kërkesë gjykatës për marrjen e kujdestarisë së fëmijëve.

Në bazë të VKM nr. 149, datë 13.3.2018 “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare”, masa e financimit për familjen kujdestare, për shpenzimet ushqimore **për një fëmijë të vendosur në kujdestari, është 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj**, ndërsa për shpenzimet e ushqimit të një fëmije me aftësi të kufizuara është 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

Avokati i Popullit ka përgatitur një raport mbi standardin e minimumit jetik në Shqipëri për vitin 2019.⁹⁰ Bazuar në analizën e kryer në kuadër të këtij raporti, është nxjerrë përfundimi se vlera e minimumit jetik për vitin 2019 në Shqipëri ishte përafërsisht 17.875 lekë në muaj. Sipas analizës së Avokatit të Popullit, nëse kjo shumë indeksohet sot, kjo vlerë llogaritet në 21 mijë lekë në muaj për person. Si rrjedhim, pagesa që përfiton një i mitur pas vendosjes nën kujdestari është rreth 52% më e ulët se vlera e standardit të minimumit jetik.

Për shkak të procedurave të zgjatura në gjykata, fëmijët dhe familjarët kujdestarë shpesh presin më shumë se një vit për të marrë ndihmën financiare. Rezulton se për shkak të kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore, sidomos në gjykatat e mëdha të vendit, këtë pension familjet kujdestare e marrin pas një periudhe kohore që shkon mbi 1 vit.

Kjo vonesë i vendos familjarët në vështirësi të mëdha, duke rritur nevojën për mbështetje emergjente financiare dhe materiale.

Nga sa më sipër, në funksion të ofrimit të mbështetjes së menjëhershme të të miturve të prekur nga ngjarjet e femicidit rekomandojmë:

Marrjen e masave për mundësimin e paketave *ad hoc* të mbështetjes financiare dhe materiale për këta fëmijë me qëllim mbështetjen e menjëhershme dhe në përputhje me nevojat e tyre, deri në caktimin e pensionit familjar apo mbështetjes financiare zyrtarisht.

Koordinimi i punës ndërmjet PMF-ve dhe psikologëve të shkollave me qëllim realizimin e mbështetjes me ndihmë psikologjike sipas nevojës së fëmijëve.

⁹⁰ Raporti i Avokatit të Popullit “Për standardin e minimumit jetik në Shqipëri”, i vitit 2021, shih: <file:///C:/Users/pc/Downloads/Minimumi%20jetik%20ok.pdf>

IV- REKOMANDIME

Rekomandimet përfshijnë krijimin e strategjive dhe fuqizimin e strukturave për parandalimin e femicidit, përfshirjen e tij si vepër penale specifike në Kodin Penal, dhe përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional për trajtimin e rasteve. Sugjerohet mbledhja dhe unifikimi i të dhënave, vlerësimi efektiv i rrezikut dhe zbatimi i masave mbrojtëse për viktimat, si dhe mbështetje psikologjike, ligjore dhe materiale për të miturit e prekur nga femicidi. Theksohet nevoja për trajnime, rehabilitimin e dhunuesve dhe standardizimin e monitorimit të urdhrave të mbrojtjes, ndërsa institucionet vendore dhe njësitë administrative duhet të krijojnë mekanizma për përgjigje emergjente dhe ndihmë të qëndrueshme për viktimat dhe trashëgimtarët e tyre. Rekomandimet janë ndarë në dy kategori: të përgjithshme dhe specifike.

- ✓ *Rekomandimet e përgjithshme* përfshijnë hartimin e strategjive kombëtare për parandalimin e femicidit, përfshirjen e tij si vepër penale specifike në Kodin Penal, përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional dhe mbështetjen për viktimat dhe trashëgimtarët.
- ✓ *Rekomandimet specifike* fokusohen në rolin e institucioneve kryesore si policia, prokuroria, gjykatat, bashkitë dhe njësitë administrative, duke theksuar mbledhjen e të dhënave të unifikuara, vlerësimin efektiv të rrezikut, zbatimin e masave mbrojtëse, rehabilitimin e dhunuesve dhe ndihmën urgjente për të miturit e prekur nga femicidi.

4.1 Rekomandime të përgjithshme

Për parandalimin e femicidit, mbështetjen e familjarëve të viktimave dhe adresimin e dhunës me bazë gjinore, rekomandohet ndërmarrja e masave dhe aktiviteteve në të gjitha nivelet:

- **Hartimi i strategjive të qarta për luftimin e femicidit**, fuqizimi i strukturave përgjegjëse që garantojnë mbrojtje efektive dhe ngritja e kapaciteteve të punonjësve të këtyre strukturave.
- **Parashikimi i femicidit si vepër penale specifike në Kodin Penal të ri** dhe përmirësimi i legjislacionit për dhunën ndaj grave dhe femicidin, në përputhje me rekomandimet e mekanizmave ndërkombëtarë (Komiteti i KEGJFDG-së, GREVIO, Grupi i Punës i RPU-së).
- **Rritja e ndërgjegjësimit publik** dhe vendosja e standardeve për raportimin mediatik të rasteve që lidhen me dhunën ndaj grave dhe femicidet.
- **Adresimi i boshllëqeve në të dhëna** dhe referimi i kryqëzuar në nivele të ndryshme për sigurimin e të dhënave të plota dhe cilësore. Koordinimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm duhet të shmangë përsëritjet dhe pasaktësitë, duke përfshirë përditësimin e sistemeve të mbajtjes së të dhënave.

- **Mbështetje për trashëgimtarët e viktimave të femicidit**, duke ofruar ndihmë psikologjike, ligjore dhe informim, në mënyrë që nevojat e tyre të adresohen gjatë proceseve ligjore.
- **Ndihmë për të miturit e prekur nga femicidi**, përmes mbështetjes psikologjike, ligjore, financiare dhe materiale, si dhe ndjekjes nga afër të rehabilitimit të tyre nga traumat e shkaktuara dhe rishikimi i vlerës së ndihmës ekonomike.
- **Rishikimi i standardeve të koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse**, me qëllim trajtimin efektiv të rasteve të dhunës, ngritjen dhe konsolidimin e shërbimeve mbështetëse dhe programeve rehabilituese.
- **Krijimi i një praktike të qëndrueshme** për njoftimin në kohë të viktimave në lidhje me lirin nga burgu të dhunuesve dhe monitorimin e tyre.
- **Vlerësimi i shëndetit mendor të të dënuarve për vepra penale ndaj grave**, si parakusht për marrjen e masave për parandalimin e episodeve të dhunës. Ngritja e programeve mbështetëse dhe rehabilituese për trajtimin e tyre është një nevojë urgjente.
- **Ndihmë dhe mbështetje shumëdisiplinore** për gratë dhe vajzat subjekte të dhunës në familje

4.2 Rekomandime specifike

4.2.1 Rekomandime për policinë

Duke njohur rolin dhe kontributin shumë të rëndësishëm që kanë strukturat e policisë së shtetit në trajtimin dhe adresimin e çështjeve të dhunës ndaj grave, përfshirë femicidin, dhe bazuar në konstatimet e Observatorit, rekomandojmë marrjen e masave në lidhje me:

- ✓ Rishqyrtimin e procedurave sa i përket kryerjes së vlerësimit të riskut dhe lëshimit të UMPMM-ve, me qëllim marrjen e masave konkrete në përputhje me standardet e Konventës e Stambollit, jurisprudencën e GJEDNJ-së, dhe me kuadrin ligjor të brendshëm. Konkretisht, kjo nënkupton:
 - Trajtimin me shumë seriozitet të kërcënimeve ndaj jetës dhe marrjen e masave të shpejta për të shmangur përshkallëzimin (p.sh. fakti që dhunuesi mund të ketë akses në armë, që ka leje për ta përdorur, përbën një indicie për rrezik; po kështu edhe shkelja e urdhrave të mëparshëm të mbrojtjes). Organet e policisë nuk duhet të presin për të qenë të sigurt për kërcënimin, por të veprojnë me dilijencë të veçantë (special diligence).
 - Krijimin e një sistemi për të siguruar mbrojtje të menjëhershme në një qendër emergjence, nëse është e nevojshme, dhe më pas qendra më afatgjata, veçanërisht nëse dhunuesi është i lirë.
 - Trajtimi me vëmendje të veçantë i fëmijëve dhe viktimave të tjera të dhunës në ambientin familjar.
- ✓ Vënien në lëvizje të mekanizmave që nxisin koordinim më të mirë të punës me strukturat e tjera përgjegjëse anëtare të MKR-ve, për zbatimin e UMPMM-ve, me qëllim shmangien e rrezikut të menjëhershëm dhe trajtimin e rasteve në mënyrë shumëdisiplinore.

- ✓ Trajtimin në mënyrë të përbashkët dhe brenda një kohe të shkurtër të rasteve nga anëtarët e MKR-ve, që nga momenti i raportimit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut, adresimin e nevojave fillestare të viktimave, monitorimin respektimit të urdhrave të mbrojtjes deri në rehabilitimin e plotë të viktimave.
- ✓ Riadresimin e nevojës për ndjekjen në mënyrë paralele të procesit për lëshimin e UMM/UM-së dhe procedimit penal të dhunuesit, duke vlerësuar se urdhri i mbrojtjes i shërben jo vetëm mbrojtjes së integritetit të viktimës por edhe procesit të rehabilitimit të saj.
- ✓ Referimin e rasteve pranë institucioneve shëndetësore me qëllim mbështetjen me ndihmë mjekësore dhe psikologjike si dhe pajisjen me raportin e posaçëm mjekësor.
- ✓ Rritjen e efikasitetit në drejtim të identifikimit të rasteve dhe veprimit me iniciativë për të kërkuar lëshimin e UMM/UM-ve në rastet kur konstatohet dhunë.
- ✓ Mbledhjen, përditësimin dhe unifikimin e të dhënave mbi të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, duke krijuar modele tip të regjistrave elektronikë për mbajtjen dhe evidentimin e tyre.
- ✓ Kryerjen e trajnimeve në vijimësi dhe ngritjen e strukturave të specializuara për trajtimin e çështjeve që lidhen me dhunën me bazë gjinore, përfshirë femicidin, në zbatim edhe të rekomandimeve të GREVIO-s.

4.2.2 Rekomandime për prokuroritë

Për prokuroritë, si institucione kyçe në hetimin dhe vënien para drejtësisë të autorëve të krimeve, rekomandojmë fuqizimin e mëtejshëm të rolit të tyre në lidhje me:

- ✓ Vënien në lëvizje të mekanizmave që nxisin analizimin e hollësishëm të historikut të dhunës ndaj viktimave dhe motivit gjinor që lidhet me kryerjen e veprës penale.
- ✓ Analizimin e historikut të dhunës ndaj viktimës dhe motiveve të vrasjes edhe në rastet kur kërkohet pushimi i çështjes për shkak se autorët kanë humbur jetën pas ngjarjes apo gjatë kryerjes së hetimeve.
- ✓ Vendosjen e urave të komunikimit dhe ndarjes së informacionit ndërmjet institucioneve të ndryshme, si policia, gjykatat civile dhe penale, shërbimet mbështetëse për viktimat, MKR-të etj.
- ✓ Vendosjen në plan të parë të sigurisë së viktimës në rastet kur hetohen çështje të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, duke koordinuar punën me koordinatorët vendorë dhe anëtarët e tjerë të MKR-së.

4.2.3 Rekomandime për gjykatat

Në përputhje me konstatimet e Observatorit dhe nevojën për forcimin e mëtejshëm të rolit të gjykatave në drejtim të trajtimit të çështjeve të dhunës me bazë gjinore, përfshirë femicidin, rekomandojmë:

- ✓ Marrjen e masave për mbajtjen e të dhënave të sinkronizuara për të pandehurit, autorët dhe viktimat.
- ✓ Vënien në lëvizje të mekanizmave që nxisin krijimin e një praktike të unifikuar në lidhje me analizën e motivit gjinor në çështjet që lidhen me të gjitha format e dhunës ndaj grave.
- ✓ Marrjen e masave në lidhje me krijimin e mundësive për pyetjen e trashëgimtarëve të viktimave në ambiente të ndryshme nga ambienti ku ndodhet autori, në funksion të shmangies së riviktimizimit të tyre.
- ✓ Trajtimin me vëmendje të shtuar të çështjeve që lidhen me dhunën ndaj grave duke i kushtuar vëmendjen e duhur përshtatjes së llojit të dënimit me nivelin e rrezikshmërisë së autorit, si dhe duke parashikuar në vendim detyrimin që dhunuesi të marrë pjesë në programe rehabilituese gjatë dhe pas vuajtjes së dënimit.
- ✓ Kryerjen e një analize të thelluar mbi historikun të dhunës dhe motivet e krimit në çdo rast, duke e shtrirë marrjen e informacionit edhe tek strukturat e tjera përgjegjëse.
- ✓ Trajtimin me vëmendje të shtuar të nevojave për mbrojtje të viktimës edhe në rastet e mosparaqitjes së saj gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, duke caktuar masa mbrojtëse që mundësojnë mbrojtjen e integritetit dhe adresimit të nevojave të saj.

4.2.4 Rekomandime për bashkitë dhe njësitë administrative

Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi dhe rolit që luajnë institucionet e vetëqeverisjes vendore në drejtim të trajtimit dhe adresimit e çështjeve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, rekomandojmë vënien në lëvizje të mekanizmave të cilët nxisin:

- ✓ Krijimin e modelit të institucioneve të cilat shërbejnë si urë lidhëse ndërmjet nevojave të viktimave dhe strukturave të tjera përgjegjëse.
- ✓ Ngritjen e burimeve materiale dhe njerëzore me qëllim përgjigjen në kohë dhe pa vonesa ndaj çdo rasti dhune në nevojë për ndihmë dhe mbështetje, duke asistuar policinë që në momentin e parë të raportimit të dhunës, si dhe ndjekin hap pas hapi të rastit deri në përfundim të procesit rehabilitues.
- ✓ Rritjen e kontributit të tyre në lidhje me paraqitjen e kërkesës për lëshimin e UMM/UM-së me kërkesën e viktimës, por edhe kryesisht, në rastet kur konstatohet dhunë.
- ✓ Rishqyrtimin e standardeve në lidhje me monitorimin e urdhrave të mbrojtjes duke i kushtuar vëmendje vlerësimit rast pas rasti të nevojave për ndërhyrje, në drejtim të parandalimit të shkeljes së urdhrave të mbrojtjes dhe përshkallëzimit të dhunës.
- ✓ Ngritjen e burimeve njerëzore dhe materiale me qëllim adresimin në kohë të nevojave emergjente dhe afatgjata të fëmijëve dhe trashëgimtarëve të viktimave të femicidit.

4.2.5 Rekomandime për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si autoriteti kryesor përgjegjës sa i përket hartimit të strategjive dhe programeve në fushën e parandalimit, mbrojtjes dhe shërbimeve ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare.⁹¹

- Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë për parashikimin e femicidit si vepër penale në Kodin e ri Penal.
- Organizimi i vazhdueshëm i fushatave ndërgjegjësuere për parandalimin e dhunës ndaj grave (krahas fushatave të dedikuara botërore dhe me fonde publike), duke trajtuar edhe femicidin si një nga format më të rënda të dhunës.
- Përshpejtimi i masave mbështetëse për rritjen e kapaciteteve të MKR-ve për të siguruar një funksionim sa me efektiv të të gjithë mekanizmave në të 61 bashkitë, veçanërisht në drejtim të vlerësimit të riskut dhe ofrimit të shërbimeve mbrojtëse emergjente për viktimat, si dhe ofrimin më tej të shërbimeve afatmesme dhe afatgjata.
- Rritjen e financimit të projekteve për ngritjen e qendrave të emergjencës nga Fondi Social, në veçanti për bashkitë ku kjo nevojë është e domosdoshme për shkak të numrit të lartë të rasteve.
- Monitorimi i projekteve par ngritjen e qendrave ekzistuese dhe përdorimi efikas i fondeve përkatëse.
- Qartësimi dhe plotësimi i të dhënave mbi shpenzimet e MSHMS-së për shërbime të ndryshme për viktimat e dhunës në familje për të cilat janë lëshuar UMPPM, UM ose UMM në të gjitha zonat e vendit, përfshirë ato rurale.
- Nevojën për trajnime dhe mbikëqyrje të sektorit të shëndetësisë, i cili mbetet një nga sektorët ku janë shfaqur më tepër problematika në drejtim të rolit të tyre për referim të rasteve të dhunës si dhe hartimit të raporteve mjekësore mbi çdo lëndim ose dëmtim, të nevojshme për t'u përdorur në proceset gjyqësore nga viktimat.
- Përshpejtimin e përpjekjeve për ngritjen e qendrave/programeve rehabilituese për dhunuesit në të gjitha qarqet e vendit, sa më shpejt dhe përpara afatit të parashikuar në SKBGJ, pasi programet aktuale janë të pamjaftueshme.
- Nevojën për bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet institucioneve përkatëse, ndër të cilat policia, gjykatat, shërbimi i provës dhe drejtoritë e burgjeve, për identifikimin dhe përfshirjen në programet e rehabilitimit të shkaktarëve të dhunës në familje.

⁹¹ Disa nga këto rekomandime janë bazuar në rekomandimet e Raportit të Avokatit të Popullit “Mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri për periudhën janar 2020 - shtator 2021”, të cilat mbeten ende për t'u adresuar, shih : [https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/RAPORT%20MONITORIM%20DHUNA%20JANAR%202020%20-%20SHTATOR%202022\[1164\].pdf](https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/RAPORT%20MONITORIM%20DHUNA%20JANAR%202020%20-%20SHTATOR%202022[1164].pdf)

SHTOJCA

RASTE STUDIMORE

Në këtë pjesë të raportit, analizohen tre raste femicidi. Rastet bazohen në disa nga ngjarjet më të rënda të ndodhura në vendin tonë ku viktimat mbetën 5 gra dhe vajza, 4 prej të cilave u vranë nga autorë me të cilët ishin në marrëdhënie familjare.

Rast studimor nr. 1

Vrasja e S.B. nga ish-bashkëshorti në shtëpinë e prindërve të saj, Fier 2021

Të dhëna mbi ngjarjen

Viktima S.B, ishte ish-bashkëshortja e autorit, nga martesë me të cilin kishte një fëmijë të mitur. Në momentin e ngjarjes, viktima ishte e pajisur me urdhër mbrojtje me afat njëvjeçar. Autori ishte dënuar edhe më parë për dhunë në familje, pasi kishte kërcënuar me armë nënën e viktimës. Për këtë vepër, ai ishte arrestuar dhe ndaj tij ishte vendosur masa e sigurimit arrest në burg. Gjatë kohës që autori ishte në burg, u zhvillua procesi i zgjidhjes së martesës ndërmjet viktimës dhe autorit, dhe vajza iu la për rritje dhe edukim viktimës. Pas 3 muajsh qëndrimi në IEVP, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier vendosi zëvendësimin e masës së sigurimit nga “arrest në burg” në “shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik”, pas kryerjes së aktit të ekspertimit për gjendjen e tij mendore. Sipas këtij akti, autori vuante nga një çrregullim psikik prej të paktën 2 vitesh, gjendje e cila i kishte prishur ekuilibrin mendor (diagnoza çrregullim psikik i paspecifikuar). Sipas aktit të ekspertimit: “Nëse sëmundja e tij nuk trajtohet dhe ndiqet rregullisht nga specialisti psikiater, sjellja e tij është e paparashikueshme dhe me pasoja”. U krye edhe një akt ekspertimi shtesë, i cili doli në të njëjtin përfundim dhe rekomandoi mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor. Katër muaj pas qëndrimit në spital nën masën kurim i detyruar në një institucion mjekësor, më 26.07.2021 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier vendosi zëvendësimin e masës mjekësore nga “mjekim i detyruar në një institucion mjekësor” në “mjekim i detyruar ambulator”, nën kujdesin e babait të tij. I pandehuri u urdhërua të paraqitej një herë në muaj pranë neuropsikiatrit në Poliklinikën e Specialiteteve, Fier. Në përmbajtje të këtij vendimi arsyetohet se, si provë në mbështetje të kërkesës, pala kërkuese paraqiti aktin “Informacion shëndetësor për pacientin E.B, nr.129 prot., datë 25.03.2021”, lëshuar nga përgjegjësi i sektorit të shëndetësisë në IEVP, Krujë. Më 21.07.2021, u krye akti i ekspertimit psikiatriko-ligjor nga një grup prej 3 ekspertësh, i cili rekomandoi masën mjekësore të kurimit të detyruar ambulator nën kujdesin e një familjari dhe ndjekjen e rregullt me specialistin psikiater.

Pas lirimit nga Institucioni i Posaçëm Mjekësor, i pandehuri filloi të kontaktonte me viktimën, duke përdorur si shkas për nisjen e bisedës vajzën e tyre, duke pyetur për të, por edhe duke i kërkuar llogari viktimës për jetën e saj (ku ishte, me kë ishte, çfarë bënte dhe duke u përpjekur ta bindte për t’u ribashkuar).

Më 10.09.2021 (rreth dy muaj pas daljes nga Institucioni i Posaçëm Mjekësor, ditën e ditëlindjes së tij, autori i dërgoi shumë mesazhe viktimës, të cilave ajo nuk iu përgjigj. Në darkë, rreth orës 22:10, autori shkoi në banesën e viktimës dhe kërkoi ta takojë. Sapo viktima doli dhe i kërkoi të sqaroheshin, ai e qëllloi disa herë me armë automatike, duke e lënë të vdekur në vend. Autori u dorëzua në polici të nesërmen e kryerjes së krimit.

Të dhëna mbi viktimën

Viktima ishte e moshës 23 vjeç, me arsim 8/9 vjeçar dhe ishte e punësuar në një ndërmarrje private në zonën ku banonte. Ajo banonte me prindërit e saj, në një zonë periferike të bashkisë së Fierit. Në lidhje me gjendjen e saj emocionale përpara ndodhjes së ngjarjes, nga dëshmitë e dhëna nga familjarët e saj rezultoi se viktima ndihej shumë e frikësuar, pasi autori e kishte kërcënuar edhe gjatë kohës që ishte në burg dhe vazhdonte ta shqetësonte duke i kërkuar llogari dhe duke i kërkuar të ribashkoheshin.

Historiku i dhunës ndaj viktimës

Viktima kishte lidhur martesë me autorin në moshë shumë të re. Rezultoi se viktima dhunohej në mënyrë të vazhdueshme nga autori, madje edhe në praninë e vajzës së mitur. Për shkak të xhelozisë, autori nuk e lejonte të shkonte në punë dhe e shoqëronte kudo që ajo shkonte, madje, siç thuhet në dëshmitë e familjarëve të viktimës, as tek prindërit e saj ajo nuk mund të qëndronte pa praninë e tij. Dhuna kishte shkuar duke u përshkallëzuar deri në momentin që viktima kishte vendosur të raportonte në polici. Autori kishte kërcënuar me armë edhe nënën e viktimës, vepër për të cilën ishte proceduar dhe mbajtur disa muaj në burg dhe më pas nën masën e sigurimit “mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”.

Pjesë nga dëshmia e nënës së viktimës:

“Vajza ime është martuar që 14 vjeçe, e rrëmbeu vajzë të vogël. Ai nuk e linte të punonte, madje dhe kur vinte në shtëpinë tonë vinte gjithmonë bashkë me të. Vajza nuk tregonte në lidhje me problemet që kishte, ai e dhunonte vazhdimisht edhe në sy të fëmijës. Edhe pse vajza më tregoi, unë e çoja atje vetëm për hatër të fëmijës, nuk doja të prishej martesën, për shkak të fëmijës. Vajza është larguar dy herë dhe unë e kam detyruar të shkojë përsëri. Ai e merrte vazhdimisht në telefon edhe kur ishte në burg.” Ajo u shpreh se autori ishte betuar se do ta vriste vajzën e saj nëse ajo do të ndahej me të.

Të dhëna mbi autorin

Autori është i moshës 28 vjeç, me status martesor i divorcuar, me banim në një zonë periferike të qytetit të Fierit. Ai kishte një fëmijë nga martesën me viktimën. Autori ishte me arsim të mesëm dhe i papunë në momentin e ngjarjes. Nga të dhënat nuk rezultoi se autori ishte përdorues i alkoolit apo lëndëve narkotike.

Ai vuante nga probleme të shëndetit mendor dhe në kohën e ngjarjes ishte nën masën “mjekim i detyruar ambulator”. Sipas dëshmive të dhëna pas ngjarjes, ai ndiqej në vijimësi nga një mjek psikiatër.

Autori ishte dënuar më parë për dhunë në familje, pasi kishte ushtruar dhunë ndaj bashkëshortes dhe nënës së saj. Në lidhje me qëndrimin që ka mbajtur autori për krimin e kryer përpara organeve kompetente, rezultoi se ai nuk ka shfaqur pendesë.

Nga të dhënat e dokumentacionit mbi rastin rezultoi se motivet e kryerjes së vrasjes lidhen me mospranimin e ndarjes së viktimës nga autori.

Procedimi penal dhe gjykimi i çështjes penale kundër autorit

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka paraqitur në gjykatë kërkesën për gjykim të të pandehurit të akuzuar për veprat penale: “Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare”, parashikuar nga neni 79/c i Kodit Penal; “Mbajtje pa leje e armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/7 i Kodit Penal; “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”, parashikuar nga neni 321/2; dhe “Prishje e rendit dhe qetësisë publike”, parashikuar në nenin 247 të Kodit Penal. Akuzat janë bazuar në prova konkrete të mbledhura gjatë zhvillimit të procesit hetimor mbi ngjarjen. Prokuroria ka kërkuar dënimin e të pandehurit me burgim të përjetshëm. Mbrojtësi i të pandehurit kërkoi pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit, pasi pretendoi papërgjegjshmërinë e tij dhe kërkoi shtrimin e tij në një Institucion të Posaçëm Mjekësor. Përfaqësuesi i trashëgimtarëve të viktimës kërkoi dënimin e autorit me burgim të përjetshëm.

Gjatë shqyrtimit të çështjes gjyqësore kundër autorit, gjykata nuk pranoi kërkesën e mbrojtjes për të kryer aktin e ekspertimit psikiatriko-ligjor. Gjykata arsyetoi se, megjithëse autori ishte nën masën “mjekim i detyruar ambulator” në momentin e ngjarjes, gjendja e tij ishte e stabilizuar dhe ai ishte i përgjegjshëm ligjërisht. Në këtë konstatim gjykata arriti bazuar në thëniet e dëshmitarëve (prindërve të autorit), sipas të cilëve ai e merrte mjekimin rregullisht dhe konsultohet rregullisht me një psikiatër, si dhe bazuar në shqyrtimin e korrespondencës së tij përpara ngjarjes, e cila sipas gjykatës, tregonte për gjendje të stabilizuar mendore.

Gjykata nuk konstatoi asnjë rrethanë lehtësuese të parashikuar nga neni 49 i Kodit Penal, ndërsa në lidhje me rrethanat rënduese, gjykata analizoi faktin e kryerjes së veprës penale ndaj personit të pajisur me urdhër mbrojtje, rrethanë e parashikuar nga neni 50, germa “e”, i KP.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes morën pjesë trashëgimtarët e viktimës, prindërit e saj, të cilët nëpërmjet dëshmive të tyre treguan se viktimja ishte dhunuar në mënyrë të vazhdueshme nga autori dhe se kishin shprehur rezervat e tyre në lidhje me nxjerrjen e tij nga burgu nën masën “kurim i detyruar ambulator”.

Kohëzgjatja e procedurave nga data e ndodhjes së ngjarjes deri në datën kur vendimi mori formë të prerë ishte 17 muaj (hetimi dhe gjykimi i çështjes). Kohëzgjatja e çështjes nga data e regjistrimit në gjykatë deri në datën e marrjes së vendimit formë të prerë ishte 10 muaj.

Gjykata nuk e ndryshoi kualifikimin e veprës penale, duke u bazuar në kualifikimin e bërë nga prokuroria.

Autori u dënua me burgim të përjetshëm, vendimi u ankimua dhe Gjykata e Apelit e la atë në fuqi.

Komente mbi çështjen

Vendimi i gjykatës, nga forma dhe përmbajtja, është një vendim i arsyetuar mirë, me një analizë të detajuar të elementëve të veprës penale dhe të provuarit të tyre. Vendimi përmban një analizë të plotë për gjykatën kompetente, aspektet materiale dhe procedurale, kërkesat e parashtruara nga palët dhe argumentet përkatëse. Mendojmë se në kushtet kur autori ndodhej nën masën “mjekim i detyruar ambulator” në momentin e ngjarjes, gjykata duhej të kishte pranuar kërkesën e avokatit mbrojtës për kryerjen e ekspertimit psikiatriko-ligjor, bazuar në mundësinë e përkeqësimit të sëmundjes, dhe në faktin se disa muaj më parë autori kishte qenë i shtruar në një spital psikiatrik, pas kryerjes së aktit të ekspertimit të shëndetit të tij mendor.

Ekspertimi i shëndetit mendor në këto raste është i rëndësishëm, jo vetëm për të vlerësuar përgjegjshmërinë e autorëve, por edhe për t’u siguruar në lidhje me shëndetin mendor të autorëve, me qëllim adresimin e duhur të nevojave të tyre për mjekim gjatë kohës së qëndrimit në I EVP. Vlerësimi i gjendjes mendore të autorëve të krimeve të tilla kaq të rënda është tepër i rëndësishëm edhe në funksion të shmangies së ngjarjeve që mund të zhvillohen në ambientet e burgut, ku autorët mund të rrezikojë shëndetin dhe jetën e të dënuarve të tjerë.

Vlen të theksohet fakti se gjykata e lidh kryerjen e veprave të tilla në marrëdhëniet familjare me motivet diskriminuese që lidhen me gjininë, por nuk referon në dispozitën përkatëse që lidhet me rrethanën rënduese të kryerjes së veprës penale për shkak të gjinisë.⁹² Gjithashtu, gjykata mban parasysh se vendi i zgjedhur për kryerjen e kësaj vepre, banesa në të cilën jetonin edhe familjarët e viktimës se bashku me vajzën e saj të mitur, shtoi rrezikshmërinë e kësaj vepre penale.

Në lidhje me fajësinë e autorit, gjykata arsyeton se kjo vepër u krye me shkallën më të lartë të fajit, nëpërmjet dashjes së paramenduar. Gjithashtu gjykata mban parasysh faktin se autori nuk shfaqti asnjë shenjë pendese në lidhje me krimin e kryer, duke treguar një mungesë të theksuar ndjeshmërie ndaj pasojave dhe gjendjes emocionale që solli ky krim tek fëmija i mitur.

Dënimi penal i dhënë ndaj autorit është dënimi maksimal i parashikuar nga dispozitat përkatëse, pasi gjykata ka dhënë dënim me burgim të përjetshëm. Autori do ta vuajë dënimin në një burg të sigurisë së lartë. Procedimi penal dhe shqyrtimi gjyqësor në shkallën e parë dhe në Gjykatën e

⁹²Gjykata shprehet se kjo vepër paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore, duke parë tendencën në rritje të këtyre veprave penale të cilat ndodhin në ambientet familjare për motive diskriminuese ndaj gjinisë femërore.

Apelit u krye brenda afateve shumë të arsyeshme, bazuar në vendimet e tjera të analizuara në kuadër të këtij raporti.

Sa i përket analizimit të marrëdhënieve ndërmjet palëve përpara ngjarjes, prokuroria dhe gjykata janë fokusuar në marrjen e dëshmive të familjarëve, por nuk është marrë informacion nga koordinatori vendor apo anëtarë të tjerë të MKR-së. Në kushtet kur viktimja ishte e pajisur me UM në momentin e ngjarjes, prokuroria duhej të ishte thelluar në marrjen e informacionit nga strukturat kompetente në lidhje me masat që ishin marrë për monitorimin e respektimit të UM-së. Të dhënat e sjella nga bashkia Fier tregojnë se viktimja ishte trajtuar nga MKR Fier dhe se kontaktohej në mënyrë të vazhdueshme nga administratori social në njësisë administrative ku ishte e regjistruar në regjistrin e gjendjes civile. Viktimja trajtohej me ndihmë ekonomike në vlerën 9900 lekë në muaj, pasi ishte e pajisur me UM me afat 1-vjeçar. Gjatë kohës që autori ishte në burg, viktimja kishte deklaruar se nuk ndihej e rrezikuar nga dhunuesi. Referohet se koordinatori vendor në bashkinë e Fierit nuk ishte njoftuar për daljen e autorit nga IEVP Krujë, dhe se nuk kishte pasur informacion se ai ishte nën masën “mjekim i detyruar ambulator”.

Në rastet e daljes nga burgu të dhunuesve, përveç dërgimit të njoftimit në kohë pranë policisë nga DPB-ja, është e nevojshme që ky informacion t’i vihet në dispozicion edhe viktimës dhe koordinatorit vendor ose punonjësit përgjegjës për monitorimin e respektimit të UM.

Në funksion të adresimit të kësaj çështje rekomandojmë që në vendimet që lidhen me dhunën ndaj grave, gjykata të urdhërojë njoftimin në kohë të të mbijetuarave nga organet kompetente në lidhje me lirin e autorëve.

Monitorimi me efikasitetin e duhur i urdhrave mbrojtës kërkon jo vetëm koordinim ndërmjet strukturave përgjegjëse, por edhe rivlerësim të rrezikut për sigurinë e viktimës në rastet e daljes nga IEVP të autorëve të dënuar për vepra penale që lidhen me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje.

Rast studimor nr. 2

Vrasja e L.B, menjëherë pas daljes nga gjykata, Elbasan, 2021

Të dhëna mbi ngjarjen

Viktimja L.B, ishte bashkëshortja e autorit, nga martesja me autorin ajo kishte dy fëmijë në moshë madhore.

Rreth 5 muaj përpara vrasjes, viktimja kishte paraqitur kallëzim penal ndaj autorit, për veprën penale “dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal (procedimi penal nr.2065, datë 04.12.2020). Për këtë çështje autori ishte marrë i pandehur nga Prokuroria e Rrethit

Gjyqësor Elbasan dhe po procedohej në gjendje të lirë. Ditën e ngjarjes, më 06.05.2021, çështja ishte duke u shqyrtuar në Gjykatën e Shkallës së parë Elbasan, ku i pandehuri nuk u paraqit. Në gjykatë ishte paraqitur viktimja e shoqëruar nga dy djemtë e saj dhe, pas mbarimit të seancës gjyqësore, dolën nga gjykata dhe u nisën për të shkuar në shtëpi. Në kryqëzimin pranë gjykatës i priste autori, i cili përpara se të qëllonte mbi viktimën, u ishte drejtuar me fjalët, “ju kam thënë se do ju vras”. Më pas ai qëlloi disa herë me armë zjarri në drejtim të viktimës, e cila u rrëzua menjëherë në tokë si pasojë e plumbave të marrë. Në këtë moment i biri, i ndihmuar edhe nga një person i tretë, i ka hequr nga dora armën autorit. Në këtë moment ai nxori një thikë nga xhepi dhe shkoi dhe e goditi me thikë në qafë viktimën, për t’u siguruar për vdekjen e saj. Autori tentoi të largohej, por u arrestua në flagrancë nga policia. Nga kjo ngjarje mbetën të plagosur edhe dy kalimtarë të rastit, njëri prej të cilëve u plagos rëndë.

Të dhëna mbi viktimën

Viktima ishte e moshës 54 vjeç. Nga martesë me autorin ajo kishte dy fëmijë në moshë madhore. Viktima ishte me arsim të mesëm dhe ishte e papunë. Ajo gëzonte shëndet të mirë fizik dhe mendor. Në lidhje me gjendjen e saj emocionale përpara ndodhjes së ngjarjes, sipas dëshmitëve të dhëna nga dy djemtë e saj, ajo ishte e frikësuar nga veprimet që mund të ndërmernte autori ndaj saj pas raportimit në polici, duke njohur karakterin e tij të dhunshëm. Viktima kishte nisur procesin për zgjidhjen e martesës me autorin dhe ishte larguar nga banesa e përbashkët dhe kishte shkuar të jetonte me familjarët të saj.

Historiku i dhunës ndaj viktimës

Nga dëshmitëve të dhëna nga dy fëmijët e viktimës rezulton se autori ushtronte dhunë në mënyrë të vazhdueshme ndaj nënës së tyre dhe se ajo kishte raportuar vetëm një herë në polici. Pas raportimit të dhunës, viktimja ishte larguar nga banesa bashkëshortore pasi ishte e frikësuar nga veprimet që mund të ndërmernte autori ndaj saj.

Të dhëna mbi autorin

Autori është i moshës 62 vjeç, me status civil i martuar, me banim në bashkinë e Elbasanit. Autori ishte me arsim të mesëm, i punësuar në momentin e ngjarjes. Autori kishte punuar disa vite si punonjës policie. Ai gëzonte shëndet të mirë fizik dhe mendor. Nga të dhënat nuk rezulton se autori ishte përdorues i alkoolit apo lëndëve narkotike. Autori nuk ishte dënuar më parë. Sa i përket qëndrimit që mbajti përpara organeve kompetente në lidhje me krimin e kryer, rezulton se autori nuk ka shfaqur pendesë, ai e refuzoi mbrojtjen me avokat të caktuar nga gjykata si dhe përdori fjalë fyese ndaj prokurorit dhe trupit gjykues.

Procedimi penal dhe gjykimi i çështjes penale kundër autorit

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan paraqiti në gjykatë kërkesën për gjykimin ndaj të pandehurit K.B, i akuzuar për veprat penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal; “Vrasje

për shkak të marrëdhënieve familjare”, parashikuar nga neni 79/c të kodit penal; “Mbajtje pa leje e armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/7 i Kodit Penal; “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”, parashikuar nga neni 321/2; dhe “Prishje e rendit dhe qetësisë publike”, parashikuar në nenin 247 të Kodit Penal. Akuzat u bazuan mbi një tërësi provash të mbledhura gjatë zhvillimit të procesit hetimor mbi ngjarjen. Prokuroria kërkoi dënimin e të pandehurit me burgim të përjetshëm.

Mbrojtësi i të pandehurit, i caktuar kryesisht nga gjykata, kërkoi pushimin e çështjes penale në ngarkim të pandehurit pasi pretendoi papërgjegjshmërinë e tij. Nga akti i ekspertimit psikiatriko-ligjor që u krye, rezultoi se autori nuk i plotësonte kushtet për diagnostikimin e sëmundjes së shëndetit mendor.

Gjykata bëri një analizë të hollësishme ligjore të faktit dhe provave të shqyrtuara dhe të administruara gjatë gjyqimit, pas të cilave konkludoi se vepra penale ishte kryer me paramendim dhe dashje direkte.

Gjykata analizoi mizorinë e kryerjes së krimit, që lidhet me faktin se pas goditjes disa herë me armë, autori e goditi viktimën edhe me thikë, me faktin se vepra u krye në prani të dy fëmijëve të tyre, si dhe rrezikshmërinë dhe pasojat që sjell përdorimi i armës në një ambient publik.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes trashëgimtarët e viktimës nuk morën pjesë .

Kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor të çështjes ishte 5 muaj, ndërsa kohëzgjatja e procedurave nga data e ndodhjes së ngjarjes deri në datën kur vendimi mori formë të prerë ishte 18 muaj.

Gjykata nuk e ndryshoi kualifikimin e veprës penale, duke u bazuar në kualifikimin e bërë nga prokuroria.

Në lidhje me këtë ngjarje, me vendimin nr.235, datë 27.04.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, autori u dënua me burgim të përjetshëm. Ky vendim u ankimua nga i pandehuri dhe më datë 06.12.2023, Gjykata e Apelit vendosi lënien në fuqi të atij vendimi.

Komente mbi çështjen

Rezulton se policia nuk i kishte plotësuar viktimës UMM/UM, duke u mjaftuar me marrjen e kallëzimit penal për dhunë në familje. Në zbatim të legjislacionit kundër dhunës në familje plotësimi i UMM/UM-së dhe procedimi penal i dhunuesit janë dy procese të cilat duhet të zhvillohen paralelisht, pasi plotësimi i UMM/UM-së i shërben jo vetëm marrjes së masave për mbrojtjen e integritetit të viktimës, por ndihmon edhe në përfshirjen e saj në shërbimet mbështetëse. Mospajisja e viktimës me UM/UM në rastet e kallëzimit në polici dhe procedimi në gjendje të lirë i autorit ndikojnë drejtpërdrejt në ekspozimin e saj ndaj rrezikut për përshkallëzim

të dhunës. Duke mos i plotësuar viktimës kërkesëpadinë me objekt lëshimin e UMM/UM-së, strukturat e policisë nuk u angazhuan në vlerësimin e rrezikut për sigurinë e viktimës, duke mos i kushtuar vëmendjen e nevojshme mbrojtjes dhe mbështetjes së viktimës. Gjithashtu duke mos qenë e pajisur me UM, viktima nuk kishte përfituar as mbështetje me ndihmë ekonomike.

Nga të dhënat e sjella nga bashkia Elbasan, rezulton se rasti nuk ishte referuar nga policia apo ndonjë anëtar tjetër i MKR-së pranë koordinitorit vendor, dhe rrjedhimisht nuk ishte trajtuar nga MKR dhe nuk kishte përfituar asnjë shërbim si viktimë e dhunës në familje.

Nuk rezulton që prokuroria apo gjykata të kenë kërkuar informacion nga koordinatorët vendorë apo anëtarë të tjerë të MKR-së në bashkinë e Elbasanit, me qëllim njohjen me hapat e ndërmarra nga strukturat përgjegjëse në mbështetje të viktimës pas raportimit të dhunës në polici. Në kërkesën për gjykim dhe në vendim nuk analizohet historiku i dhunës ndaj viktimës dhe pasojat e saj ndaj viktimës.

Në vendim nuk janë analizuar motivet e kryerjes së krimit dhe nuk është parashtruar si rrethanë rënduese kryerja e veprës e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, e parashikuar në nenin 50/J të Kodit Penal.

Rast studimor nr. 3

Gratë dhe vajzat e vrara dhe të plagosura nga D.H.

Të dhëna mbi ngjarjen

Dy javë pas daljes nga burgu ku vuajti dënimin për veprën penale dhunë në familje ndaj ish-bashkëjetueses së tij, D.H vrau 3 gra/vajza dhe plagosi 3 të tjera. Ngjarja e rëndë, që tronditi mbarë opinionin publik, ndodhi më 01.03.2023. Autori fillimisht plagosi ish të dashurën e tij, dhe më pas vrau dhe plagosi 4 gra, nga të cilat njëra ishte ish-bashkëjetuesja e tij, ndërsa 3 të tjerat familjaret e saj. Viktima e gjashtë ishte motra e një personi me të cilin autori kishte pasur konflikte gjatë kohës kur vuante dënimin për dhunë në familje.

Konflikti me bashkëjetuesen kishte filluar në lidhje me shtatzëninë e saj, sepse autori pretendonte që ai nuk ishte babai biologjik i fëmijës.⁹³ Autori dhe ish-bashkëjetuesja e tij janë konfliktuar me njëri-tjetrin në lidhje me këtë fakt, dhe gjatë këtyre konflikteve autori i ka thënë se do t'ia shuante të gjithë familjen, si dhe thuri planin për këtë qëllim. Viktima e parë që mbeti e plagosur ishte një shtetase me të cilën autori pretendonte se kishte pasur marrëdhënie intime dhe së cilës i kishte dhënë një shumë parash borxh. Pas kësaj ngjarjeje, autori u nis për tek banesa e ish-bashkëjetueses së tij⁹⁴ me qëllimin për ta vrarë. Kur hyri në oborr, ai pa motrën dhe kunatën e saj. Fillimisht tentoi t'i godasë me armë, por duke qenë se arma iu bllokua, i goditi disa herë me

⁹³Ish-bashkëjetuesja e tij, e cila mbeti e plagosur në këtë ngjarje, kishte rreth dy javë që kishte lindur fëmijën nga bashkëjetesa me autorin.

⁹⁴E cila, pas ndarjes me autorin, ishte rikthyer për të jetuar me familjen e saj.

thikë. Më pas u fut brenda, ku u përball me ish-bashkëjetuesen dhe nënën e saj. Në fillim kërkoi nëse kishte anëtarë të tjerë të familjes në shtëpi dhe më pas, me thikën që kishte në dorë, zhbllokoi armën dhe qëlloi në drejtim të ish-vjehrrës. Në këto momente i doli përpara ish-bashkëjetuesja e tij dhe të dyja kanë mbetur të plagosura. Më pas autori doli në oborr dhe gjuajti përsëri me armë në drejtim të automjetit në të cilin kishte lënë të varurë motrën e ish-bashkëjetueses, dhe u largua. Pasi u largua, shkoi në drejtim të banesës së një shtetasi me të cilin kishte pasur konflikte kur ishte në burg, kapërceu murin rrethues dhe u fut në banesë. Aty u përball me një grua dhe një vajzë, të cilën e ka pyetur nëse ishte e motra e personit me të cilin ishte konfliktuar në burg. Kur ajo pohoi me kokë, ai e qëlloi për vdekje.

Sipas deklarimeve të tij në polici dhe prokurori, autori tha se vrasjet dhe plagosjet në familjen e ish-bashkëjetueses i kreu për të marrë hak ndaj saj dhe familjarëve të saj, të cilët më herët e kishin denoncuar për dhunë në familje. Krimi ndodhi 14 ditë pasi autori doli nga burgu. Autori kreu 3 vrasje me armë zjarri dhe 3 plagosje me thikë. Autori i pranoi akuzat dhe nuk shprehu pendim për krimet e kryera. Deklarata e tij në prokurori ishte: "Nuk më vjen keq. Unë i kam kryer krimet me vetëdije të plotë - dhe jam i vetëdijshëm për atë që kam bërë."

Autori ndodhet aktualisht nën masën e sigurisë "arrest me burg". Ai është vendosur në një burg të sigurisë së lartë dhe ka tentuar të arratiset. Gjatë kësaj kohe ai është përfshirë edhe në ngjarje të tjera kriminale brenda burgut.

Të dhëna mbi viktimat

Viktimat M.H dhe H.D, ishin përkatësisht motra dhe bashkëshortja e vëllait të ish-bashkëjetueses së autorit. Ato ishin të grup moshës 30-44 vjeç, me status civil të martuara, M.D., ishte shtatzënë në momentin e vrasjes. Viktimat ishin me arsim të mesëm dhe nuk ishin në marrëdhënie pune përpara ngjarjes. Ato u përballën të parat me autorin dhe u përpoqën ta qetësonin dhe të parandalonin ngjarjen që iu kushtoi jetën. Viktima e tretë, V.K., ishte e grup moshës 15-29 vjeç, me status civil beqare, me arsim 8/9 vjeçar. Ajo ishte në marrëdhënie pune përpara ngjarjes. Ajo u vra nga autori në shenjë hakmarrjeje ndaj vëllait të saj, me të cilin ai ishte konfliktuar në burg.

Historiku i dhunës ndaj viktimave

Nga të dhënat, rezulton se ngjarja e rëndë erdhi pasi autori kërkoi të hakmerret ndaj ish-bashkëjetueses së tij, e cila e kishte raportuar në polici.

Autori dhe ish-bashkëjetuesja e tij ishin lidhur në martesë faktike (duke bërë edhe dasmë), rreth 9 muaj përpara ngjarjes. Konfliktet midis tij dhe bashkëjetueses kishin lindur për shkak të xhelozisë së autorit dhe dyshimit të tij në lidhje me shtatzëninë e saj. Autori ishte ndarë me bashkëjetuesen e tij dhe, disa ditë më vonë, ishte thirrur nga familjarët e saj për t'u sqaruar, por ata kishin njoftuar policinë dhe atë e kishin arrestuar. Pas arrestimit, ai u dënua për veprën penale "Dhunë në familje", parashikuar nga neni 130/a i KP-së, vepër për të cilën autori pretendon se u arrestua padrejtësisht dhe se nuk i ishin respektuar të drejtat gjatë burgimit.

Të dhëna mbi autorin

Autori është i grup moshës 30-44 vjeç, i lindur në Kukës dhe banues në Kamëz, me status civil i divorcuar, pa fëmijë, me arsim të mesëm, i papunësuar përpara ngjarjes. Autori rezulton i dënuar 3 herë përpara ngjarjes⁹⁵ - një herë për vrasjen e bashkëshortes së parë, një herë për dhunë në familje dhe pengmarrje, dhe herën e tretë për dhunë në familje. Nga të dhënat nuk rezulton se autori ishte përdorues i alkoolit apo lëndëve narkotike.

Procedimi penal dhe gjykimi i çështjes penale kundër autorit

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë paraqiti në gjykatë kërkesën për gjykimin e të pandehurit D.H., i akuzuar për veprat penale “Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” të shtetaseve M.H. dhe H.D. (neni 79/c i KP-së); “Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” mbetur në tentativë, ndaj shtetaseve A.H. dhe K.H., (neni 79/c dhe 22 i KP-së); “Vrasje me paramendim” e shtetases V.K. (neni 78/2 dhe 22 e Kodit Penal); “Sigurim i kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasjen” (neni 80 i KP-së); “Mbajtje pa leje e armëve shpërthyesë dhe municionit”, (neni 278/7 i KP)ë “Prodhim, mbajtje, blerje apo shitje pa leje e armëve të ftohta”, (neni 279/1 i KP-së). Për këto ngjarje Gjykata e Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr.466, datë 4.03.2023, vendosi pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe kalimin e çështjes për gjykim.

Komente mbi çështjen

Çështja është në proces shqyrtimi gjyqësor dhe janë zhvilluar disa seanca gjyqësore,⁹⁶ disa prej të cilave janë shtyrë kryesisht për shkak të kërkesave për shtyrje nga avokatët, mungesës së anëtarëve të trupit gjykues, transferimit të tyre, si dhe mosrealizimit të njoftimit të trashëgimtarëve të viktimave.

Në kërkesën e prokurorisë jepen shumë pak të dhëna në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet autorit dhe bashkëjetueses së tij dhe nëse ai kishte ushtruar më parë dhunë ndaj saj apo familjarëve të saj. Në kërkesë nuk jepen të dhëna në lidhje me vendimin e dënimit të autorit për veprën penale të dhunës në familje dhe nëse ish-bashkëjetuesja apo familjarët e saj ishin pajisur me UMM/UM pas raportimit të dhunës.

Në disa prej seancave ka marrë pjesë edhe i pandehuri, ku ka parashtruar pretendimet e tij në lidhje me problemet shëndetësore dhe papërshtatshmërinë e ambienteve të burgut ku qëndron i paraburgosur.

⁹⁵Në vitin 2007, autori kishte vrarë me thikë gruan e tij të parë (vetëm 22 vjeçe), për të cilën ishte dënuar me 14 vite burgim. Ndërsa në vitin 2003 ai ishte dënuar me 2 vjet e 8 muaj burgim për veprën penale “Heqje e paligjshme e lirisë” (neni 110/2 i KP).

⁹⁶ Institucioni i Avokatit të Popullit po monitoron seancat gjyqësore në lidhje me këtë çështje.

Megjithëse nga gjykata i është caktuar një avokat mbrojtës, i pandehuri ka shprehur mosbesimin e tij në lidhje me mbrojtjen që mund t'i ofrohet prej tij, duke e justifikuar me faktin se veprat penale janë aq të rënda sa asnjë avokat mbrojtës nuk mund ta mbrojë.

Trashëgimtarët e viktimave A.H. dhe H.D. përfaqësohen në këtë proces nga avokati i tyre mbrojtës, ndërsa trashëgimtarët e viktimës V.K. nuk kanë marrë pjesë në proces.

Kryerja e vrasjeve vetëm disa ditë pas daljes së autorit nga burgu nxjerr në pah nevojën e marrjes së masave për përfshirjen e dhunuesve në programe rehabilituese gjatë qëndrimit në IEVP dhe mbajtjen e tyre nën vëzhgim pas lirimit nga burgu.

Në funksion të parandalimit të ngjarjeve të tilla, DPB duhet të rishikojë praktikën e bashkëpunimit me strukturat e policisë. Në këtë kuadër mendojmë se do të ishte me shumë vlerë përcjellja e një relacioni shpjegues mbi ecurinë e procesit rehabilitues dhe mbi nevojën për ndjekje në vijimësi për të dënuarit për vepra penale që lidhen me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje.

INTERVISTA ME FAMILJARËT E VIKTIMAVE

Pas analizimit të dokumentacionit të sjellë nga institucionet përgjegjëse, u identifikuan familjarë të viktimave të cilët mund të intervistoheshin. Në këtë kuadër, u zgjodh një familjare e rritur dhe një e mitur.

Intervista nr.1

Në përputhje me vullnetin e trashëgimtares së intervistuar, përshkrimi i rastit është bërë bazuar në parimin e ruajtjes së anonimitetit.

Zonja e intervistuar është e moshës 44 vjeç; ajo është motra e njëres prej viktimave, e martuar dhe ka tre fëmijë nga të cilët dy në moshë madhore dhe një në moshë të mitur. Ajo thotë se informacionin në lidhje me ngjarjen e mori nga familjarët e saj. Që pas ndodhjes së ngjarjes ajo mban dhe kujdeset për tre fëmijët e mitur të motrës së saj. Në lidhje me gjendjen shëndetësore ajo thotë se është e aftë për punë por gjendja psiko-emocionale e saj pas vdekjes së motrës nuk është e mirë, ajo shprehet se ka probleme me ankthin dhe pagjumësinë.

Në lidhje me gjendjen social-ekonomike të familjes së saj, ajo shprehet se e përballojnë me shumë vështirësi jetesën, sidomos prej rreth një viti e gjysmë, që kur kanë marrë përsipër rritjen dhe edukimin e tre fëmijëve të së motrës.

Në lidhje me mbështetjen e ofruar nga institucionet menjëherë pas ngjarjes, ajo thotë se mban mend vetëm punonjësit e policisë të cilët vinin herë pas here. “Isha shumë e tronditur,” thotë ajo “dhe nuk mbaj shumë mend”.

Në lidhje me shërbimet e ofruara, ajo shprehet se disa ditë më pas ajo u kontaktua nga punonjësit përgjegjës pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është me banim, të cilët i kërkuan që të bënin një vizitë në familje. Pas kryerjes së kësaj vizite, punonjësit përgjegjës ndërmjetësuan me një organizatë që ofron mbështetje për fëmijët, me qëllim mbështetjen me ndihmë psikologjike dhe pako ushqimore. Ajo thotë se mbështetja ishte minimale dhe vetëm për një kohë të shkurtër. Në lidhje me ndihmën psikologjike⁹⁷, ajo thotë se fëmijët nuk kishin pasur mundësi të kishin akses në të për shkak të largësisë dhe mospërshtatjes së orareve. Ajo shprehet se nuk ka marrë asnjë lloj ndihme tjetër që prej kohës kur ka ndodhur ngjarja.

Në lidhje me mbështetjen financiare, ajo thotë se kjo mbështetje jepet pasi të ketë marrë kujdestarinë e fëmijëve me vendim gjykatë. Zonja shprehet se me kursimet e familjes zgjodhi një avokat privat për ndjekjen e çështjes së vrasjes së motrës së saj në gjykatë, si dhe për procesin gjyqësor në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve. Megjithatë ajo shpreh shumë rezerva ndaj këtij të fundit, pasi sipas saj ai i ka neglizhuar çështjet e marra përsipër.

Në lidhje me vrasjen e motrës së saj, zonja thotë se nuk është thirrur asnjëherë për të dhënë dëshmi në lidhje me ngjarjen, apo në lidhje me marrëdhëniet që kishin palët përpara ngjarjes. Ajo shprehet se autori ushtronte në mënyrë të vazhdueshme dhunë ndaj viktimës dhe fëmijëve. Madje rreth një vit përpara ndodhjes së ngjarjes, ajo e kishte bindur motrën e saj të shkëpuste marrëdhënien me autorin dhe ishte përpjekur ta ndihmonte për t'u sistemuar së bashku me fëmijët në zonën ku ajo banon. Por, siç shton ajo, motra e saj vendosi të kthehej përsëri me autorin, me shpresën se gjërat do të ndryshonin, por dhuna u përshkallëzua deri në vrasjen e saj.

Përveç dhimbjes së madhe për humbjen e njeriut të dashur ajo thotë se u përball me vështirësi të shumta, nga të cilat më e vështira ishte përballimi i traumës pas ngjarjes dhe përkujdesja për fëmijët e motrës, të cilët ishin në gjendje shumë të rënduar psiko-emocionale.

Në lidhje me raportimin që ju bë ngjarjes në media ajo shprehet se u përhapen lajme të pavërteta. Ajo sugjeron që mediat duhet të kenë më tepër ndjeshmëri dhe të tregojnë shumë kujdes kur raportojnë në lidhje me ngjarje të tilla, për të mos ua rënduar më tepër dhimbjen familjarëve dhe, në mënyrë të veçantë, fëmijëve.

Në lidhje me pyetjen nëse ngjarja mund të parandalohet, zonja shprehet se ajo ishte përpjekur shumë për ta bindur motrën e saj t'i jepte fund marrëdhënies me autorin, por kishte qenë e pa fuqishme. Ajo shton se, pasi motra u largua nga bashkëshorti rreth një vit më parë, u përball me vështirësi të shumta, ajo raportoi edhe në polici pas dhunës së ushtruar nga autori, por më pas hoqi dorë.

⁹⁷ Fëmijët morën shërbim psikologjik vetëm dy herë pranë kësaj organizate.

Ajo thotë se kur një grua shkon në polici për të raportuar, ngjarja duhet ndjekur nga policia edhe nëse viktima heq dorë, sepse nëse do të kishte marrë mbështetjen e nevojshme pas raportimit në polici, ajo ndoshta nuk do të ishte detyruar të rikthehej me autorin.

Në fund e intervistuar ka një mesazh për gratë dhe vajzat që përballen me dhunën. Ajo thotë se: “Gratë dhe vajzat duhet ta gjejnë forcën për ta raportuar dhunën dhe për të mos hequr dorë; ato nuk duhet të reshtin se mbrojturi të drejtat e tyre. Ato duhet të luftojnë fort për veten dhe fëmijët e tyre”.

Intervistë me një të mitur të prekur nga femicidi

Intervista u zhvillua në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë bashkisë përkatëse dhe në prani të punonjësës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve⁹⁸

E mitura është e moshës 14 vjeç; në kohën e ngjarjes ishte në moshën 13 vjeçare. Ajo ka një motër më të madhe dhe një vëlla më të vogël, të tre janë në moshë të mitur. Vajza shpjegoi se ka marrëdhënie të mirë me motrën dhe vëllain, me familjen e tezes, si dhe me familjarët e tjerë nga e ëma. Ndërsa në lidhje me të afërmit nga babai, e mitura u shpreh se nuk kishin kontakte dhe se ata nuk kishin treguar interes për ta.

E mitura gëzon shëndet të mirë fizik dhe emocional, ajo ndihet e sigurt dhe e mbrojtur pranë familjes së tezës së saj, ku është akomoduar pas ngjarjes. Aktualisht ajo është në klasën e shtatë⁹⁹ dhe frekuenton rregullisht shkollën.

Në lidhje me mbështetjen që iu ishte ofruar nga institucionet përgjegjëse menjëherë pas ngjarjes, e mitura u shpreh se nuk i ka takuar askush “kur ndodhi ngjarja ne po luanim në oborrin e pallatit, erdhi dhe na mori halla, pas dy ditësh u zhvendosem tek teza”.

Në lidhje me shërbimet që iu ofruan më pas nga institucionet e mitura shprehet se “Disa ditë pas ndodhjes së ngjarjes, punonjëset e bashkisë erdhën tek shtëpia e tezes dhe na vizituan, me pas ata sollën një shoqatë që punon me fëmijët¹⁰⁰ që të na vizitonte dhe mbështeste. Shoqata na ofroi disa pako ushqimore, si dhe mua më morën dy herë tek qendra e tyre ku më ofruan ndihmë psikologjike”. E mitura u shpreh se nuk kishte mundur të shkonte rregullisht për të marrë shërbime pranë kësaj organizate për shkak të largësisë së vendbanimit nga vendndodhja e shoqatës, si dhe për arsye se orët e mësimi në shkollë i bënte në turnin e dytë.

⁹⁸ Fëmijët ishin nën menaxhimin e kësaj punonjëseje, e cila ishte njohur me rastin e tyre pas referimit të kryer nga bashkia ku kishin qenë me banim fëmijët në momentin e ngjarjes.

⁹⁹ E mitura shpjegoi se e kishte humbur një vit shkollor për shkak se e ëma ishte zhvendosur në një qytet tjetër pranë familjarëve të saj së bashku me tre fëmijët për shkak të dhunës që ushtronte i ati. Ajo ishte regjistruar në shkollë në qytetin ku ishin zhvendosur por pasi ata ishin rikthyer në qytetin e tyre të lindjes, nuk ishte bërë i mundur transferimi në shkollën përkatëse.

¹⁰⁰ Nga komunikimi me PMF-në, u raportua se pas njohjes me nevojat e tyre e mitura së bashku me vëllain dhe motrën ishte referuar pranë një shoqate që ofron shërbime për fëmijët, ku ju ishte ofruar trajtim psikologjik dhe mbështetje me pako ushqimore.

Duke qenë se shkolla ku e mitura studion nuk ka psikolog, ajo nuk është trajtuar më tej nëpërmjet këtij shërbimi.

Në lidhje me të atin (autorin e vrasjes), e mitura u shpreh se ai u kishte dërguar një letër nga burgu, ku kërkonte t'i takonte, por fëmijët nuk kishin pranuar. Në lidhje me marrëdhëniet që e mitura kishte me të atin përpara ngjarjes, ajo u shpreh se nuk kishte pasur marrëdhënie të mira, pasi ai ishte shumë i ashpër dhe ushtronte dhunë edhe ndaj tyre.

Në lidhje me pyetjen nëse ndonjëri prej të miturve ishte thirrur për të dhënë dëshmi në lidhje me ngjarjen, ajo u shpreh se motra e saj ishte thirrur për të dëshmuar, ndërsa ajo vetë dhe vëllai, jo.

Në lidhje me raportimin në media të ngjarjes, e mitura u shpreh se kishin thënë gjëra të pavërteta në lidhje me nënën e saj dhe kjo gjë i kishte mërzhitur shumë. Në lidhje me pyetjen nëse ngjarja mund të parandalohet ajo u shpreh se nëna e saj duhet të kishte kërkuar të ndahej nga i ati dhe të kishte kërkuar ndihmë.

Në lidhje me mesazhin që do të përcillte për gratë dhe fëmijët që dhunohen nga familjarët e tyre e mitura u shpreh: “Dhuna nuk duhet të tolerohet, nënat duhet të kërkojnë mbrojtje për vete dhe për fëmijët e tyre. Një familje në të cilën ushtrohet dhunë nuk mund të quhet familje”.

INTERVISTA ME AUTORËT

Procesi i intervistimit të autorëve u bë i mundur në kuadër të bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Autorët janë dënuar me vendim të formës së prerë për vrasje të cilat janë vlerësuar si femicide në zbatim të elementeve klasifikues të analizuar në raport.

Rasti nr.1

Numri i vendimit 660, datë 30.03.2024, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Autori është i grup moshës 45-59 vjeç

Numri i fëmijëve: Dy

Arsimi: I lartë

Statusi i punësimit në kohën e ngjarjes: I punësuar

Gjendja gjyqësore: I pa dënuar më parë

Nga të dhënat e vendimit të gjykatës rezulton se familja e të dënuarit jetonte në kushte të mira ekonomike.

Në lidhje me këtë rast, ekipi përgjegjës për kryerjen e intervistës konstatoi se i dënuari i planifikuar për t'u intervistuar nuk ishte në gjendje t'iu përgjigjej pyetjeve të pyetësorit të përgatitur paraprakisht për shkak të problemeve të shëndetit mendor. Nga analizimi i vendimit të gjykatës rezulton se i dënuari në fjalë i ishte nënshtruar kryerjes së ekspertimit psikiatrik. Në

aktin e ekspertimit të përgatitur nga grupi i ekspertëve citohet: “Pas ngjarjes autori shfaq simptoma të çrregullimit të stresit pas traumës, por në kohën e kryerjes së veprës penale ai nuk vuante nga probleme të shëndetit mendor që të kenë drejtuar gjykimin dhe sjelljen e tij” dhe autori u vlerësua si i përgjegjshëm për veprën e kryer.

Nga takimi me të dënuarin u konstatua se gjendja e tij psiko-emocionale ishte tepër e rënduar. A ai nuk ishte në gjendje të kuptonte arsyen e intervistimit dhe me të nuk mund të zhvillohej një bisedë normale.¹⁰¹ Sipas komunikimit me titullarët e institucionit, i dënuari merrte rregullisht mjekimin e nevojshëm dhe asistohet nga stafi psiko-social i institucionit.

Raste të tilla tregojnë se këto ngjarje sjellin pasoja tepër të rënda edhe për shëndetin mendor të autorëve. Titullarët e institucioneve të burgjeve na komunikuan se, për shkak të gjendjes së rënduar mendore, disa prej tyre tentojnë edhe të vetëvriten në ambientet e burgut.

Rasti nr.2

Numri i vendimit 406, datë 17.07.2024, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan

Autori është i grup moshës 45-59 vjeç

Numri i fëmijëve: Tre

Arsimi: 8-vjeçar

Statusi civil : I martuar

Statusi i punësimit në kohën e ngjarjes: I punësuar

Gjendja gjyqësore: I padënuar më parë

Ai është dënuar me burgim të përjetshëm me vendim të Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për veprën penale “Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” (neni 79/c i KP), për vrasjen e kumatës së tij. Autori e ka pranuar akuzën dhe ka shprehur pendim për veprën e kryer. Ai ka pretenduar se krimin e kreu në kushtet e vetëmbrojtjes.

I dënuari shprehet se gëzonte shëndet të mirë para ngjarjes, ndërsa pas ngjarjes ka qenë i shtruar disa ditë në spitalin e burgut për shkak të gjendjes së rënduar psiko-emocionale. Në lidhje me raportet me familjarët pas kryerjes së krimit, ai thotë se është vizituar nga dy djemtë e tij.

Ai gjithashtu punonte në I EVP-në ku po vuan dënimin, pasi, siç shprehet ai, puna e ndihmon të kalojë traumën që ka pësuar pas ngjarjes. Ai thotë se vizitohet shpesh nga stafi mjekësor i I EVP-së dhe kurohet në mënyrë të rregullt për shkak të tensionit të lartë.

I dënuari thotë se nuk u vizitua nga një mjek psikiatër gjatë procedimit penal, pasi, sipas tij, gjendja e tij shëndetësore ishte e stabilizuar.

¹⁰¹Ky konstatim iu parashtrua administratës së burgut duke rekomanduar kryerjen e një rivlerësimi të gjendjes mendore të të dënuarit me qëllim adresimin e nevojshëm të nevojave të të dënuarit dhe parandalimin e ndonjë ngjarje tjetër në I EVP.

Në lidhje me pyetjen nëse kishte pasur ndonjë varësi përpara ngjarjes, ai shprehet se pas vdekjes së bashkëshortes së tij të parë si pasojë e një sëmundje të rëndë, ai kishte filluar të abuzonte me alkoolin. Pas rreth një viti e gjysmë nga vdekja e bashkëshortes së tij të parë, ai kishte lidhur një martesë tjetër. Ai thotë se me bashkëshorten e re kishin një jetesë normale dhe kalonin shumë mirë së bashku. Por, sipas tij, motra e saj ndërhynte herë pas here në marrëdhënien e tyre. Për shkak të këtyre ndërhyrjeve ai kishte shpesh konflikte me kumatën e tij. Ditën e ngjarjes, thotë se pas punës kishte pirë me shokët, ishte kthyer në shtëpi dhe nuk e kishte gjetur bashkëshorten në banesë. Kishte dalë në lagje që ta kërkonte dhe e kishte gjetur së bashku me të motrën tek po kullosnin bagëtitë. Pas një debati me kumatën e tij, gjatë të cilit, sipas tij secili ka përdorur fjalë fyese, situata ka precipituar në përdorimin e dhunës, ku autori e ka goditur viktimën me sëpatë, duke i shkaktuar vdekjen dhe më pas është vetëdorëzuar në polici.

Në lidhje me njohjen me të drejtat pas ngjarjes, autori pohon se ishte njohur me të drejtat por thotë se në gjendjen e rënduar në të cilën ndodhej pas ngjarjes, nuk i ka kuptuar mirë.

Në lidhje me pyetjen nëse kishte ndonjë pretendim në lidhje me shkeljen e të drejtave të tij nga policia, prokuroria, gjykata, administrata e IEVP-së, shprehet se të gjithë kanë pasur sjellje korrekte ndaj tij. Në mënyrë të veçantë shpreh vlerësimin e tij për mbështetjen e ofruar në IEVP-në Elbasan dhe marrëdhëniet shumë të mira që ka me personelin dhe të dënuarit e tjerë.

I dënuari shpreh rezerva në lidhje me avokatin mbrojtës të caktuar kryesisht, i cili sipas tij nuk e kishte takuar përpara gjyqit dhe nuk ishte angazhuar siç duhet për mbrojtjen e tij.¹⁰² Avokati i caktuar kryesisht ka detyrimin të takohet me të pandehurin dhe të angazhohet në realizimin e mbrojtjes efektive në funksion të zbatimit të parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit në procesin penal.

Në këtë kuadër **rekomandohet** vënia në lëvizje e mekanizmave që nxisin monitorimin e shërbimeve të ofruara nga avokatët kryesisht, si dhe ngritja e kapaciteteve të tyre në funksion të realizimit të mbrojtjes efektive.

Gjatë gjithë intervistës u vu re pendimi i thellë i të dënuarit i cili herë pas here shprehej se jeta e tij kishte marrë fund pas asaj ngjarjeje. Në lidhje me motivet e krimit, ai u shpreh se ngjarja ndodhi pas një konflikti të çastit dhe për shkak se ishte në gjendje të dehur. “Nëse nuk do të kisha qenë i dehur nuk do ta kisha kryer kurrë një krim të tillë”, tha ai.

¹⁰²Neni 6 i KEDNJ-së, i siguron të akuzuarit të drejtën për t'u mbrojtur personalisht ose nëpërmjet asistencës ligjore të zgjedhur prej tij/saj, ose nëse ai/ajo nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar asistencë ligjore, t'i jepet asistencë ligjore pa pagesë, kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë.


Në lidhje me pyetjen nëse mendon se ngjarja mund të parandalohet, ai shprehet se duhet t'iu ishte shmangur konflikteve dhe duhet të kishte kërkuar ndihmë për të ndërprerë konsumimin e alkoolit.

Në lidhje me mesazhin që do t'ju përcillte grave dhe vajzave që përballen me dhunën, ai thotë se dhuna është e patolerueshme dhe secili që ndodhet në situata të tilla duhet të kërkojë ndihmë për të gjetur një rrugë shpëtimi dhe për të parandaluar ngjarje të tilla kaq të rënda.

Në lidhje me mesazhin që mund të përcjellë për personat që ushtrojnë dhunë ndaj grave dhe vajzave, ai shprehet se:

“Në asnjë rrethanë nuk duhet që një burrë të ushtrojë dhunë ndaj një gruaje. Nëse marrëdhënia nuk funksionon, secili duhet të kërkojë ndihmë për të gjetur një zgjidhje”.

Harta e qendrave kombëtare dhe strehëzave për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje



LITERATURA

Referenca kombëtare

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë.
- Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur .
- Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021–2030, dhe Plani i saj i Veprimit.
- Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030.
- Raporti “Vrasjet e grave (femicidi) dhe tentativa për femicid në Shqipëri (2017-2020)”.
- Raportet vjetore të Prokurorit të Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit viti 2022 dhe 2023.
- Raporti i Avokatit të Popullit “Për standardin e minimumit jetik në Shqipëri”, viti 2021
- Raporti i Avokatit të Popullit “Mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri për periudhën Janar 2020-Shtator 2021”
- Raporti i veçantë i Avokatit të Popullit “Analizë e efikasitetit të drejtësisë për fëmijët, në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve familjare”, 2024.
- Raporti i INSTAT-it “Burra dhe gra”, viti 2023.
- Raporti Vjetor i Këshillit të lartë Gjyqësor, viti 2022 dhe 2023
- Analizat Vjetore të Performancës, viti 2022 dhe 2023, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.
- Studimi i QDNJD-së “Sistemi gjyqësor si pararendës në mbrojtjen e të drejtave të viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, periudha e monitorimit 2020-2021.

Referenca ndërkombëtare

- Konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin nr. 1769, datë 9.11.1993.
- Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, ratifikuar me Ligjin nr. nr. 104/2012, datë 8.11.2012.
- Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 25 tetor 2012, “Krijimi i standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA”.
- Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, 2024.

- Rekomandimi i përgjithshëm nr. 35, mbi dhunën me bazë gjinore kundër grave, që përditëson rekomandimin e përgjithshëm nr. 19”.
- *Building trust by delivering support, protection and justice* (Ndërtimi i besimit përmes ofrimit të mbështetjes, mbrojtjes, dhe drejtësisë), Raporti i parë tematik vlerësues për Shqipërinë, shtator 2024.
- *Analysis of 2021 femicide and attempted femicide cases in Georgia* (Analizë e rasteve të femicidit dhe tentativave për femicid në Gjeorgji në vitin 2021), përgatitur nga mbrojtësi publik në Gjeorgji, në kuadër të programit të përbashkët të OKB-së “Për barazi gjinore”, me mbështetjen financiare të Suedisë.
- *Defining and indentifying femicide* (Përkufizimi dhe identifikimi i femicidit), shqyrtim bibliografik, përgatitur nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore (IEBGJ), 2021.
- *Establishing a Femicide Watch in Every Country* (Krijimi i një observatori të femicidit në çdo vend), botim i Këshillit Akademik të Sistemit të Kombeve të Bashkuara (ACUNS) dhe Vienna Liaison Office, volume VII, 2017.
- *Femicide as a Form of Gender Based Violence* (Femicidi si formë e dhunës me bazë gjinore), Fanny Johansson, 2021.
- Femicide Census 2021, përgatitur nga Femicide Census Organisation.
- *Femicide: a classification system* (Femicidi: një sistem klasifikimi), përgatitur nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore (IEBGJ), 2021.
- *Improving legal responses to counter femicide in the European Union* (Përmirësimi i përgjigjeve ligjore për luftimin e femicidit në Bashkimin Evropian), përgatitur nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore (IEBGJ), 2023.
- *Measuring Femicide in EU and internationally* (Matja e femicidit në BE dhe në nivel ndërkombëtar), përgatitur nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore (IEBGJ), 2021..
- *Measuring femicide in Italy* (Matja e femicidit në Itali), përgatitur nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore (IEBGJ), 2020.
- Raporti i përbashkët të Zyrës së Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe Krimin (UNODC) dhe UN Women, “Femicidet në 2023 - vlerësime globale të femicideve nga partnerët intimë dhe anëtarët të familjes”, viti 2024.
- Raporti i UNODC dhe UN Women “Vrasja e grave dhe vajzave e lidhur me gjininë”, Vlerësime globale në lidhje me vrasjet e grave dhe vajzave nga partnerët intimë dhe anëtarët e familjes, viti 2022.
- *Statistical framework for measuring the gender-related killing of women and girls (also referred to as “femicide/feminicide”)* (Kuai statistikor për matjen e vrasjeve të grave dhe vajzave të lidhura me gjininë). Përgatitur nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe

Krimet dhe Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave, miratuar nga Komisioni Statistikor i Kombeve të Bashkuara në sesionin e 53-të, 28 shkurt – 2 mars dhe 4 mars 2022.

Praktikë gjyqësore

- Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- Vendime të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Vendime të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.